Rruga e Arbërit

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 9 (125). SHTATOR 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Korabi kthehet te fitorja

Nga **Defrim Methasani**



13

Isuf Koçi, "Qytetar Nderi" i Bulqizës

Nga **Azis Keta**


12

Afrim Murrja, një shkollë për blektorët e rinj

Nga **Osman Xhili**


7

■ **Dështon tenderi** për HEC e Katundit të Ri ■ **Turizmi** në Dibër, një potencial ekonomik i pashfrytëzuar ■ **Ikja** e Profesorit! ■ **Kryeministri Rama:** "Dibra i ka dhënë mend gjithë Shqipërisë" ■ **Një ide** për pavarësinë e komuniteteve nga veprimtaria minerare ■ **Anekdoda** postelektorale ■ **Ç'kemi asaj Dibre!** ■ **Për kë** luan Korabi? ■ **Ylber Pilku** hap një muze shqiptar në mes të New Jorkut ■ **Plagë** që dhëmbin fort ■ **Hasan Çipuri**, "ky është vetëm fillimi..." ■ **Kryengritja** e dibranëve e Shtatorit 1913 ■ **Vjeshta** dibrane midis ngjyrave të arit dhe ylberit ■ **Bledar Kaca**, talenti i ri i këngës popullore dibrane ■ **Rrëfenjë** për kirurgun Tahir Alku ■ **Kanuni** me ... shekën e kosit(!) ■ **Halim Leska**, i vetëm kundër ushtrisë serbe ■ **Tahsim Oshafi**, kompozitor i harruar ■ **Dr.Islam Cani** është i gjallë me kontributin shoqëror dhe veprat e botuara ■ Homazh për Halit Bushin

Zgjedhjet rikthejnë shpresën për Rrugën e Arbrit

■ **"Rruga e Arbrit" apo "Rruga e Sizifit"?!** Nga **Adem Bunguri**

■ **"Jemi kundër çdo projekti që eliminon tunelin e Qafë Murrizit"**

■ **Kryeministri Rama: Ne i kemi borxh Dibrës Rrugën e Arbrit, të cilën duhet ta nisim me patjetër brenda këtij viti të fundit të mandatit tonë!".**



Deklaratë e Grupit të Lobimit për Rrugën e Arbrit:
Ne shpresojmë se simbolika e marrjes seriozisht të kësaj çështje do të jenë fillimi i punimeve në Tunelin e Qafë Murrizës. Çdo nisje punimesh në vend tjetër para zgjedhjeve të ardhshme do të jetë një veprim i gabuar në interes të vendit, pavarësisht se qeveria mund ta interpretojë si një mbajtje premtimi. Tani për tani premtimi i kësaj qeverie se "Rrugë e Arbrit do të ndërtohet brenda këtij mandati" është një premtim i pambajtur.

Speciale në faqet 3,4,5,6,9

KNAUF Bashkëpunon me komunitetin

www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

KUJTOJMË BASHKËPUNËTORËT tanë se çdo shkrim i botuar në një media tjetër apo rrjete sociale nuk ka përparësi botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

Faleminderit për mirëkuptimin!

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 9 (125). 1 - 30 Shtator 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA

Kontribuan për këtë numër:
Adem BUNGURI
Xhafer MARTINI
Defrim METHASANI
Vjollca SADIKU
Agim KASA
Tan LLESHI
Azis KETA
SELMAN MEZIU
Dritan BRUNGA
Haki PËRNEZHA
Metush SKEJA
Suat SHATKU
Faik XHANI
Ali HOXHA
Sulejman TOMÇINI
Shahin LAZRI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL902021121900000047000366 40

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Dështon tenderi për HEC e Katundit të Ri

Në tender nuk ka pasur asnjë ofertë të dytë. Konsorciumi turk akoma nuk është shprehur mbi vendimin.



Dhënia me koncesion e hidrocentralit Katund i Ri, pjesë e projektit elektroenergjitik të Skavicës është anuluar. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është firmosur nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë, Damian Gjiknuri, ndërkohë që arsyeja e cituar me një fjali brenda tij, në dukje mbetet procedurale. "Për arsye se nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore, vendos anulimin e procedurës konkurruese 'Dhënie me koncesion e Hidrocentralit, Katund i Ri", shkruhet mbi firmën e ministrit.

IKJA E TURQVE

Interesit për dinamikën e zhvillimit të procesit të tenderimit, deri në anulimin e vendimit, i është përgjigjur Ministria e Energjisë dhe Industrisë me argumentet ligjore të tenderimit. "Në janar është bërë një ofertë e pa kërkuar në rastin konkret është bërë nga një konsorcium i dy kompanive turke. Në zbatim të ligjit, kur një kompani paraqet një ofertë të pa kërkuar vlerësohet nga qeveria me një bonus pikësh.

Pra, ka pasur një vendim të Këshillit të Ministrave që i ka dhënë bonus (kjo për shkak se kjo kompani ka bërë studime teknike, studime financiare etj), e më pas është autorizuar ministria përgjegjëse për të hapur procedurën për dhënien me koncesion të kësaj vepre", citon MEI.

Më tej, deklarata e Ministritë vijon me procedurën e radhës për gjetjen e kompanive konkurrente, siç e parashikon ligji, edhe me njoftim mediatik ndërkombëtar. "Është detyrim që procedura të njoftohet dhe të bëhet tender ndërkombëtar, pra të njoftohet përmes medias ndërkombëtare.

Në rastin konkret, është dhënë njoftimi nga "The Economist" dhe përmes tij është lënë një afat për kompanitë që shfaqin interes dhe të sjellin propozimin në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Kur skadon afati, bëhet një konkludim për të parë sa oferta kanë ardhur, e në këtë rast nuk ka pasur asnjë ofertë të dytë. Pra, në përfundim për shkak se nuk ka ofertë, procedura konsiderohet e anuluar", sqaron ministria.

Ndërkohë, teksa koncesioni është anuluar dhe banorët e zonës kanë legjitimitetin për të festuar, pas protestave që kanë bërë, ministria e Energjisë ajo që e lë të hapur mundësinë për një proces të dytë tenderimi në ardhmen. "Tashmë gjithçka është anuluar, është ezauruar, por nëse do të ketë sërish shfaqje interesi dhe garë mes kompanish, aty mund të investohet e të ndërtohet HEC".

KONCESIONI

Qeveria shqiptare vendosi dhënien me koncesion të ndërtimit të Katundit të Ri në 7 janar të këtij viti, 2 javë pasi kompania turke Suzer bëri një ofertë të pa kërkuar, ku Këshilli i Ministrave i miratoi asaj edhe një bonus prej 8 pikësh si shpërblim për hartimin e projektit. Ky ka qenë një nga koncesionet më të sulmuar nga ana e opozitës, e cila akuzoi kryeministrin dhe ministrin e ekonomisë në atë kohë, Arben Ahmetaj për favorizim të firmës turke, pasi projekti ka qenë i studiuar disa herë, madje datonte që prej vitit 1960.

Skavica është menduar si një hidrocentral i cili do të kishte të instaluar një fuqi prej 350 MËH dhe përveç ndërtimit të HEC-it do të krijonte një liqen të ri i cili do të shërbente për rritjen e eficencës së prodhimit të gjithë kaskadës së Drinit. Në 2007-ën, kompania TKG bëri një studim për korporatën elektroenergjitike dhe i dha asaj 3 alternativa zhvillimi. Qeveria shqiptare zgjodhi atë të ndarjes në dy HECe, Katund i ri dhe Skavica 385, ku vlera e investimit shkonte në 110 milion euro dhe fuqia e hidrocentralit 70 MËH. Por edhe pse njoftoi ambicien e saj për këtë vepër edhe në faqen e internetit, bashkimi i firmave "Suzer" dhe "Nurol" nuk ka dhënë asnjë detaj për tërheqjen nga ky projekt.

PROTESTAT

Në muajin shkurt, qindra banorë të luginës së Drinit të Zi u mblodhën në një tubim në qendër të Maqellarës, për të kundërshtuar ndërtimin e hidrocentraleve të Katundit të Ri dhe atë të Skavicës. Kryetari i shoqatës së Drinit të Zi u bëri të ditur se në dy brigjet e Drinit pjesa më e madhe e tokave janë të pa regjistruara, dhe nuk ua kanë regjistruar ndoshta qëllimisht, por këto janë toka të trashëguara dhe jo toka të falura me ligjin 7501. Ndërkohë, Partia Demokratike përmes një deklarate në media, lajmëroi se koncesioni i Skavicës është korruptiv dhe në rast se do t'u jepej turqve të Suzer, ajo do ta zhbënte me forcën e ligjit.

NERITAN GJERGO
(Marrë me shkurtime nga gazeta "Shekulli")

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Bëj pajtimin tënd me
PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

OKAZION
SHITET APARTAMENT NË BLLOK
DUBLEKS, 281 M².
Kati i tretë: dhomë ndjenje, kuzhinë, 1 dhomë gjumi, banjo, 2 ballkone.
Kati i katërt: 4 dhoma gjumi, 2 banjo, 2 ballkone.
Tel: **069 55 271 83**

‘Jemi kundër çdo projekti që eliminon tunelin e Qafë Murrizit’

Pas zgjedhjeve në Dibër, Kryeministri Edi Rama dhe aktorë të tjerë, inxhinierë dhe specialistë të ndërtimit të rrugëve në Shqipëri, kanë dhënë opinione që bien ndesh me njëra -tjetrën.

Në vëmë re në këto deklarata një rrezik që i kanoset standardit të ndërtimit të Rrugë së Arbrit dhe me këtë rast do të donim t’i vinim në dukje për publikun.

Nga njëra ana kemi deklaratat e Kryeministrit, i cili thekson se “fitorja e Bashkisë së Dibrës është një besim i madh për të bërë shumë më tepër për Dibrën. Dhe ne do të bëjmë për Dibrën më shumë se çfarë bënë të tjerët në 20 e ca vite të marra së bashku”.

Në një postim në Facebook Edi Rama shkruan: “Ne i kemi borxhe Dibrës në këto tre vite, duke filluar nga rruga e Arbrit! E cila është një borxh i vjetër e i mbartur qeveri më qeveri ndaj dibranëve, por ne duhet ta nisim me patjetër brenda këtij viti të fundit të mandatit tonë!”

Por ndërkohë që Edi Rama lëshon deklarata shumë premtuese për Dibrën, nga ana tjetër kemi propozime që cënojnë standardin e Rrugës së Arbrit, propozime të cilat shkojnë kundër deklaratave të Kryeministrit.

Duke pasur parasysh se edhe në të shkuarën mes premtimeve dhe realizimeve faktike ka pasur deformime të mëdha, dëshirojmë të vëmë në dukje për publikun çështjen e rreziku të humbjes përfundimisht të standardeve në ndërtimin e rrugës.

Ndërkohë që mbështesim përpjekjet e Kryeministrit (përpjekje që akoma mbeten ri-premtime) për ndërtimin e rrugës së shumëpritur nga dibranët dhe të gjithë shqiptarët, dëshirojmë të theksojmë se propozimet e ripërsëritura gjatë këtij viti të Inxhinier Faruk Kabës, bien ndesh me interesat e qytetarëve të Dibrës për një rrugë me standarde bashkëkohore, më kryesorja e të cilave është siguria e përdoruesve të rrugës.

Propozimi i Kabës, i botuar në gazetën Panorama [1] dhe në disa portale [2], është “ndërtimi paraprakisht i një bypass-i në vend të tunelit të Murrizit”. Kaba e argumenton këtë me shkurtimin e buxheteve të nevojshme financiare, afatin e ndërtimit e realizimit të veprës, si dhe hapjen e rrugës në 15-18 muaj.

Ky opinion i Kabës vjen i ripërsëritur pas tre muajsh, kur me një shkrim të ngjashëm në gazetën Mapo [3] dhe gazetën “Rruga e Arbërit” [4] iu kundërvu ministrit Haxhinasto. Edhe në atë shkrim Kaba hodhi idenë e ndërtimit të një bypass-i në vend të tunelit.

Ne dëshirojmë të theksojmë se jemi kundër çdo projekti që eliminon tunelin e Qafë Murrizit. Tentativa për eliminimin e tunelit përbën ‘grushtin’ e fundit për ndalimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit sipas standardeve ndërkombëtare dhe qëllimit kryesor të saj për të shërbyer njëkohësisht si një ‘urë’ që do të lidhë jo vetëm Dibrën me kryeqytetin, por edhe të afrojë Shkupin me Tiranën.

Ne dëshirojmë të theksojmë edhe njëherë se projektet e deritanishme të zbatimit dhe puna në terren për Rrugën e Arbrit kanë qenë jashtë këtyre standardeve.



Në foto: Tuneli i Qafës së Buallit, njëri nga treguesit e standardeve të prishura të Rrugës së Arbrit. Foto: © B.Karoshi / Mars 2016

> Ndërkohë që mbështesim përpjekjet e Kryeministrit (përpjekje që akoma mbeten ri-premtime) për ndërtimin e rrugës së shumëpritur nga dibranët dhe të gjithë shqiptarët, dëshirojmë të theksojmë se propozimet e ripërsëritura gjatë këtij viti të Inxhinier Faruk Kabës, bien ndesh me interesat e qytetarëve të Dibrës për një rrugë me standarde bashkëkohore, më kryesorja e të cilave është siguria e përdoruesve të rrugës.

Media dhe specialistë të infrastrukturës kanë theksuar me të drejtë çdo shmangie që i është bërë deri tani rrugës nga projektet fillestare. Rruga Bulqizë-Ura e Çerenecit, për shembull, aktualisht është krejt ndryshe nga projektet fillestare, pasi është ndërtuar mbi segmentin e vjetër të rrugës dhe nuk ka asnjë standard sigurie. Ndërsa rruga nga Qyteti i ri i Bulqizës drejt tunelit të Qafë-Buallit pësoi ndryshime që na çojnë në dyshime për veprime korruptive. Dhe së fundi, tuneli i Qafë-Buallit ndryshoi krejtësisht projekt dhe u ndërtua në një pozicion krejt të papërshtatshëm, duke cënuar rëndë sigurinë në rrugë.

Ne kemi marrë informacione koefidenciale që theksojnë se “qeveria Shqiptare po shikon mundësinë e ndërtimit të rrugës me buxhetin e shtetit ose me fonde të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”.

Nuk është detyra jonë të kështillojmë qeverinë shqiptare se si ajo do t’i gjejë fondet e mjaftueshme. Ajo që ne e konsiderojmë si detyrë tonën dhe përgjegjësi qytetare është të ngremë zërin që këto 27 km rrugë të mbetura t’i japin frymëmarrje rrugës në rritjen e qarkullimit në vitet e ardhshme. Përdryshe, çdo akrobaci nga politikanë dhe personel teknike të papërgjegjshëm do të rezultojë në rrëzimin përfundimisht të ëndrrës për një rrugë me standarde ndërkombëtare, e cila garanton sigurinë e përdoruesve dhe integron shqiptarët e harruar në Shqiperi dhe Maqedoni.

Ne do ta mbështesim qeverinë shqiptare që të vazhdojë përpjekjet për gjetjen e burimeve të financimit dhe kompani ndërtuese serioze brenda e jashtë vendit, me qëllim që sa më parë të fillojnë punimet në rrugë.

> Ne dëshirojmë të theksojmë se jemi kundër çdo projekti që eliminon tunelin e Qafë Murrizit. Tentativa për eliminimin e tunelit përbën ‘grushtin’ e fundit për ndalimin e ndërtimit të Rrugës së Arbrit sipas standardeve ndërkombëtare dhe qëllimit kryesor të saj për të shërbyer njëkohësisht si një ‘urë’ që do të lidhë jo vetëm Dibrën me kryeqytetin, por edhe të afrojë Shkupin me Tiranën.

> Kryeministri e lexoi fitoren e Bashkisë së Dibrës “si një detyrim shumë të madh ndaj dibranëve”. Ndaj i kërkojmë Rames që me të njëjtin besim dhe detyrim të angazhohet maksimalisht që të mos rrezikohen standardet e ndërtimit të rrugës.

> Ne shpresojmë se simbolika e marrjes seriozisht të kësaj çështje do të jenë fillimi i punimeve në Tunelin e Qafë Murrizës. Çdo nisje punimesh në vend tjetër para zgjedhjeve të ardhshme do të jetë një veprim i gabuar në interes të vendit, pavarësisht se qeveria mund ta interpretojë si një mbajtje premtimi. Tani për tani premtimi i kësaj qeverie se “Rrugë e Arbrit do të ndërtohet brenda këtij mandati” është një premtim i pambajtur.

Kryeministri e lexoi fitoren e Bashkisë së Dibrës “si një detyrim shumë të madh ndaj dibranëve”. Ndaj i kërkojmë Rames që me të njëjtin besim dhe detyrim të angazhohet maksimalisht që të mos rrezikohen standardet e ndërtimit të rrugës.

Ne shpresojmë se simbolika e marrjes seriozisht të kësaj çështje do të jenë fillimi i punimeve në Tunelin e Qafë Murrizës. Çdo nisje punimesh në vend tjetër para zgjedhjeve të ardhshme do të jetë një veprim i gabuar në interes të vendit, pavarësisht se qeveria mund ta interpretojë si një mbajtje premtimi. Tani për tani premtimi i kësaj qeverie se “Rrugë e Arbrit do të ndërtohet brenda këtij mandati” është një premtim i pambajtur.

[1] http://www.panorama.com.al/faruk-kaba-projekt-per-rrugen-e-arbrit-pa-tunel-por-qeveria-e-refuzoi/

[2] http://www.dritare.net/2016/09/11/inxhinieri-kaba-ministria-e-transporteve-kerkoi-financues-pa-pasur-projekt-per-rrugen-e-arbrit/1

[3] http://www.mapo.al/2016/06/genjeshtra-per-rrugen-e-arberit/1

[4] Gazeta “Rruga e Arbërit”, nr. 122, f.6, qershor 2016.



Plani i Bardhë.

analizë

Gjatë këtyre 20 viteve është bërë studimi i fizibilitetit dhe projekti (jo i plotë) i rrugës, është mbajtur në Tiranë një Kuvend Kombëtar mbi Rrugën e Arbrit (2007), janë shkruar dhjetëra artikuj mbi këtë rrugë dhe potencialet e saj, janë bërë emisione në Radio&TV dhe janë sjellë argumente të shumtë mbi domosdoshmërinë historike të ndërtimit të saj! Megjithatë, duke e parë se përpjekjet e dibranëve për ndërtimin e «Rrugës së Arbrit» i ngjajnë «mundimeve të Sizifit», po e rishtroj këtë çështje, duke e plotësuar atë edhe me një vështrim të shkurtër arkeologjiko-historik, me shpresën për të ndikuar sadopak tek organet vendimarrëse dhe dëshirën për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se në një sistem demokratik, janë vetë ata që e kanë në dorë fatin e tyre dhe të rrugës së tyre dhe jo «Sizifët» që vijnë e shkojnë!

"Rruga e Arbrit" apo "Rruga e Sizifit"?!

Nga **Prof. dr. ADEM BUNGURI**

NË VEND TË HYRJES

Kanë kaluar tashmë 20 vjet, që nga peticioni i parë i intelektualëve dibranë drejtuar qeverisë së Shqipërisë, ku argumentohej nevoja e domosdoshme e ndërtimit të «Rrugës së Arbrit», në kontekstin e zhvillimeve gjeo-strategjike të vendit dhe rajonit. Gjatë këtyre 20 viteve, është bërë studimi i fizibilitetit dhe projekti (jo i plotë) i rrugës, është mbajtur në Tiranë një Kuvend Kombëtar mbi Rrugën e Arbrit (2007), janë shkruar dhjetra artikuj mbi këtë rrugë dhe potencialet e saj, janë bërë emisione në Radio&TV dhe janë sjellë argumente të shumtë mbi domosdoshmërinë historike të ndërtimit të saj! Megjithatë, duke e parë se përpjekjet e dibranëve për ndërtimin e «Rrugës së Arbrit», i ngjajnë «mundimeve të Sizifit», po e rishtroj këtë çështje, duke e plotësuar atë edhe me një vështrim të shkurtër arkeologjiko-historik, me shpresën për të ndikuar sadopak tek organet vendimarrëse dhe dëshirën për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se në një sistem demokratik, janë vetë ata që e kanë në dorë fatin e tyre dhe të rrugës së tyre dhe jo «Sizifët» që vijnë e shkojnë!

Tek të gjithë ato që nuk kanë shkelur në Dibër, ekziston mendimi se ajo përfaqëson një krahinë të thellë e të izoluar malore. Ky mendim pati mbizotëruar edhe në qarqet më të larta shtetërore të diktaturës, të cilët e trajtuan Dibrën si një provincë të thellë e të prapambetur malore dhe e izoluan atë në mënyrë sistematike. Ky izolim, për fat të keq, vazhdone ende, përderisa politika po e shtyn për në kalendat greke, ndërtimin e „Rrugës së Arbrit", kërkesës së vetme të dibranëve të të dy Dibrave në këto 25 vjet!. Por për ne që jetojmë në Dibër, dhe për të gjithë ata që origjina i lidh me këtë krahinë, mendimi i mësipërm nuk është krejtësisht i saktë. E vetmja e vërtetë e tij, është fakti, që në këtë krahinë mbizotëron relievi malor. Por me një frymëmarje të lirë komunikuese. Megjithëse malet zënë ¾ e sipërfaqes krahina e Dibrës nuk është e izoluar nga viset fqinje e ato më të largëta. Kjo gjë i detyrohet përshkimit të saj nga lumi i Drinit të Zi dhe bashkërrjedhësit e tij, që kanë përthyer prevalencën malore të terrenit, kanë krijuar dy pellgjet më të mëdha dhe të begatë të tij, atë të Dibrës dhe të Peshkopisë, dhe kanë përcaktuar vetitë komunikuese të rajonit tonë me viset fqinje e ato më të largëta. Duke pas atributet e një arterie me aks thuajse meridional, së bashku me degëzimet tërthore të Radikës, Drinit të Bardhë e afluentëve të tjerë, ky depresion lumor mori që në prehistori funksionin e një tranversaleje të rëndësishme ekonomike e kulturore me përmasa ballkanike. Nëpërmjet luginës së këtij lumi, rajoni ynë lidhej me pellget e Ohrit dhe të Korçës në jug dhe atë të Kukësit në veri, ndërsa përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në verilindje me Rrafshin e Dukagjinit, Fushë Kosovën dhe më tej me Ballkanin Qëndror. Në lindje lumi i Radikës e lidh atë me sistemin Moravë-Vardar dhe rrugët që hapen përgjatë tyre deri në Pelagoni, Maqedoninë Egjeane, Ballkanin Lindor e Thesali, ndërsa në perëndim, nëpërmjet Qafës së Buallit dhe asaj të Murrës, ai lidhet me pellgun e Matit dhe viset bregdetare. Është pikërisht ky pozicion gjeo-hapsinor i rajonit të Dibrës, që ka përcaktuar edhe rrugët tradicionale të tij nga jugu dhe veriu, nga lindja dhe perëndimi. Që nga viti 1913, kur Dibra, ashtu si dhe Shqipëria ishte ndarë më dysh nga të fuqishmit e Europës, porta e vetme perëndimore e Dibrës londineze ishte rruga që kalonte nëpër Qafën e Buallit. Në drejtimin Qafa e Buallit-Peshkopi, kjo rrugë kalonte kryesisht nëpër trasenë e dikurshme të "Rrugës së Arbrit".

PAK HISTORI

«Rruga e Arbrit», është rruga e tretë antiko-mesjetare më e rëndësishme në hapësirën shqiptare, pas **Via Egnatias** dhe asaj **Lissus-Naissus,** një rrugë e shkurtër dhe mjaft strategjike që lidhte Adriatikun me brendësinë kontinentale të Ballkanit, ose Dibrën me Dyrrahun. I ardhur në portin e Dyrrahut, udhëtarit antik, që duhej të përshkonte këtë rrugë, i duhej të kalonte në linjën Durrës-Tiranë-Zall-Bastar-Zall-Dajt-Tujan-Qafë-Murrize-Guri i Bardhë-Ura e Vashës-Plan i Bardhë-Qafa e Buallit-Bulqizë- Ura e Qytetit (ku gjenden rrënojat e qyetit mesjetar të **Geties**)-Ura e Çerenecit-Gjoricë-Dibër e Madhe. Vazhdimi i saj në FYROM nga qyteti i Dibrës ndjek luginën e Radikës(Rekë) deri në Qafë-Mavrovë, përshkon Pollogun dhe linjën Gostivar-Tetovë-Shkup, në një distancë të përgjithshme Tiranë-Shkup rreth 210km. Kjo ka qenë rruga tradicionale e Dibrës, e rrahur të paktën që nga shek. V para Kr. siç dëshmojnë zbulimi i dy përkrenareve prej bronzi të tipit ilir si dhe disa enëve me vërnik të zi të Dyrrahut në Sofraçan[1], buzë zallit të Bulqizës, nga kalonte kjo rrugë. Ajo mori trajtën e një rruge të vërtetë që në periudhën antike ilire, përkatësisht në shek. II-I para Kr, dhe veçanërisht në periudhën e hershme perandorake (shek. I-II pas Kr.), kur u përdor nga perandoria për qëllime ushtarake. Si dëshmi për këtë është sjellë edhe emri "Mansaj" i një lagjeje në Gur të Bardhë si mbetje toponimike e stacionit rrugor (« mansio ») të periudhës romake[2]. Rruga i nënshtrohet një rikonstruksioni të plotë në shek. XI pas Kr nga perandoria bizantine, përkatësisht gjatë dinastisë së Komnenëve, të cilët e përdorën atë si rrugën më të shkurtër natyrore, më të mbrojtur dhe më strategjike për të dalë nga Adriatiku në Ballkanin Qëndror e atë Lindor, ku interesat e perandorisë në këtë kohë kërkonin neutralizimin e orekseve ekspansioniste të shtetit mesjetar bullgar. Është shkrimtarja bizantine Ana Komnena, vajza e perandorit Aleksi I Komnen (1081-1118), që në veprën e saj **"Aleksiada"**[3], përmend për të parën herë rrugën që ndiqnin ushtritë bizantine, pasi zbarkonin në Durrës, për të dalë në trojet e Arbrit. Kjo ishte "Rruga e Arbrit", që përshkonte viset e Arbrit nga perëndimi në lindje, për të dalë në Ballkanin Lindor. Sipas burimeve historike antike dhe bizantine, viset e Arbrit shtriheshin midis Durrësit dhe Dibrës, ku në shek. II pas Kr. banonin « Albanët » sipas Ptolemeut, dhe në shek. XI pas Kr. « Arbrit » sipas M. Ataliatit. Inxhinierët ushtarakë të perandorisë kishin studiuar me hollësi viset e Arbrit dhe kishin përzgjedhur pikërisht trasenë e kësaj rruge, për vlerat e saj topografike dhe gjeo-strategjike.Kanë kaluar mbi 900 vjet nga koha kur u rindërtua kjo rrugë mbi bazën e një traseje më të hershme ilire! Rruga shfytëzohet gjërësisht gjatë mesjetës si rrugë e sigurtë strategjke dhe ushtarake. Nëpër këtë rrugë kaluan ushtri të ndryshme bizantine, madje edhe ushtria normane e Boemundit për pushtimin e tokave të rajonit të Dibrës, Pollogut dhe Shkupit (viti 1107)[4], ndërsa në vitin 1257 ushtria bizantine nën drejtimin e Gjergj Akropolitit[5], marshoi nëpër këtë rrugë për të shtypur kryengritjen e popullësisë arbëreshe të zonës së Dibrës. Gj. Akropoliti ka shënuar se **"duke u nisur nga Durrësi dhe duke kaluar nga vendet e Kunavisë si dhe duke kaluar malin, të cilin vendasit e quajnë Kaqi Petra shkova në krahinat e Matit dhe prej këndej arrita në Dibër"**[6]. Ajo pasqyrohet si rrugë e rëndësishme edhe në regjistrin kadastral osman të marsit 1467 dhe atë të vitit 1583, ku përmenden disa fshatra të quajtura "dervenë", që kishin detyrim ruajtjen dhe mirëmbajtjen e rrugës. « Rruga e Arbrit » vazhdon të përdoret gjatë gjithë periudhës së mesjetës, asaj të Rilindjes dhe të Pavarësisë deri në kohën e mbretërisë së parë shqiptare, madje ajo është përdorur deri vonë për qëllime ushtarake. Aksi i kësaj rruge ruan trakte të shtruar me kalldrëm, si dhe disa ura, prej të cilave vlen të përmendet Ura e Vashës (Klos). Në funksion të saj ishin ngritur edhe hane për të kaluar natën, të ngjashme me stacionet rrugore romake, si Hani i Toskës tek Ura e Qytetit në hyrje të Fushë-Bulqizës, Hani i Murrizit në Gur të Bardhë, Hani i Zall-Dajtit në Malësinë e Tiranës etj. Në Tiranë ajo njihet edhe sot me emrin "Rruga e Dibrës" dhe përfaqëson një nga 4 rrugët kryesore të kryeqytetit. Me ndërtimin e rrugës së re interurbane në vitet 30' të shekullit të kaluar, që lidhte Tiranën me Dibrën, e cila ndjek tjetër linjë, rruga e mësipërme e humbi gradualisht funksionin e saj. Megjithatë « Rruga e Arbrit » mbetet rruga më e shkurtër dhe më strategjike, që lidh Dibrën dhe viset e Shqipërisë Lindore me Tiranën dhe Adriatikun Lindor dhe përfaqëson tranversalen më të rëndësishme ballkanike ose koridorin që lidh Adriatikun me Detin e

(Vijon në faqen 5)

Qeveria aktuale nuk ka dhënë deri më sot as shenjën minimale se do të mbajë premtimin ndaj dibranëve në vitin 2013 se “sapo të vinte në pushtet do të bënte realitet ëndrrën e tyre dhe do të ndërtonte më në fund “RRUGËN E ARBRIt”!

(Vijon nga faqja 4)

Zi. Ndërtimi i rrugës së re Tiranë-Dibër, ose « Rrugës së Arbrit », përbën një imperativ të zhvillimeve të sotme integruese. Nëpërmjet kësaj rruge erdhën në Tiranë me mijëra dibranë, të dëbuar dhunshëm nga trojet e tyre në Dibrën Madhe e rrethinë prej politikës genocidiste dhe masakrave çnjerëzore serbe gjatë luftrave Ballkanike (1912-1913) dhe Luftës I Botërore (1914-1918). Deri në mbarim të Luftës I Botërore dhe çlirimit të Dibrës londineze(1921), kanë ndodhur dy valë të mëdha migruese të dibranëve, të lidhura me vitet 1913 dhe 1918-1921, të njohura në tradicionin popullor si “Muhaxhirllëku i parë” dhe “Muhaxhirllëku i dytë”. Dibranët u vendosën në disa zona të Tiranës, por pjesa më e madhe e tyre krijuan “Mëhallën e Dibranëve”, të lokalizuar aty ku sot është “Shkolla e Kuqe” dhe në afërsi të “Xhamllëkut”.Sipas të dhënave të shtypit periodik, nga “Mëhalla e Dibranëve” sot në Tiranë jetojnë afro 80.000 banorë me prejardhje nga Dibra[7]. Ende mbahen mend shtëpitë e tyre karakteristike një ose dykatëshe, me oxhaqe, me puse dhe obore të pastër dhe të mbushur me trëndafilë, me avlli të lyera me gëlqere, dhe rrugica të shtruara me kalldrëm, të cilat çdo mëngjez herët, spërkateshin me ujë dhe pastroheshin nga vashat e reja apo nuset e shtëpisë. Banorët autoktonë të Tiranës i pranuan me lehtësi dibranët migratorë, jo vetëm pse ata ishin mjaft korrekt dhe e paguan me flori çdo pëllëmbë toke të blerë, por edhe pse sollën një kulturë të re jetese, që gradualisht u përqafua edhe prej vendasve. Dibranët e ardhur në Tiranë u dalluan si njerëz të thjeshtë, të ndershëm dhe bujar, të përkushtuar ndaj punës dhe familjes, tipare që ua lehtësuan integrimin në vendbanimin e ri. Aq i plotë ishte ky integrim, sa që shumë shpejt miqësitë u përforcuan me anë martesash midis migratorëve dhe vendasve, ndërsa brezi i dytë dhe i tretë i dibranëve, në shumicë janë të martuar me banorë autokton të Tiranës. Duke folur për dibranët e Tiranës, Prof. dr. Aran Fuga, ka postuar në rrjetet sociale shënimin: «Dibranët e meritojnë të afrohen me Tiranën, se familjet e tyre e kanë mbajtur gjallë kulturën tiranase, duke qenë banorë të hershëm të saj, çfarë populli, çfarë familjesh, çfarë miqsh! Pa zë, plot mençuri, të thjeshtë, besnik, pastërtorë, familjarë të mirë, solidarë, besimtarë në vlera. Nuk thoshin kot »Ke dibranët!». »Mëhalla e Dibranëve» dhe «Rruga e Dibrës» janë dy toponime aq të njohura prej më se 100 vjetësh në Tiranë dhe janë pjesë organike e kryeqytetit shqiptar.

PERIUDHA KOMUNISTE (1944-1991) : BULQIZA DHE KROMI

Bulqiza është e identifikuar me kromin dhe minierën e tij, fillimet e të cilës datojnë në 18 shkurtin e vitit 1948[8], kur shënohet edhe lindja e qytetit të Bulqizës. Miniera e Bulqizës, më e madhja e këtij lloj në Shqipëri, deri në vitin 1990 jepte 32-37% të GDP[9]. Ajo njihet në literaturën botërore si një nga vendburimet më të pasura të kromit, që e rradhisin Shqipërinë në vendin II në botë për rezervat e kromit. Nga miniera e Bulqizës kromi dërgohej në portin e Durrësit, prej ku eksportohej nëpër botë! Pasi **“kromi çante bllokadën”,** dhe sillte të ardhurat më të mëdha të buxhetit të shtetit shqiptar! Atëherë Bulqizës dhe kromit i qe kushtuar dhe një këngë, e kënduar mjeshtërisht nga virtuozi Qemal Kartusha: ***“Që nga Durrësi në Bulqizë, rrugë e gjatë gjarpëron, më ngadalë se bagëtia, i ka mbushur rrugët plot!”*** dhe refreni: ***”Tý tý tý, bie boria, skoda ime fluturon, mos u trembni dhent’ e mia, skoda ime ju don fort!”.*** Megjithëse nga Bulqiza nxirrej krom pa pushim në 24 orë dhe miniera u shfrytëzua në mënyrë barbare, askush nga qeveria nuk u kujtua që kjo zonë të paktën e merritonte një rrugë për të qenë! Askush nga qeveria nuk u kujtua për t’ua lehtësuar rrugën e vështirë, të paktën shoferëve heronjë të skodave, që udhëtonin ditën dhe natën nga Bulqiza në Durrës dhe anasjelltas! Në rrugë të ngushta, gjithë kthesa, plot humnera dhe rreziqe! Në një shkrim brilant mbi Rrugën e Arbrit, shkrimtari Agron Tufa ka shënuar se ***“të gjithë ata që i kanë rënë kryq e tërthor Ballkanit e dinë se nuk gjendet kund mbi faqe të dheut rrugë më e rrezikshme, rrugë më e keqe, më e gjatë e më e vështirë se rruga torturuese Tiranë-Peshkopi”[10].*** Pa frikë teprimi, mund të thuhet se kjo është rruga më e vështirë dhe më e rrezikshme në Europë! Megjithatë, gjatë 50 viteve të regjimit komunist, për Bulqizën dhe Dibrën nuk u ndërtua asnjë rrugë për të qenë! Qeveria komuniste e trajtoi Dibrën dhe Bulqizën gati si koloni, duke i shfrytëzuar deri në palcë, duke u marrë gjithçka duke u dhënë fare pak, vetëm “bukën e përditshme” sa për të mbajtur frymën! Sipas të dhënave të shtypit sasia vjetore e xeherorit të kromit të nxjerrë nga Bulqiza ka arritur në 250.000 ton/vit[11], ndërsa sipas burimeve të tjera kjo sasi shkonte deri në 1 milion ton/vit[12]. Absurdi shtohej nga fakti se ndërsa ndërtoheshin rrugë të gjëra në vise të tjera të Shqipërisë, me fondet që buronin në shumicë nga kromi i Bulqizës, për rrugën e Bulqizës dhe të Dibrës nuk jepej asnjë cent! Dhe vargu i skodave udhëtonte çdo ditë dhe natë nga Bulqiza në Durrës dhe anasjelltas! Me miliona ton krom janë marrë nga Bulqiza dhe janë eksportuar nëpër botë! E ndërsa kromi konvertohej në florinj për shtetin shqiptar, minatorët e Bulqizës vuanin (dhe vazhdojnë të vuajnë)(!) nga skamja! Po ashtu, janë marrë nga Dibra me mijra ton mermer, me mijëra ton mollë, kumbulla, qershi, fruta të konservuara, reçelna të shumëllojshme, me mijëra ton patate, fasule, mish, gjalpë, djath etj! I gjith ky mall i Dibrës transportohej në rrugë pa rrugë, gjithë kthesa e rreziqe, që jo pak herë kanë marrë jetë njerëzish! Edhe pse Dibra përfaqësonte një nga rajonet me potenciale të fuqishme natyrore, dhe një vend i begatshëm për jetesë, ishte izoluar qëllimshëm nga regjimi komunist!. Edhe përpjekja e viteve 70’ të shekullit të kaluar, për zgjerimin e rrugës Bulqizë-Peshkopi, me nismën e Ministrit të Ndërtimit, dibranit të mirë, z. Rahman Hanku, ishte ndërprerë nga hakërrimi i vrerosur i Kryeministrit të atëhershëm! Vetëm në vitet e fundit të komunizmit, qeveria u kujtua se duhej investuar diçka në këtë drejtim, me fillimin e punimeve të hekurudhës së papërfunduar “Milot-Rëshen-Klos”. Lugina e Bulqizës ka shërbyer që kur u krijua jeta mbi tokë si koridor i rëndësishëm natyror për të lidhur pellgun e Dibrës me Adriatikun, përgjatë vijës ku është ndërtuar nga Bizanti “Rruga e Arbrit”. Ndërsa nga Qafa e Buallit në Peshkopi, rruga ndjek përgjithësisht trasenë e rrugës antiko-mesjetare të Arbrit, në pjesën tjetër të rrugës në perëndim të kësaj qafe, pra në rrugën nga Qafa e Buallit në Tiranë, rruga ndjek tjetër kahje. Në 70 vitet e fundit, dibranët duhej të bënin një trajektore të gjatë, të pakuptimtë dhe rraskapitëse, duke përshkuar mes për mes rrethet e Matit (Qafë-Buall-Klos-Burrel-Baz-Bushkash-Ulëz-Shkopet), Kurbinit (Milot-Laç-Sanxhak), Krujës (Thumanë-Fushë Krujë,Tapizë) për të arritur më në fund pas 6-7 orësh të lodhshme në Kamëz, Laprakë dhe Tiranë!



Një segment i rrugës së ndërtuar pranë pishave në Fushë Bulqizë.

PERIUDHA POSTKOMUNISTE (1992-2016)

Periudha e diktaturës komuniste dhe ajo postkomuniste dallohen nga dy koncepte të ndryshme lidhur me infrastrukturën rrugore. Ndërsa gjatë periudhës së parë, synohej përshkimi i sa më shumë qendrave të banuara nga rruga nacionale ose kalimi i saj afër tyre (karakteristikë e vendeve të varfëra të botës), gjatë periudhës së dytë, synohet që rruga nacionale apo ndërqytetëse të kalojë nëpër linja të drejta, në distancat më të shkurtëra të mundshme! Ky koncept modern, që kursen kohë, karburant dhe mjete të tjera, kthehet në një mundësi potenciale që pret të materializohet, sidomos në rastet kur egziston një trase e kahershme e rrugës, siç është në rastin tonë, traseja e Rrugës së Arbrit. Duke marrë si pikë referimi kohën e sundimit të Aleksit I Komnen (1081-1118), kur kjo rrugë u rindërtua dhe u bë një nga arteriet më të rëndësishme dhe strategjike të perandorisë në Ballkan, rezulton se ajo tashmë i ka mbushur plot 900 vjet të egzistencës së saj!

Për të parën herë çështja e ndërtimit të Rrugës së Arbrit, është shtruar mediatikisht nga publiçisti Hysen Uka, një nga mbështetësit më energjik të saj, në një kronikë për Radio Tiranën, me 8 tetor 1995! Ishte janari i vitit 1996 kur një grup prej 46 intelektualësh dibranë, i dërguan qeverisë peticionin e parë për ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”, një faksmile e të cilit është botuar kohët e fundit nga Abdurahim Ashiku edhe në shtypin periodik . Fillimi qe shpresëdhënës, pasi disa muaj më vonë qeveria Meksi miratoi një vendim për nisjen e studimit të fizibilitetit për 5 rrugë kryesore në vend, përfshirë dhe atë të Dibrës, por pa e cilësuar atë me përcaktorin “Rruga e Arbrit”! Duhet thënë se në atë kohë, kishim një dozë të lartë idealizmi dhe besimi se qeveritë e zgjedhura demokratikisht e kanë për detyrë të orientojnë politikat zhvillimore të vendit në drejtimet më të rëndësishme, ku pa asnjë dyshim, duhej përfshirë ndërtimi i “Rrugës së Arbrit”! Por viti i mbrapshtë 1997 përmbysi gjithçka, aq sa ndërtimi i kësaj rruge dukej atëhere si një luks i paarritshëm! Megjithatë, ëndrra e dibranëve vazhdon, presioni rritet dhe më 18 mars 2013, inicohet edhe një peticion online nga profesori dibran Gëzim Alpion (Londër), menjëherë i mbështetur nga dhjetra mijëra dibranë, brenda dhe jashtë Shqipërisë! Ndërkaq projekti i kësaj rruge në shumicën e gjatësisë së saj, është hartuar nga ing. dibran z. Faruk Kaba. Ndërsa rruga aktuale Peshkopi-Tiranë (megjithë shkurtimet nga rruga Tiranë-Shkodër) është 174km dhe zgjat 4-5 orë, rruga e re Tiranë-Dibër përgjatë Rrugës së Arbrit do të jetë 72.6-75km, dmth 100km më e shkurtër dhe udhëtimi do të zgjasë vetëm 1.5 orë!

Loti i parë i kësaj rruge në Fushë-Bulqizë, një lot fare i shkurtër, vetëm 100m, tërësisht elektoral, kishte filluar nga qeveria Nano në qershor 2005, vetëm një muaj para zgjedhjeve parlamentare të korrikut 2005! Por fillimi i vërtetë i saj lidhet me vitin 2007 dhe u intensifikua në vitet 2008-2009, kur u plotësua loti “Bulqizë-Ura e Qytetit” dhe lotet “Ura e Qytetit-Krajkë”, “Sofraçan-Çerenec” dhe “Maqellarë-Herbel”. Pavarësisht se lotet e mësipërme ishin jashtë parametrave të kërkuara nga një rrugë e këtij standarti, u krijua bindja se qeveria Berisha do të përfundonte ndërtimin e “Rrugës së Arbrit”! Sipas projektit të miratuar nga Këshilli i Ministrave në shtator 2008, parashihej përfundimi i saj në vitin 2013. Në atë kohë të gjithë besonim se sapo të mbarohej Rruga Durrës-Morinë, maqineritë e rënda të kompanisë “Bechtel Enka”, “që e hanin malin si mollë”, do të silleshin në “Rrugën e Arbrit” për të hapur tunelin e Qafë-Murrizit dhe atë të Qafë Buallit, gjë që për fat të keq, nuk ndodhi! Gjatë mandatit të dytë të qeverisë Berisha (2009-2013) u vazhdua me hapjen e trasesë së lotit “Qafë-Buall-Plan i Bardhë-Ura e Vashës”, hapjen e tunelit të Qafë-Buallit (kuota e të cilit u ndryshua padrejtësisht nga ajo e parashikuar në projekt) dhe u punua me lotin “Tiranë-Zall-Bastar”. Kur të gjithë prisnim me padurim të hapej tuneli i Qafë Murrizit, dhe të ndërtohej Ura e Madhe që bashkon kanionin midis Klosit dhe Planit të Bardhë, ndoshta vepra më e vështirë inxhinierike e kësaj rruge, krejt papritur, me një vendim të pakuptueshëm të qeverisë Berisha, të gjitha fondet dhe forcat qeveritare u çvendosën tek tuneli i Qafë-Krrabës dhe rrugës së re Tiranë-Elbasan! Gjithësesi, mosndërtimi i kësaj rruge, shkon në faturën e mosrealizimeve të qeverisë së mëparshme.

Qeveria aktuale nuk ka dhënë deri më sot as shenjën minimale se do të mbaj premtimin ndaj dibranëve në vitin 2013 se ***“sapo të vinte në pushtet do të bënte realitet ëndrrën e tyre dhe do të ndërtonte më në fund “RRUGËN E ARBRIT”!*** Kryeministri aktual kishte deklaruar se e shihte «Rrugën e Arbrit» ***«si një projekt kombëtar shumë të rëndësishëm për Shqipërinë»*** dhe kishte përsëritur tri herë, se në se do të fitonte, prioritet i qeverisë së tij do të ishte: ***«Rruga e Arbrit, Rruga e Arbrit, Rruga e Arbrit!»,*** të cilën do ta përfundonte ***«brenda mandatit të parë qeverisës!».*** Përkundrazi, tani pas më shumë se tre vjetësh, qeveritarët “rilindas” pohojnë se nuk e kanë ndërmend ndërtimin e kësaj rruge, pasi ***“kushton shumë!”*** dhe se gjithçka që është thënë, ka qenë thjesht një mashtrim elektoral! Këtë deklaratë cinike, e lexoi në interpelancën parlamentare të 9 qershorit 2016 në Kuvendin e Shqipërisë, me qetësi dhe dashuri, ish ministri i kollarisur i transporteve, mësuesi i anglishtes Haxhinasto! Pa u skuqur dhe pa u zverdhur, pa iu dridhur zëri dhe pa i lëvizuar asnjë nerv në fytyrën e mbushur dhe të lëmuar! Duket se ai e kishte harruar kohën kur udhëtonte edhe vetë në rrugën Tiranë-Peshkopi, si mësues i anglishtes në fshatin Grevë të Peshkopisë.

(Vijon në faqen 6)

Rruga e Arbërit nr. 125
analizë

«Rruga e Arbrit», është rruga e tretë antiko-mesjetare më e rëndësishme në hapësirën shqiptare, pas Via Egnatias dhe asaj Lissus-Naissus, një rrugë e shkurtër dhe mjaft strategjike që lidhte Adriatikun me brendësinë kontinentale të Ballkanit, ose Dibrën me Dyrrahun.

"Rruga e Arbrit" apo "Rruga e Sizifit"?!

(Vijon nga faqja 5)

Se çfarë lidhje ka një mësues i anglishtes me Ministrinë e Transporteve dhe ndërtimin e rrugëve, kjo është e vështirë për t'u kuptuar! Por thelbi nuk është ky! Madje kjo pyetje është krejt e panevojshme, pasi në të vërtetë, gjatë 3 viteve të kësaj qeverie, nuk janë ndërtuar as edhe 3cm të kësaj rruge! Kështu që edhe po t'i kishte njohuritë inxhinierike ky ministër, ato nuk do t'i hynin në punë në asnjë sekond të sundimit të tij ministror! Pyetja thelbësore është: Si është e mundur të harrohen aq lehtë premtimet e bujshme elektorale në Pallatin e Kulturës "H. Stërmilli" Peshkopi dhe në gjithë fushatën elektorale të vitit 2013 mbi "Rrugën e Arbrit"?!. A e dinë qeveritarët tanë se tradicioni dibran besën dhe mbajtjen e fjalës së dhënë e ka të shenjtë, ndërsa thyerjen e saj e konsideron sakrilegj?! A do të mundet të justifikohet dështimi spektakolar në ndërtimin e rrugëve, dhe sidomos në Rrugën e Arbrit, me ndryshimin e Ministrit të Transporteve, pra me zëvendësimin e mësuesit të anglishtes Haxhinasto me mësuesin tjetër të anglishtes Dervishaj, veprim që tregon në të vërtetë shkallën e interesimit të qeverisë aktuale për rrugët në përgjithësi dhe për Rrugën e Arbrit në veçanti?! Tashmë është e qartë se qeveria e "rilindjes", nuk ka dëshirë dhe vullnet të ndërtoj "Rrugën e Arbrit"! Pasi kur ka vullnet, ka edhe zgjidhje!.

Akti i fundit i «komedisë» mbi «Rrugën e Arbrit» u luajt në ditën e 23 gushtit 2016, në Pallatin e Sportit «Bashkim Lala» në Peshkopi! Edhe pse asnjë nga premtimet e para tre vjetëve nuk ishte mbajtur, asnjë në mënyrë kategorike, Kryeministri i vendit me stilin e tij senekian («populli beson çdo lloj gënjeshtre që i serviret»), mundohet t'i trullosë mendjet e njerëzve me alogjizma eklektike! ***« Përsa i përket Rrugës së Arbrit…*** deklaroi ai***…që në 20 e ca vjet, të gjithë e kemi premtuar dhe nuk e kemi bërë. Unë e kam premtuar, por akoma nuk mund të thoni që nuk e kam bërë…..por unë po ju them këtu, që unë nuk do të largohem nga zyra e Kryeministrit, pa bërë Rrugën e Arbrit»!***[14]. Ndërkaq, nuk u tha asnjë fjalë për planet e qeverisë së tij për HC e Katundit të Ri dhe të Skavicës dhe përmbytjen e afërt të Dibrës! Të ndodhur para një sofizmi të tillë kryeministror, dibranët fjalëpak dhe të matur, mbetën pa fjalë! Disa u habitën nga elokuenca e tij, madje edhe e duartrokitën, disa të tjerë dyshonin tek arithmetika e tij, disa të tjerë shpresonin të kishte zgjedhje për çdo vit në Dibër, pasi vetëm atëherë qeveria kujtohej se edhe Dibra ishte në Shqipëri(!), por të gjithë mbetën të zhgënjyer, pasi nuk mund të mos kujtonin premtimin e tij të tre viteve më parë mbi *«Rrugën e Arbrit», që do të ndërtohej brenda mandatit të parë qeverisës!»*.

Meqë mandati i kësaj qeverie mbaron në qershor të vitit 2017, i bie që tani duhej të kishte përfunduar ndërtimi i kësaj rruge dhe të ishte kaluar në fazën përmbyllëse që lidhet me degëzimet (exitet), kanalizimet,vijëzimet dhe sinjalistikën!. Por në të vërtetë, asgjë e tillë nuk ka ndodhur! Ajo që ka ndodhur, është që pas ardhjes në pushtet të qeverisë së «rilindjes», menjëherë u ndërprenë punimet e filluara nga qeveria e mëparshme në lotin "Qafë-Buall-Plan i Bardhë-Ura e Vashës", rruga u braktisë, u hoqën të gjitha maqineritë nga puna, dhe në këtë rrugë nuk u pa më asnjë punëtor dhe nuk u lëviz asnjë lopatë zhavorr! Ndërsa dibranët pyesnin të habitur se ç'po ndodhte me rrugën e tyre, njerëz afër pushtetit përpiqeshin t'i bindnin, që



fajet për këtë ndërprerje i kishte kompania kontraktuese kineze *"China State Construction Company"*, që paska kërkuar një projekt të ri fizibiliteti etj!.

Megjithatë, dibranët do të duhej të kuptonin më në fund, se edhe pse «Rruga e Arbrit» nuk ishte bërë, fajet për këtë nuk mund t'i kishte qeveria e «rilindjes», por ajo tjetra, e mëparshmja, që na paskësh lënë borxhe të mëdha, dhe se pikërisht për këtë arsye, pra për borxhet e lëna prej tyre, qeveria aktuale nuk kishte bërë asgjë për Dibrën! Cilado qoftë e vërteta, dibranët deshën ta pyesnin Kryeministrin nëse në fushatën e ardhshme zgjedhore, do të vinte në Dibër nga «Rruga e Arbrit» apo nga liqeni i HC të Skavicës?! Nuk e pyetën me fjalë, e lanë të kuptohet! Se kodi i mikpritjes nuk i lejon që mysafirit të lartë t'i bëhen pyetje të sikletshme «alla dibrançe», për më tepër në takime të tilla festive të mbushur me «fitorje» imagjinare! Se kjo mund të mërziste atë, dhe atëherë mallkimi mund të binte mbi mikëpritësit, si rrufetë e Zeusit mbi Prometheun!

Gjithësesi, duket se dibranët nuk e kanë kuptuar ose nuk duan t'a kuptojnë thelbin e mosndërtimit të "Rrugës së Arbrit"! Disa thonë se premtimet për ndërtimin e kësaj rruge strategjike ishin "lojë"!. Disa thonë se fajin për këtë e kishte qeveria e Kinës! Disa të tjerë thonë, se edhe po të mos e kishte qeveria kineze, pra kushdo që ta kishte fajin, kjo rrugë tashmë nuk do t'u duhej! Pasi, shumë shpejt, në emër të "dashurisë" qeveritare, dibranëve do t'u përmbyteshin shtëpitë dhe trojet dhe Dibra do të kthehej në një liqen të stërmadh, që nga Mireshi në jug deri në Skavicë në veri! Disa të tjerë thonë se paskan dëgjuar të flitet edhe mbi gjoja bashkimin e liqenit të HC të Spilesë në Dibrën e Madhe, që u përmbyti dibranëve të Shehërit Fushën e Udovës, bashkë me qytetërimin antik që ajo ruante në gjirin e saj, me liqenin e HC të Katundit të Ri dhe Skavicës në Dibrën e Vogël! Të paktën mendonin ata, kështu do të mund të bashkoheshin më në fund me anë të këtij liqeni të dy Dibrat, ajo e Epërmja dhe e Poshtmja, të ndarë nga shkau dhe miqtë e tyre evropianë, qysh para 100 vjetësh! Por për të mundësuar këtë, dibranët e Dibrës së Poshtme do të duhej të lejonin qeverinë që t'ua përmbyste jo vetëm shtëpitë dhe trojet, por edhe tokat dhe livadhet, edhe pyjet dhe pasuritë, edhe kishat dhe xhamitë, edhe varret e të parëve dhe ato të luftëtarëve, edhe historinë dhe kulturën, edhe toponimet dhe gjithçka tjetër që lidhet me kujtesën historike të një populli! Mundësisht edhe këngët, që sikur duan t'u thonë brezave më të rinj se medemek *"në Dibër qenka bërë luftë e madhe kundër shkaut!"*, se *"deri n'Stamboll ka shkue fjala, qe nantë vjet luftojmë me krajla!"*. Se medemek, *"gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, me pushkë me gjalm, e paskan ndalur shkaun që "u kishte ardhur tek dera" dhe e paskan shpëtuar Dibrën!"* Mjaft më dibranët na ishin mbajtur në të madh, sikur *"Dibra paska qenë qendra e Shqipërisë natyrore"*, dhe se në të gjitha momentet kyçe për Historinë e Shqipërisë, *"zgjidhjet paskan ardhur pikërisht nga Dibra!"* Sikur Dibra të paskësh qenë Piemonti i Shqipërisë! Dhe kur kjo Dibër të flejë nën ujrat e liqenit(!) (në se populli do t'a lejoj të ndodhë (!), atëherë dibranëve nuk do t'u hynte më në punë "Rruga e Arbrit"! Atëherë do të ishin më praktike varkat e lundrimit në këtë liqen të stërmadh, që nga Skavica deri në Dibër! Mendjemprehtë dhe racional, dibranët tashmë duhej vetëm të arsyetonin me pragmatizëm dhe të pranonin zgjidhjet që u ofronte qeveria! Madje disa prej tyre, kishin filluar të shijojnë pragmatizmin e momentit, të paktën që nga shtatori i këtij viti! Vetëm mendjengushtët dhe të pabindurit, dhe siguricht njohësit e historisë së Dibrës dhe ata që e donin vërtetë Dibrën, akoma nuk e kishin kuptuar apo nuk mund t'a kuptonin thelbin e mosndërtimit të "Rrugës së Arbrit"!

Ç'TË BËJMË?

Kjo pyetje më kujton kohën e fakultetit(1973-1977) kur në një seminar të "Historisë Moderne" duhej të konspektonim tre broshura të Leninit, përkatësisht "Shtetet e Bashkuara të Europës", "Një hap para, dy hapa mbrapa" dhe "Ç'të bëjmë?". Shkon një student në bibliotekë dhe e pyet punonjësen e saj në se i kishte broshurat e kërkuara sipas radhës. Për dy broshurat e para, punonjësja iu përgjigj se nuk ishin në bibliotekë, pasi i kishin marrë studentë të tjerë. "Po, ç'të bëjmë?" e pyet studenti, dhe përgjigjia nga ana tjetër e xhamit erdhi e menjëhershme: "Bëj ç'të duash!", pa e ditur se "Ç'të bëjmë?" ishte një nga broshurat e kërkuara!

Tani është radha e popullit të Dibrës, që me zgjuarësinë e tij, do të dij "ç'të bëj" për të mos lejuar që t'u përmbyten shtëpitë dhe trojet dhe që "Rruga e Arbrit" të mos mbetet më si "rruga e Sizifit"! Të marin vetë në dorë fatin e tyre, të mbrojnë Dibrën nga përmbytja dhe shpopullimi dhe të mundësojnë ndërtimin e "Rrugës së Arbrit"!

Tani është radha e popullit të Dibrës, që me zgjuarësinë e tij, do të dij "ç'të bëj" për të mos lejuar që t'u përmbyten shtëpitë dhe trojet dhe që "Rruga e Arbrit" të mos mbetet më si "rruga e Sizifit"!

NË VEND TË MBYLLJES

Meqenëse për 25 vjet politika postkomuniste shqiptare, ka qenë e pandjeshme ndaj interesave jetike të Dibrës, meqenëse për 25 vjet, nuk u mundësua ndërtimi i "Rrugës së Arbrit", një rrugë e rëndësishme dhe strategjike jo vetëm për Dibrën, por për të gjithë Shqipërinë Veriqëndrore dhe rajonin, meqenëse kjo klasë politike, pa formimin dhe pjekurinë e nevojshme, kërkon të luaj dhe aktin e fundit të tragjedisë dibrane, duke përgatitur përmbytjen e Dibrës nga liqeni i HC të Katundit të Ri dhe të Skavicës, dhe për rrjedhojë braktisjen dhe shpopullimin përfundimtar të saj, atëhere për dibranët ka vetëm dy alternativa:

a. T'u besojnë premtimeve elektorale periodike të politikanëve të tipit "sine cura" dhe të ngopen me lugën bosh!
b. Të marin vetë në dorë fatin e tyre, të mbrojnë Dibrën nga përmbytja dhe shpopullimi dhe të mundësojnë ndërtimin e "Rrugës së Arbrit"!

Alternativa e parë është nënshtrim, e dyta është betejë. Për fitoren e kësaj beteje ka vetëm një rrugë demokratike:

a. Protesta masive deri në tërheqjen e qeverisë nga planet për ndërtimin e HC të Katundit të Ri dhe të Skavicës!
b. Bojkotim i plotë i të gjitha llojeve të zgjedhjeve politike në Shqipëri deri në ndërtimin e "Rrugës së Arbrit"!

---

[1] A. Bunguri, *Prehistoria e Dibrës,* Tiranë 2010, 261-267.

[2] V. Shtylla, *Rruga e Arbërit-rruga kryesore e vendit, krahas rrugës Egnatia që në lashtësi,* Rruga e Arbërit, Tiranë, 2007, 9.

[3] Anna Comnenae Porphyogenetae, Alexias, A. Reifferscheid I-II Lipsiae B.G. Teubneri, 1884.

[4] K. Bozhori-F. Liço, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë(shek. V-XV),* Tiranë 1975, 2, 103; Ana Komnena, *Kalimi i Boemundit në krahinat e Maqedonisë perëndimore, vëll. I,* libri V, 5; Po aty, 115. *Zbarkimi i Boemundit në bregdetin shqiptare* (1107) vëll. II, libri XII, 8, 9.

[5] K. Bozhori-F. Liço, *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. V-XV),* Tiranë 1975, 2, 157.

[6] *Idem*, 157.

[7] V. Sadiku, *"Mëhalla e dibranëve", një histori e Tiranës,* Gazeta „Koha", e përditshme informative, 17.09. 2016.

[8] H. Likdisha, *Miniera, një histori suksesi, abuzimi dhe varfëria*, "Rruga e Arbërit", nr. 106, f. 2.

[9] *Idem*, f. 2.

[10] A. Tufa, *Nderi i humbur i deputetëve të Dibrës,* Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 122, 7; "Panorama" 27.06. 2016.

[11] H. Likdisha, *Miniera, një histori suksesi, abuzimi dhe varfëria,* "Rruga e Arbërit", nr. 106, 2.

[12] A. Ashiku, *Intelektualët dibranë me gojë të mbyllur me dry,* ABN, 1 korrik 2016.

[13] A. Ashiku, *Rruga e Arbërit si Rrugë e lindvdekur,* Gazeta "Rruga e Arbërit", nr. 120, 8.

[14] B. Karoshi, *'Rruga e Arbërit, premtim i pambajtur i qeverive në 20 vite,* Gazeta "Rruga e Arbërit", nr. 124, 2.

portret

Afrim Murrja e bazon punën e tij tek kontratat serioze e jo te gjërat e rastësishme e spontane. Ka kontratë për shitjen e qumështit me spitalin e Peshkopisë...

Afrim Murrja, një shkollë për blektorët e rinj

Nga **OSMAN XHILI**

Në vitin 1992, Afrim Murrja nga fshati i vogël Selane, buzë Drinit, punonte në tregti si ekonomist kontabël. Ato ishin ditët e fundit të punës së tij në atë sektor, pasi gjërat po shkonin drejt shkatërrimit total. Ai ishte në dilemë nëse duhej të punonte atë pak tokë që kishte në fshat, apo të merrte rrugët e kurbetit? Cilën rrugë të ndiqte për të mbajtur familjen? Apo ndoshta mund të kishte një të tretë, më të përshtatshme se që të dyja ato.

Afrimi tregon se në vitin 1993 u shpërndanë ca lopë e mëshqera nga ferma që ishte caktuar për byronë politike të kohës. Dikush, kishte marrë një mëshqerë prej tyre, të rracës Holenshtein dhe donte ta shiste. Blerësi i ri ishte Afrim Murrja, kundrejt një shume prej 35 mijë lekësh. Krejt rastësisht, një mjek veteriner e kontrollon dhe arrin në përfundimin se ajo ishte barse. Përse të mos e mbante atëherë? Të paktën, fëmijët e tij të vegjël, qumësht e bulmet do të kishin me shumicë.

Afër punës së tij kishte pasur stallat e grumbullimit dhe një njeri të shkëlqyer, Xheladin Zenelin. Prej tij kishte përfituar shumë gjëra dhe mes të tjerash, dëshirën për të punuar me kafshët, kujdesin që duhej treguar për to. Mëshqera e blerë kishte qenë këmbëmbarë. Ajo u bë si pjesëtare e familjes dhe bëri plot 15 viça, nga të cilët, 12 mëshqera dhe tre mëzetër. Pati një prodhim mesatar prej 22 litrash në ditë dhe përqindje të yndyrës 4,6 . Që atëherë , u rrit dhe u rrit numri i krerëve, për të shkuar në mbi 100 lopë qumështi e viça për majmëri.

Afrimi e menaxhon me kujdes dhe siguri fermën e tij. Ai thotë se 40 përqind e suksesit është rraca, dhe pjesën tjetër e përbën sasia dhe cilësia e racionit ushqimor, kushtet e stallës, shërbimet dhe faktorë të tjerë. Në fermën e tij angazhohet e gjithë familja, katër punëtorë definitivë dhe dhjetë të tjerë, me punë sezonale. Afrimi kërkon prej tyre përkushtim maksimal , por dhe i trajton me respekt. Shumë i rregullt në shlyerjen e pagesave, bile në raste festash jep shpërblime e dhurata të ndryshme.

Për të përballuar nevojat ushqimore të



- Nga një mëshqerrë në vitin 1993, tani ferma e tij shkon në mbi 100 krerë: një biznes familjar që synon të zgjerohet vazhdimisht...
- 40 përqind e suksesit është rraca, dhe pjesën tjetër e përbën sasia dhe cilësia e racionit ushqimor, kushtet e stallës, shërbimet dhe faktorë të tjerë.
- Në fermën e Afrim Murrës angazhohet e gjithë familja, katër punëtorë definitivë dhe dhjetë të tjerë me punë sezonale.

fermës, ka marrë gati 30 hektarë tokë me qera. Ai e njeh mirë tokën , përmbajtjen dhe vlerat e saj. Ka ndryshime nga njëra zonë e mikrozonë , tek tjetra. Toka e Dohoshishtit, - thotë Afrimi, është për qumësht, - kurse ajo e Çapit të Brezhdanit, është për mish, ndaj dhe kavaletat e jonxhës i ka të ndara, sipas destinacionit. Për ta menaxhuar sa më mirë këtë sipërfaqe toke, krahas zetorit që e përdor prej vitesh, ka blerë makineri në vlerën e 85 mijë eurove, i ndihmuar dhe nga fondet e Ipard like. Një korrëse bari, një mbledhëse, një makineri për balla jonxhe dhe një kultivator misri, janë arsenali i ri, që do t'ia lehtësojnë më shumë punën në të ardhmen.

Krahas prodhimit të qumështit e të djathit, Afrimi e sheh trajtimin e viçave për mish, si një burim shumë fitimprurës . Ai ka një kontratë me një thertore dhe viçat, që kanë një peshë 50 kilogramë në lindje, i skarton në moshën 6 muajshe, kur arrijnë peshën 5 - 6 kunjtalë, apo nga njëherë dhe më shumë. Eksperimente të shumta ka bërë në drejtim të majmërisë, për të parë se cila dietë, apo mënyrë trajtimi është më e mira. Viçat e tij shtojnë mesatarisht 40 kilogramë në muaj, me kusht që të pijë 7 kilogram qumësht, për tre muaj rresht. Viçat i ndan në moshën 3,5 muaj, duke u reduktuar qumështin, deri në 0,5 kilogram , në ditën e fundit. Kur kalon nga qumështi në ushqim të plotë, nuk ka shtesë peshe për një periudhë dy javore. Uji për ta është i vazhdueshëm, kurse ushqimi është një kombinim misri, thekri, gruri, hime, jonxhe, dhe ky pa limit, sipas dëshirës dhe oreksit të tyre.

Nga një tjetër eksperiment i ri, rezulton se shtesa mujore e viçit, mund të shkojë dhe 70 kilogramë, por për këtë duhen plotësuar dy kushte. Ai duhet të jetë me peshë 250 kilogramë dhe të pijë jo më pak se dhjetë litra qumësht në ditë.

Afrimi, thuajse , nuk ka dëmtime në blektori, as në lopë e as në viça. Në eksperiencën gati çerek shekullore me fermën e tij , ka mësuar shumë formula e sekrete dhe gjithë konvejeri i punës , lëviz si një makineri perfekte. Veç kësaj, ai fal nga këto produkte, bën kurbane mishi dhe jep sadaka. Të gjitha këto mblidhen së bashku e gjenerojnë ato vlera që janë të prekshme e reale.

Por, Afrim Murrja, ndonëse trupimët e ndoshta me jo shumë fuqi trupore, gjeneron nje energji të habitshme. Ai nuk ka të ndalur në synimet e tij. Ai e bazon punën e tij tek kontratat serioze, e jo te gjërat e rastësishme e spontane. Ka kontratë për shitjen e qumështit me spitalin e Peshkopisë, kontratë me thertoren për viçat, kontratë për djathin, apo dhe për tokat që merr me qira. Të gjitha këto i japin qetësi e siguri biznesit të tij, duke parë me besim nga e ardhmja. Shumë shpejt, sapo të çlirohen lejet e ndërtimit, mendon të shtojë dhe një stallë tjetër e kjo do ti dyfishojë automatikisht shifrat: numrin e krerëve , produktet , si dhe numrin e të punësuarve.Mendon të bëjë dhe një baxho qumështi, pasi aty ka një burim uji me një temperaturë konstante prej nëntë gradësh,dimër dhe verë. Po në atë vend, ka qenë më parë një fabrikë djathi e sallami, pra ideja e Afrimit nuk është utopi, por një realitet i prekshëm.

Afrimi ka tre djem të mrekullueshëm, punëtorë, inteligjentë, të sjellshëm dhe besimtarë. Emrat u fillojnë që të treve me "E". Ervisi, më i madhi, ka mbaruar për financë bankë, Elvini ka mbaruar gjimnazin dhe don të studjojë për inxhinjeri, kurse i treti ndjek një shkollë profesionale në Shkodër. Ata janë një garanci se puna e babait të tyre, jo vetëm që nuk do bjerrë, por do të ngjitet akoma më tej në nivele profesionale. Ferma e tyre, me madhësinë dhe seriozitetin e saj, ka shërbyer e do shërbejë si një shkollë për blektorët e rinj dhe fermat e reja në qarkun e Dibrës.



- Afrim Murrja e bazon punën e tij tek kontratat serioze dhe jo te rastësia. Ka kontratë për shitjen e qumështit me spitalin e Peshkopisë, kontratë me thertoren për viçat, kontratë për djathin, apo dhe për tokat që merr me qira. Të gjitha këto i japin qetësi e siguri biznesit të tij
- Ferma e tyre, me madhësinë dhe seriozitetin e saj, ka shërbyer e do shërbejë si një shkollë për blektorët e rinj dhe fermat e reja në qarkun e Dibrës.



Rruga e Arbërit nr. 125



Turizmi në Dibër, një potencial ekonomik i pashfrytëzuar

Milva Ekonomi, Ministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ishte në Dibër më 30 shtator, gjatë një veprimtarie kushtuar turizmit në Dibër.

Pas një ekspozeje lidhur me zhvillimin e turizmit në vend dhe të ardhmen e saj dhe rolin në ekonominë kombëtare, ajo foli edhe për turizmin malor, si një destnacion turistik në rritje në qarkun e Dibrës.

Nga muret e kalasë së Grezhdanit në Peshkoi një atraksion turistik i zonës, ministrja Ekonomi tha se "kryesfida jonë mbetet turizmi gjithëvjetor, që do të thotë se ne duhet ta shtojmë vëmendjen, mbështetjen dhe promovimin e turizmit malor në mënyrë që zonat malore të marrin zhvillim".

Për turizmin malor tha ministrja Ekonomi duhet të punohet më shumë.

"Disa vite më parë ne thoshim që: "për ne turizmi është deti. Ne kemi një pasuri shumë të madhe, që është uji dhe bregdeti". Por kemi kuptuar që Shqipëria është e tëra e mbushur me pasuri natyrore dhe ne mund të përfitojmë duke filluar nga kodrat e bukura, por edhe nga lartësitë përmbi kodër, që janë gjithashtu shumë të bukura. Por, për çfarë do të përdoren? Ato mund të përdoren për ecje në shtigje, ndaj dhe iniciativat rajonale që ju zona juaj ka për të lidhur me një shteg të përbashkët malet e Maqedonisë, Kosovës, Shqipërisë janë iniciativa shumë të mira që duhen çuar edhe më tej dhe duhen promovuar", - u shpreh Ekonomi.

Duke u ndalur në potencialet turistike të Dibrës, Ekonomi tha:

"Gjithashtu, ju keni dhe mundësinë që të ofroni një burim tjetër natyror, siç janë ujërat termalë, të cilat duhen standardizuar me produkte të barabarta me vende të tjera të rajonit ose europiane. Përveç kësaj, ju keni dhe mundësi të ofroni turizmin e aventurës, falë burimeve ujore që padyshim ndihmon në shtimin e numrit të vizitorëve. MZHETTS do të jetë gjithmonë në krahun tuaj për ta nxitur këtë dimension të ri të zhvillimit ekonomik për rajonin, do të jetë aty për të dhënë mbështetje në iniciativat e reja të sipërmarrjes, duke i mbështetur ato me projekte sipas nevojave dhe mundësive".

Një falenderim të veçantë ministrja Ekonomi bëri për Qeverinë Gjermane, e cila nëpërmjet GIZ -bashkëpunimi teknik gjerman, po jep asistencë dhe kontribut në zhvillimit e turizmit malor në vite në Shqipëri, si dhe për shumë donatorë të tjerë që kanë orientuar projektet e tyre nga zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit rural dhe kulturor.

KRYEBASHKIAKU MUHARREM RAMA: DIBRA ME POTENCIALE TË FUQISHME TURISTIKE

Ndërsa kryebashkiaku Muharrem Rama tha se "Dibra ka resurse turistike të shumta.

> "Turizmi do të ketë prioritetet e veta gjatë kësaj periudhe, pasi turizmi malor është për të gjithë vitin. Ne kemi mbështetjen tuaj dhe të qeverisë shqiptare për një projekt për ujërat termale, duke e kthyer këtë zonë në një zonë shumë atraktive, ku prioriteti ynë është rritja e numrit të turistëve".

Ardhja e Ministres Milva Ekonomi na jep një shtysë më tepër në bashkëpunimin me Zyrën Gjermane, gjithashtu dhe me ardhjen time si kryebashkiak do të kemi një bashkëpunim shumë të frytshëm për ta zhvilluar Dibrën, për ta bërë një zonë turistike ashtu siç e meriton.

"Turizmi do të ketë prioritetet e veta gjatë kësaj periudhe, pasi ky lloj turizmi nuk është dy muaj që bëhet plazhi, turizmi malor është për të gjithë vitin.

Ne kemi mbështetjen tuaj dhe të qeverisë shqiptare për një projekt për ujërat termale, duke e kthyer këtë zonë në një zone shumë atraktive, ku prioriteti ynë është rritja e numrit të turistëve. Përveç llixhave kemi dhe shumë zona të tjera, si kisha, xhamia, kalaja e Grezhdanit, kemi projekte me kalanë e Dodës, me Lurën që në të ardhmen bashkë me mbështetjen tuaj dhe projektet gjermane do t'i bëjmë realitet, ta bëjmë Dibrën një zonë të fuqishme turistike" - tha kryebashkiaku i Dibrës Muharem Rama.

INAUGUROHEN PIKAT E INFORMIMIT

Gjatë qëndrimit në qytetin e Peshkopisë, Ministrja Ekonomi së bashku me kryebashkiakun Muharrem Rama inauguruan katër Info-Pointe në gjuhën shqipe dhe angleze që do t'u vinë në ndihmë turistëve. E nisim me Dibrën, - tha Ministrja Ekonomi për ta vijuar, me vendosjen e 60 të tjerave në qytete të tjera të Shqipërisë, të realizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit.

GIZ -Bashkëpunimi Teknik Gjerman i dhuroi Bashkisë së Dibrës 10.000 harta të printuara me të gjitha destinacionet turistike të zonës, në mënyrë që aksesi në to të jetë sa më i lehtë.

Ndërsa në një panair me produkte dhe ushqime të zonës Ministrja Ekonomi inkurajoi prodhuesit lokalë të aplikojnë për fonde mbështetje pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Opinion

Ikja e Profesorit!

Nga AGIM KASA

Tashmë që zgjedhjet në Dibër mbaruan dhe kandidatët morën pagëzimin e merituar, për të cilën luftuan duke dalë nga kjo betejë politike, dikush si fitues e të tjerë si humbës, po ndalem vetëm te njëri prej tyre, prof. Sherefedin Shehu.

Kandidimin e tij mirëprita, sepse ia njihja cilësitë profesionale, aq të domosdoshme për një administrator, por kandidimi i tij më shtoi edhe më shumë respektin, sepse linte një karrige më të lartë politike për të marrë një tjetër më afër halleve të popullit.

Do të përpiqem shkurt e qartë të theksoj se pse kandidimi i tij më gëzoi dhe pse humbja nuk më hidhëroi.

E kam ndjekur në mjaft takime elektorale ku Sheu nuk foli as një ditë të vetme për hallet e dibranëve. Dibra nga paraardhësi i familjes së tij politike, tre herë i mandatuar, ishte kthyer në një gjysëm qytet e gjysëm fshat. Ato pak lulishte që ne të ikurit kishim lënë, ishin zënë e rrethuar me tela gabian për kotec pulash, turrë drush e gjithfarë ndërtimesh ku vetëm haure lopësh nuk ishin bërë. Bulevardi i Blinëve" u kthye në parking makinash, rrugët ishin ngushtuar deri në frymëzënie derisa kryebashkiaku i ri i majtë, me mungesë vizioni, bëri atë që askush nuk e priste.

Fjalët e Shehut ngjitnin kur flitej për pastrimin e atij qyteti të zënë në zhul , rregullimi i territorit, lirimi i lulishteve dhe mbjellja e tyre me trëndafila si dikur e të tjera nga këto, e sa për moralin në administratë nuk ishte e nevojshme as edhe një fjalë si diçka e turpshme të flisje para jush.

Në dalje të qytetit, rrugës drejt fshatit tuaj të lindjes Sllovë, ka qenë dikur zdruktharia e re, një ndërtim modern për kohën, Fabrika e Prodhimit të mobiljeve shumë cilësore jo vetëm për Peshkopinë, e mbyllur për t'u kthyer në Fabrikë Pije frutash. Mendoja se mu aty kishe një mijë e një arsye për t'u takuar me biznesin e qytetit e pse jo edhe me qytetarë, por nuk e bëre as këtë, e t'u shpjegoje se mbyllja e një ish fabrike druri me gjithë të këqiat se u shkurtuan vende pune, prodhimet e të cilave kishin treg, sillte të mirën tjetër se shpëtoi pyjet nga asgjësimi, por ama edhe kthimi i saj në Fabrike Pije frutash ishte ndoshta më e mira gjë për zhvillimin e frutikulturës. Dibra i është rikthyer investimeve në pemëtari, janë ngritur blloqe të reja pemësh frutore me mollë e qershi e zhvillimi e fuqizimi i industrisë përpunuese duhet të ishte kryefjala e bisedës tuaj. Duhet t'u kishe kujtuar dibranëve se dikur prodhoheshin 80 mijë kv fruta, prej të cilave 4 mijë kv shkonin në eksport, por ju as këtë nuk e bëtë, së paku do të tregoje se nuk i ke harruar. E unë mendoj se duke folur për blegtorinë e pemëtarinë në Dibër njerëzit do t'ju dëgjojnë, e kur do t'ju flasësh se si do t'i mbështetësh ato patjetër që edhe do t'ju votojnë. Por ju nuk e bëtë edhe këtë, e unë shpesh do ta kujtoj. Përse të mos flisje për pyjet dhe kullotat, sektorë ku sherret janë vërtet të mëdha?!

Ju nuk takuat as banorët e "Prroit të Llixhave". Janë një komunitet jo i vogël, por rreth 2 mijë familje, të cilët as për meritë të së majtës, as për meritë të së djathtës kanë ngritur e fuqizuar biznesin familjar të lidhur ngushtë me ujërat termale apo Llixhat, siç i quajmë ne. E dije se edhe ata e kanë një hall e jo të vogël, biznesi i tyre është i kërcënuar nga Përroi i Bellovës e ju si kryebashkiak mund të bënit diçka për ta sistemuar atë përrua që ata ta ndjejnë veten më të mbrojtur, se ndaj fenomeneve natyrore askush nuk është i imunizuar. E përse të mos ju flisje edhe për taksa që duhet të derdhin, se dikush duhet të paguajë në atë qytet, që qyteti të jetë më i pastër. Keq më vjen: nga çfarë shikoja, i lumi unë, - nga çfarë dëgjoja, i mjeri unë.

Një tjetër takim mund të kishit bërë me komunitetin e artistëve, sportistëve e ato pak intelektualëve të mbetur atje, ju vini nga një vend arsimdashës, ku përpara se të jeni besimtar në fe, ju jeni besimtar në shkencë dhe kulturë, e ju jeni veçse njëri prej tyre që jeta ju ka përkëdhel, keni studiuar në ekonomi dhe kualifikuar në shkallë superiore. Një takim për t'i dëgjuar ata, por ju as këtë nuk e bëtë. "Oda Dibrane" tashmë një traditë, por edhe Korabi në superiorë si risi do ta lidhnin mirë e bukur jetën kulturore dhe artistike të qytetit në takimin tuaj, siç volejbolli femra dhe mundja nuk janë fjalë apo histori të së shkuarës, por është një zjarr që djeg. Veli Vraniçi – ky Mjeshtër i Madh apo Përparim Tomçini gjithashtu një kompozitor e muzikant i madh nuk janë poshtë jush nga formimi kulturor. Do ta kishim zili një takim të tillë mes dibranësh, por ju nuk e mundësuat këtë. Në teatër e estradë shkojnë të gjithë; të majtë e të djathtë, e nuk ndahen si në kishë apo xhami.

Unë ju fola për halle të vogla, por që në jetën e përditshme janë të mëdha dhe të rënda për një qytet të vogël si Peshkopia, por që janë punë e kryebashkiakut. Dibra ka halle dhe më të mëdha, të cilat ju nuk mund t'i zgjidhni. "Rruga e Arbrit" nuk është një shëtitore, por është një arterie që bashkon kombin, gjithashtu edhe Kaskada e Drinit, ku kryefjale është Skavica apo nën bijat e saj nuk është punë hurdhash nga ato ku laheshim dikur fëmijë e fjala juaj është vetë zëri i Dibrës, por këto janë vërtet gjëra të mëdha dhe jashtë autoritetit tuaj vendimmarrës ...

Për të gjithë këto arsye faleminderit që pranove përgjegjësi. Më gëzove, por një mijë herë faleminderit që nuk u votove, ndaj edhe nuk u hidhërova. Dibranët edhe një herë treguan se janë një popull i mençur. Pak ditë para votimeve, një mik Dibre nga Reçi më thotë me mesele se ai që ka vulën të vë edhe kësulën, duke nënkuptuar se kandidati i majtë do të fitonte, kur dëshira e të dyve ishte që fitues të ishit Ju, por më mirë që u zhgënjyem ne e kjo vërtet nuk është çështje vule e ksule e më mirë që vulën e kësulën e vu Dibra.

Edhe një gjë, në humbjen tuaj mos ngatërro askënd. Ajo ishte e juaja dhe vetëm e juaja personale. Ju nuk biseduat me ta si një djalë shtëpie. Ngushëllohu që nuk arrite të vetvotohesh.

Humbja është e rëndë dhe unë ju uroj veçse kurajo, ndërsa fituesit i uroj që të punojë me përkushtim e vendosmëri, për të nisur për Peshkopinë një epokë e re.

Zgjedhjet në Dibër: Kandidati i majtë Muharem Rama fiton bindshëm kreun e bashkisë së Dibrës. **Kryeministri Rama:** "Ne do të bëjmë për Dibrën më shumë se çfarë bënë të tjerët në 20 e ca vite të marra së bashku".

Kryeministri Rama: "Dibra i ka dhënë mend gjithë Shqipërisë"



Në foto: Kryeministri Edi Rama dhe kryetari i ri i bashkisë së Dibrës, Muharem Rama.

EDI RAMA:

"Dëshiroj të nënvizoj se këtë fitore të madhe unë e lexoj mbi të gjitha si një detyrim shumë të madh ndaj dibranëve. Me mirënjohje të thellë, angazhim të madh e përunjësi në detyrë, ne do të bëjmë çmos të jemi në lartësinë e nderit të posaçëm që na bëri Dibra, me besimin e paçmueshëm që na dha sot".

"Ne i kemi borxhe Dibrës në këto tre vite, duke filluar nga Rruga e Arbrit, e cila është një borxh i vjetër e i mbartur qeveri më qeveri ndaj dibranëve, por ne duhet ta nisim me patjetër brenda këtij viti të fundit të mandatit tonë!".

"Kandidati ynë në çdo sondazh apo kontakt direkt me elektoratin ishte qartësisht i preferuari i dibranëve pa dallim, majtas apo djathtas. Ai komunikoi pastër, thjesht me dibranët dhe për problemet e Dibrës. Nuk premtoi asgjë në hatashme dhe në themelin e zotimeve të veta vuri figurën e vet të pakontestuar në komunitet si një shërbëtor i mirë dhe i ndershëm i njerëzve në nevojë për kujdes mjekësor".

Më 11 shtator 2016, mbi 33 mijë zgjedhës nga 57 mijë të regjistruar në bashkinë e Dibrës iu drejtuan 118 qendrave të votimit për të votuar kryetarin e ri të bashisë. Kandidati i Aleancës së majtë - PS, LSI dhe PDIU, Muharem Rama mori 56.31 perqind të votave (18603 vota), duke u zgjedhur kështu si kryebashkiaku i ri i bashkisë së madhe të Dibrës. Kundërshtari i tij, Sherefedin Shehu, i cili dorëzoi mandatin e deputetit për të marrë postin e kryebashkiakut mori vetëm 14435 vota.

Situata para dhe gjatë zgjedhjeve ka qenë e tensionuar. Gjithë grupi parlamentar i PD dhe aleatët e saj, të sigurt në fitore, ishin përqendruar në Dibër gjatë fushatës, duke bërë jo vetëm një fushatë për kreun e bashkisë, por e përdorën atë si një mesazh për ndryshimin e qeverisë vitin e ardhshëm.

Ndërsa e majta ia besoi drejtimin e fushatës Ministrit Gjiknuri dhe deputetes Gjylameti, ndërsa anëtarë të tjerë të qeverisë si dhe deputetë të saj u angazhuan në Dibër për një fitore të kandidatit Rama.

Risia e këtyre zgjedhjeve ishte përfshirja e PDIU, e cila brenda pak muajsh ka organizuar strukturat e saj, duke e kthyer këtë parti në njërën nga degët kryesore në qark, me premisa që në zgjedhjet e ardhshme të fitojë deri në dy vende në parlament.

Megjithëse rezultati u pranua zyrtarisht nga PD, ajo i gjeti shkaqet e humbjes te angazhimi i strukturave qeveritare në blerjen e votave dhe në lejimin e kultivimit të hashashit. Megjithëse gjatë fushatës kultivimi i kanabisit nuk ishte një temë elektorale, pas fushatës kjo u interpretua si shkaktari kryesor i humbjes. Partia Demokratike ka dorëzuar edhe një kallëzim në prokurori kundër një grupi zyrtarësh lokalë dhe oficerë policie, të cilët akuzohen nga PD se kanë blerë vota dhe kanë manipuluar rezultatin zgjedhor.

Por, ashtu si edhe në të kaluarën, kjo do të mbetet një përjekje për të mos njohur zhvillimin e zgjedhjeve si një proces demokratik.

Të dyja palët gjatë ditës së zgjedhjeve denoncuan tentativat për blerje dhe manipulim votash, por kjo nuk solli rezultate në cënimin e procesit zgjedhor. Diferenca shumë e madhe e votave mbylli çdo shteg për një proces tërësisht manipulativ.

Ky rezultat ka çoroditur analistët dhe vëzhguesit e zgjedhjeve në kryeqytet, por Partia Socialiste dhe Kryeministri e pritën si një fitore të merituar dhe si një mesazh për t'u angazhuar më shumë drejt investimeve në Dibër.

"Dibranët votuan për ne jo se janë të gjithë të kënaqur për çfarë kemi bërë për ta, jo se nuk janë të lëkundur apo të mërzitur, por sepse janë të bindur se ne jemi të vetmit që bashkë me ta do t'i bëjmë gjërat që Dibra pret prej 25 vitesh për ata për të cilët votojnë".

"Fjalët e tepërta janë vërtet fukarallëk, nën dritën e rezultatit kuptimplotë të zgjedhjeve të Dibrës!" - do të shkruante kryeministri Rama një ditë pas zgjedhjeve në faqen e tij në Facebook.

"Dëshiroj të nënvizoj se këtë fitore të madhe unë e lexoj mbi të gjitha si një detyrim shumë të madh ndaj dibranëve. Me mirënjohje të thellë, angazhim të madh e përunjësi në detyrë, ne do të bëjmë çmos të jemi në lartësinë e nderit të posaçëm që na bëri Dibra, me besimin e paçmueshëm që na dha sot", - mbyllte ai komentin një ditë pas zgjedhjeve.

Ndërsa në takimin e falenderimit në Peshkopi më 14 shtator, Kryeministri Rama falenderoi "qytetarët e Dibrës, pa dallim, të cilët morën pjesë në këtë proces demokratik".

"Fitorja e bujshme e kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Europiane është një besim i jashtëzakonshëm që na është dhënë, pas 3 vitesh qeverisje dhe që për ne do të thotë jo një rezultat më i lartë në Dibër, po një detyrim ende më i madh ndaj Dibrës", theksoi Rama.

"Ne i kemi borxhe Dibrës në këto tre vite, duke filluar nga Rruga e Arbrit, e cila është një borxh i vjetër e i mbartur qeveri më qeveri ndaj dibranëve, por ne duhet ta nisim me patjetër brenda këtij viti të fundit të mandatit tonë!".

"Ky besim dhe energji e re që ne morëm me rezultatin e të dielës, tregon mençurinë dhe urtësinë e njerëzve të punës, që bukën e nxjerrin me punë dhe jo me drogë", - tha Kryeministri.

Fitorja e PS në Dibër ishte një çështje shumë e diskutuar nga analistët në Tiranë. Emisione televizive të posaçme u realizuan për këtë çështje, duke rritur paqartësitë rreth asaj që kishte ndodhur në Peshkopi, çka e detyroi kryeministrin Rama, që gjatë një komunikimi javor me publikun me 18 shtator, t'i kushtohej pothuajse plotësisht rastit "Dibra".

"Kandidati ynë në çdo sondazh apo kontakt direkt me elektoratin ishte qartësisht i preferuari i dibranëve pa dallim, majtas apo djathtas.Ai komunikoi pastër, thjesht me dibranët dhe për problemet e Dibrës. Nuk premtoi asgjë në hatashme dhe në themelin e zotimeve të veta vuri figurën e vet të pakontestuar në komunitet si një shërbëtor i mirë dhe i ndershëm i njerëzve në nevojë për kujdes mjekësor", tha kryeministri Rama për fituesin e zgjedhjeve Muharem Rama.

Gjithashtu, Kryeministri e bazoi fitoren e Dibrës te një fushatë "e qetë, e thjeshtë, e drejtpërdrejtë në mbështetjen e kandidatit dhe e përqendruar tek problemet e komunitetit. Një fushatë me një koefiçent politik mëse normal dhe pa asnjë ekses në sjelljen e pushtetit".

Por ajo që është më e rëndësishme për Kryeministrin ishte fakti se "Dibra duhet të bënte dhe një vlerësim të forcave politike, të aftësive të tyre qeverisëse, të vullnetit të tyre për të sjellë ndryshim në përpjekjen për të bërë shtet".

Ai bëri edhe një lloj autokritike kur theksoi se "këto tre vite kanë treguar se ne jemi larg së qenit të pakritikueshëm padyshim, por edhe që nuk ka asnjë krahasim të mundshëm mes forcave politike që ishin përballë në garë për Dibrën, PS dhe koalicionit të madh reformist dhe një partie që prej tre vjetësh refuzon të pranojë qoftë dështimin që e çoi në opozitë, qoftë ndryshimet reale që kanë nisur në Shqipëri në çdo fushë".

"Dibra i ka dhënë mend gjithë Shqipërisë", ishte një shprehje e përdorur nga Kryeministri. "E kisha bindjen që dibranët me votën e tyre do t'i jepnin mend në radhë të parë të gjithë të lëkundurve apo të pakënaqurve prej nesh. Dhe pavarësisht faktit se me të drejtë edhe në Dibër si në gjithë Shqipërinë njerëzit presin më shumë nga ne, dibranët do të na jepnin besimin për të vazhduar të punojmë me ta. Dhe dibranët bënë pikërisht këtë, votuan për ne jo se janë të gjithë të kënaqur për çfarë kemi bërë për ta, jo se nuk janë të lëkundur apo të mërzitur, por sepse janë të bindur se ne jemi të vetmit që bashkë me ta do t'i bëjmë gjërat që Dibra pret prej 25 vitesh për ata për të cilët votojnë".

Sipas kryeministrit, "në Dibër ka ndodhur gjëja më normale që mund të ndodhte. Dibra zgjodhi të vetmen rrugë të arsyeshme për të ecur drejt të ardhmes dhe dha një mesazh shumë të qartë për të gjithë".

Kryeministri tha se e ka kuptuar "mesazhin e Dibrës për qeverinë e koalicionit dhe për PS", i cili është "Besim i madh për të bërë shumë më tepër për Dibrën".

"Dhe ne do të bëjmë për Dibrën më shumë se çfarë bënë të tjerët në 20 e ca vite të marra së bashku", - e mbylli komunikimin me publikun Kryeministri Rama më 18 shtator.

B. Karoshi



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Një ide për pavarësinë e komuniteteve nga veprimtaria minerare

TAN LLESHI

Zhvillimi i sektorit minerar dhe renta minerale mbetet një çështje që kërkon anagazhim dhe bashkerendim të të gjithë hallkave të pushtetit qendror dhe atij vendor, për një shfrytëzim sa më të mirë të burimeve natyrore, por edhe për një përdorim sa më të mirë të hapsirave ligjore, ekonomike dhe zhvillimore të krijuara nga legjislacioni përkatës.

Gjithashtu, në këtë rikthim të kësaj tematikë më ngacmoi një ide e shprehur në fund të kësaj diagrame:

"Shndërrimi i komuniteteve në sa më pak të varur nga veprimtaria minerare". Kjo, sepse së bashku me uljen e rezervave tek aktivitetet minerare, venitet edhe jeta ekonomike e sociale e këtyre vendbanime.

Pra, për rehabilitimin e tyre duhet të mendohet që gjatë kohës kur përfitohet nga aktiviteti mineral. Këtu kam pasur parasysh disa specialistë japonezë, të cilët si mundësi për rivitalizimin e zonave me zhvillim ekonomik të venitur shërbenin koncepte të bioteknologjisë, ose me saktë akoma koncepti i "Biomass Toën".

Pra, kjo mund të jetë një alternative zhvillimore edhe për rastin tonë, sidomos për zona me intensitet të lartë të zhvillimit minerar.

Një projekt i tillë do të bënte që ndoshta si rrallë herë të gjendeshin të përfshirë në të njëjtin projekt dy departamente të AKBN: ai minerar dhe ai i energjive të rinovueshme.

Pyllëzimi dhe shtimi i sipërfaqeve të mbjella do të ishin mundësi për çeljen e shumë veprimtarive ekonomike, duke filluar me industrinë e përpunim drurit, bletarinë, gjuetinë, turizmin deri tek prodhimi i vajrave dhe esencave e rrjedhimisht me to edhe i industrise kozmetike, duke mos harruar një strategji të mirëmenduar të trajtimit të mbetjeve të tyre, që do i shndërronte ato në energji përmes pelletit, briketit, por pse jo, edhe vetem përmes ashkëlzimit. E duke mbetur te kjo temë, mund të mendohej për prodhimin e biodieselit dhe biogazit nga mbetjet e aktiviteteve ekonomike, bujqësore e blektorale të zonës.

Garancite rehabilituese të subjekteve minerare mund të ishin një fond i mirë nxitës dhe mbështetës për këtë shndërrim të tillë nga "qytet minerar" në "qytet të biomasës".

Pyllëzimi dhe shtimi i sipërfaqeve të mbjella do të ishin mundësi për çeljen e shumë veprimtarive ekonomike, duke filluar me industrinë e përpunim drurit, bletarinë, gjuetinë, turizmin deri tek prodhimi i vajrave dhe esencave e rrjedhimisht me to edhe i industrise kozmetike, duke mos harruar një strategji të mirëmenduar të trajtimit të mbetjeve të tyre, që do i shndërronte ato në energji përmes pelletit, briketit, por pse jo, edhe vetem përmes ashkëlzimit. E duke mbetur te kjo temë, mund të mendohej për prodhimin e biodieselit dhe biogazit nga mbetjet e aktiviteteve ekonomike, bujqësore e blektorale të zonës.

Me lart, kur citova "përdorimin sa më të mirë të hapsirave ligjore" kisha parasysh vendimin Nr. 741 datë 09.09.2015,

"Për miratimin e formës, rasteve dhe mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare".

Në pikën 14 të këij vendimi shkruhet:

"Vlera e garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit, e kaluar në favor të shtetit, përdoret nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare për rehabilitimin progresiv ose përfundimtar të mjedisit të zonës përkatëse ose, në raste të veçanta, në zonën përreth".

Në kuptim të kësaj pike do të doja të shtoja:

1. Në rastet e rehabilitimeve përfundimtare, ndodh që rehabilitimi të kryhet pas një periudhe relativisht të larget.

2. Në rastet e zonave ku rehabilitimi është i pamundur, të shtyn të mendosh që fondet e depozituara për këtë qëllim janë të destinuara për zonat përreth.

Duke u nisur nga këto dy faktorë mund të themi:

- koha e largët për rehabilitimin përfundimtar dhe nevoja e fondeve për pyllëzim;
- mundësia për t'i përdorur fondet në zonën përreth, nëse pushteti lokal ka dhe prezanton plane rehabilituese pyllëzimi.

Do të sygjeroja pas paraqitjes së projekteve konkrete nga pushteti lokal, Ministria përkatëse të mundësonte përdorimin e fondit teë garancisë së subjekteve që e kanë të pamundur rehabilitimin në zonën e tyre të veprimtariseë.

Në mënyre periodike, çdo 2 vjet, si të shihet e arsyeshme si dhe çlirimin e subjekteve nga detyrimi për të kryer rehabilitimin për periudhen në fjalë.

Mendojme se kjo do të rriste efektshmërinë e këtyre fondeve; do të rriste transparencën e përdorimit të tyre; do të ulte keqpërdorimin dhe korrupsionin e mundshëm lidhur me këto fonde si dhe, mbi të gjitha, do të mundësonte atë për të cilin e nisëm këtë diskutim: Shndërrimin e komuniteteve në sa më pak të varur nga veprimtaria minerare.

Shënim: Për më shunë rreth kësaj çështje dhe ideve të tjera për përdorimin e biomasës, mund të ndiqni faqen në Facebook: AKBN-SE BASHKU

10 vjet gazeta Rruga e Arbërit

Abdi Baleta, Abdi Shehu, **Abdurahim Ashiku**, Abdyl Koleci, Adela Halo, **Adem Bunguri**, Adi Darsi, Adrian Blackledge, Afrim Karoshi, Agim Baçi, Agim Boba, Agim Çadri, **Agim Deva**, Agim Gjini, Agim Kaba, Agim Kasa, Agim Shenjatari, Agim Vinca, Agron Sela, **Agron Tufa**, Agron Xhagolli, Agustin Gjinaj, Ahmet Çaushi, Ahmet Kamberi, Ahmet Përlepa, Albert Vata, Albert Zholi, Aldo Mingo, Aleksandër Cipa, Ali Hoxha, Ali Koçeku, Ali R. Berisha, Alma Mile, Andi Balla, Andon Andoni, Aneta Cani, Aqif Ademi, Aqif Karaj, Aqif Xhemi, Arbana Qorri Ahmeti, Arben Muka, Arbër Lleshi, Ardian Reçi, Ardit Selami, Ardita Abdiu, Aria Sukniqi, Arian Avrazi, Arian Kadiu, Ariola Lami, Arjana Tollja, Arjeta Tafçiu, Armond Duraku, Arqile Teta, Arsim Kolari, Artan Gjyzel Hasani, Artan Hoxha, Artan Lame, Arthur Nelsen, Artin Spahiu, Astrit Balliu, Astrit Gjunkshi, Astrit Hoxha, Atli Dema, Avni Alcani, Axel Kronholm, Baftjar Gazidede, Bajram Hyseni, Bajram Xhafa, Bardhyl Agasi, Bardhyl Berberi, Bardhyl Marku, Bardhyl Xhama, Bashkim Alungu, Bashkim Lami, **Bashkim Lleshi**, Bashkim Rama, Bedri Tahiri, Begzad Baliu, Behar Gjoka, Ben Andoni, Bena Kërluku, Beqir Ajet Shehu, Beqir Sina, Bernard Zotaj, Besnik Alku, Besnik Rama, Blerim Lazimi, Bleta Qormemeti, Bujar Kapexhiu, **Bujar Karoshi**, Bujar Leskaj, Bujar Plloshtani, Bujar Vitija, Dali Horeshka, Dali Noka, Dali Tërshalla, Dalip Greca, Danjel Bica, Dashmir Zace, Dashnor Kaloçi, Daut Shehi, Dedë Llesh Doçi, **Defrim Methasani**, Dejang Nova, Denis Lushi, Destan Rama, Dhimiter Shehollari, Dhori Qirazi, **Dionis Xhafa**, Dita Tona, Diqosa Potozani, Dhori Bocku, Dritan Murrja, Drite Ademi, Driton Zenku, Dukagjin Hata, Dylbin Reçi, Edibe Sehiri - Osmani, Edison Baha, Edison Ypi, Edlira Haxhiymeri, Edmond Hasani, Edmond Zhulali, Eduard Abazi, Eduard Ilnica, Elliot Hasan Moglica, Elmaz Lala, Elona Mazari, Elvana Zaimi, Emrie Skuka, Engjëll Celibashi, Engjëll Musai, Enver Halili, Enver Hysa, Enver Kaloshi, Eqrem Basha, Eralda Skarra, Erisa Saraci, Ermir Dizdari, Emir Hoxha, Ermira Isufaj, Ermira Shehu, Esat Ruka, Eshref Ymeri, Esmeralda Bica, Esmeralda Ilnica, Eva Orhan, Eva Zhiti, Evi Xhelani, Fatos Bugi, Fatbardh Hetoja, Fatik Xhafa, Fatos Kaba, Fatbardh Veria, Fation Pando Viki, Fatmir Delishi, Fatmir Minguli, Fatmir Terziu, Fatmir Zhuzhi, Fatos Baxhaku, Fehmi Lleshi, Fejzulla Gjabri, Femi Sufaj, Ferit Fixha, Fitim Dika, Flamur Hadri, Flora Nikolla, Florika Bushi, Gafur Muka, Gafur Zota, Gafur Zoto, **Gazmend Kërkuti**, Genc Melonashi, Genci Luarasi, Genta Nishica, Geri Selenica, Gëzim Alpion, Gjergj Marku, Gjergji Mima, Gjokë Beci, Gjon Fierza, Gjon Ndreja, Grehans Uka, Hajredin Toca, Hajri Mandri, Hajri Shehu, Hajrush Mani, Haki Duka, Haki Kola, Haki Përnezha, Halil Rama, Halil Robi, **Halil Teodori**, Hamdi Hysuka, Hamdi Skeja, Hamit Taka, Hamit Vata, Hane Burnett, Hasan Leka, Hasan Lleshi, Hasan Pasha, Hekuran Vladi, Hilë Lleshaku, Hygmet Kadriu, **Hysen Likdisha**, Hysen Myftiu, Hysen Repa, **Hysen Uka**, Hysni Bakiu, Hysni Stafasani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Kolari, Ibrahim Milushi, Ida Nurçe, Idriz Xhomara, Ilir Krosi, Ilir Sinanaj, Ilir Spata, Ilirjana Sulkuqi, Iljaz Bobaj, Iljaz Kaca, Ilmi Dervishi, Ina & Erta Disha, Ina Xhaferi, Inva Halili – Kuhn, Isa Halilaj, Islam Cani, Islam Çenga, Islam Sharofi, Ismail Hysa, Isuf Miho, Isuf Salla, Iva Cipuri, Ivzi Çipuri, Jahe Delia (Selmani), Jani Thomai, Jera Isakaj, Jorgji Muzaka, Jorgo Papa, Kadri Dauti, Kamber Farruku, Kastriot Çela, Koço (Kozo) Zylo, Klara Kodra, Kozmare Ollogu, Kristo Zhakollia, Kristofor Barbuti, Kujtim Bexhiri, Kujtim Osmani, Laura Koprani, Lavdrim Lalaj, Leonard Lleshi, Shkëlzen Hoxha, Leonora Çela, Lesten Pambuku, Llazar Semini, Lulzim Basha, Lulzim Çela, Lutfi Hanku, Lutfi Turkeshi, Mahir Jangulli, Mahmud Hysa, Majlinda Hoxha, Malvina Shehi, Marin Mema, Marius Dobrescu, Mark Tirta, Martin Cukalla, Mehdi Dema, Mehmet Dume, Melsi Tafa, Mendu Dema, Mentas Nasufi, Mentor Hoxha, Meral Ismaili, Mersin Hoxha, Metodija Velevski, Metush Skeja, Mevlud Buci, Mexhit Prençi, Mhill Velaj, Miftar Fana, Mimoza Erebara, Mimoza Hoxha, Miradije Hysa, Mirela Ymeri, Mirela Tase, **Miranda Goleci**, Mirvet Lala, Moisi Murra, Molnar Kolaneci, Monika Stafa, Muhamet Bitri, Murat Gecaj, Murat Koltraka, Musa Kraja, **Musa Riçku**, Mustafa Tola, Muzafer Korkuti, Myhyr Hoxha, Myslim Islami, Nadire Skënderi (Murra), Naim Berisha, **Naim Plaku**, Naim Zoto, Namik Selmani, Naxhi Hasa, Ndue Dedaj, Nefail Spahiu, Neki Feta, Neki Kaloshi, Nerilda Meda, Nexhi Baushi, Nikoll Marku, Nikolla Malaj, Nikolla Mazi, Nikoll Ndoja, **Nuri Abdiu**, Nuri Koleci, Odise Plaku, **Osman Xhili**, Pajtim Përnezha, Pandeli Koçi, Perikli Jorgoni, Perparim Luca, Perparim Spahia, Perparim Tomçini, Petri Hoxhi, Petrit Dunga, Petrit Fetahu, Petro Luarasi, Pjetër Jaku, Qamil Sula, Qazim D. Shehu, Qazim Hata, Qazim Prejsi, Qemal Skendo, Qenan Hasani, Qeram Cibaku, **Rakip Suli**, Ramadan Ajazi, Ramadan Ndreka, Ramazan Biba, Ramazan Buci, Ramazan S. Ilnica, **Ramiz Gjini**, Ramiz Lushaj, Ramiz Zekaj, Rasim Buci, Renato Totraku, Resul Bendo, Rexhep Doda, Rexhep Ndreu, **Rexhep Torte**, Rezehana Hysa, Rifat Malaj, Robert Reci, Roland Çene, Roland Zisi, Rovena Vata, Rozi Theodhori, Rrenzi Ndreu, Ruzhdi Pipa, Rustem Deva, Ruzhdi Veli, Sabri Hamiti, Sadik Lala, Salimir Shahini, Sakip Cami, Sali Ajazi, Sali Bushi, Samet Zagradi, Sami Milloshi, **Sashenka Ndreka**, Sazan Goliku, Sazan Guri, Sefedin Shabani, Sefulla Kata, Sejdi M. Hashi, **Selman Mëziu**, Shaban Bitri, **Shaban Sinani**, **Shaqir Skarra,** Shefki Aliti, Shefqet Hoxha, Shehat Cami, Shehat Marku, Shemsi Daci, Shemsi Manjani, Shemsi Prençi, Sherif Delvina, Shinasi Rama, Shkëlzen Lushaj, Shkëlzen Haliti, Shpend Teqollia, Shpëtim Cami, Shpëtim Hyka, Shpëtim Polovani, Shuaip Nanlo, Shuaip Haderi, Skënder Minxhozi, Sokol Çobo, Sokol Demaku, Spiro Xhavara, Srecko Sekeljic, Stephen Schaertz, Suat Saqipi, Suela Lala, Sulejman Borova, Sulejman Tomçini, Syrja Stafa, Tefik Jegeni, Tefik Skera, Tefta Cami, Tefta Nuredini, Thanas Feka, Theodhori Karaj, Ulkie Sinani, Ullmar Qvick, Valbona Zunçe, Valeria Dedej, Valmir Gashi, Valter Shtylla, Vehbi Bajrami, Vehbi Hoti, Veip Proda, Veli Vraniçi, **Vesel Hoxha**, Vezir Muharremaj, Virion Graçi, Viron Kona, Vita Koja, Vojsava Leka, **Xhafer Martini**, Xhafer Seiti, Xhavit Deda, Xheladin Çelmeta, Xhelal Luca, Xhelal Marku, Xhelal Roci, Xhelal Zejneli, Xhelil Cibaku, Xhemail Ali Peci, Xhemal Domi, Xhemal Mato, Xhezair Abazi, Ylber Nuredini, Ylli Molla, Ylli Prapa, Ymer Keta, Ymer Stojku, Zabit Lleshi, **Zaim Elezi**, Zaim Korsi, Zamira Gjeleshi, Zef Çoba, Zejnel Sula

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Bej "**Like**" dhe "**Share**". Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Për më shumë informacion:
Tel: 00455 68 65 08 441. +355 68 65 08 441 +355 69 20 68 603
Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com

ATA E PREMTUAN NDËRTIMIN E RRUGËS SË ARBRIT POR NUK E MBAJTËN FJALËN. NE PUNUAM SË BASHKU PËR GAZETËN "RRUGA E ARBËRIT" DHE E NDËRTUAM PËRMES LIRISË SË FJALËS DHE MENDIMIT, ME PËRKUSHTIM DHE DASHURI!

Klinika Mjekësore "VENIS"

Klinika mjekësore "VENIS" është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm.

Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

1. **DIAGNOSTIKIM**. Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë.
2. **TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE.** Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare.
3. **TRAJTIM MJEKËSOR.** Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare.
4. **KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE.** Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve.

MOS KINI PARAGJYKIME! Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur.
Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM
Vizitat kryhen me planifikim paraprak.
Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287**
E-mail: **sadikhlala@gmail.com**

Anekdoda postelektorale

"KUSH TË VIJË I FUNDIT"

Tre ditë para zgjedhjeve një grup vëzhguesish të zgjedhjeve ishin në Peshkopi. Një mëngjes, duke dalë nga Dobrova, njëri prej tyre, që e pinte duhanin shumë, pa që i kishin mbaruar cigaret. Dyqanet ishin mbyllur. Diku në dalje të qytetit, pa një xhip që po ecte trotuarit dhe mbante një cigare ndezur.

Ndaluan makinën dhe ai që pinte duhan - ishte edhe vetë dibran, e pyeti xhipin:

- Mimgjes o kushaj, i foli Xhipit!
- Mimgjes, tha xhipi dhe ndali hapin.
- A ta baj ni pietje?
- Po mor, tha xhipi, fol.
- Turp asht me lip apo me dhanë!
- Turp asht me lip, - tha Xhipi.
- Atëherë, turpi më mbetet mu, - tha burri, e jam tu t'lip: A ke t'më japësh ni cigare?

Xhipi pa tre veta në makinë dhe pa folë asnjë fjalë nxori tre cigare dhe ua drejtoi.

- Faleminders', - i tha ky që lypi cigare. Këto dy të tjerët nuk e pinë, por unë me turp se me turp u bana dhe po i mbaj të treja. Por a ta bëj edhe një pyetje? Si e ke mendjen për të votuar?

- Hala nuk e kam nda, - tha xhipi. - Pres kush do m'vijë në derë i funit?

- Si të të vijnë në derë, nuk e kuptoj?

- Ka ardh' i pari para ni jave dhe m'ka dhanë nizet mij lek për vot, ka ardh ni qetër di ditë ma vonë dhe m'ka dhana trajdhetë mijë. Tahaj po pres deri t'shtunën në dark mos po vjen ndonjë tjetër të m'japë pak ma shumë...

"5000 LEKË NJË COPË LETËR"

- A nuk ke turp si e ke shajt votën, - i thanë një burri të vjetër në një katund të Dibrës, i cili kishte pesë anëtarë me të drejtë vote dhe ishin përhapur fjalë se e kishte shajt ni votë 5000 lekë.

- Jo, tha, sepse nuk kam shajt votën, por kam shajt ni copë letër pesë mijë lek.

- Jo, jo, votën ke shajt! Se tani që e ke shajt, t'asht mshel gjoja me kërkue ato pak gjana si t'takojnë...

- Jo, jo, - tha plaku. - E ke gabim. Gojën e kam pas hap gjithë kohën, por nuk m'i ka dhanë kush ato gjana si m'takojnë. Tahaj prap nuk kanë me m'i dhanë, por t'paktën u mora pak nga ajo që na kanë vjedhur. Jo vetëm për vete e për familjen teme, por për t'gjithë katundin... Sa t'kalojm këtë dimër, se verën qetër kemi prap zgjedhje...

"KUR S'KE SY, KE GOJË"

Një grup deputetësh nga Tirana kishin shkuar në Dibër për fushatë. Dhe hipur mbi makinat e tyre të shtrenjta, përfunduan në një fshat pa rrugë e asfalt. Ngaqë nuk dinin ku të shkonin, menduan të ndalonin në atë katund të vogël, por shumë të hapur, me shtëpitë larg njëra - tjetrës. Dhe kishin dëgjuar se në Dibër, për fushatë, ose takojnë të fortin e lagjes ose më të vjetrin e fshatit. Ndaluan një kalimtar në rrugë, një djalë të ri dhe e pyetën:

- Jemi nga Tirana dhe kemi ardhur për fushatë elektorale. Të lutem, na thuaj, kush është më i vjetri në këtë katund dhe si mund të shkojmë të pimë një kafe?

- Është një burrë i vjetër, por nuk e di si mund të shkoni. Ja, është ajo shtëpia në fund, - dhe bëri me dorë nga një kodër, - por kam frikë se nuk shkoni dot me makina, pasi rruga është gropa-gropa e vija-vija, dhe do t'ju prishet makina.

- Po si mund të shkojmë ndryshe, thanë fushatistët nga Tirana.

- Ja, merrni rrugës sipër te kanali u ujit merrni djathtas dhe për 10-15 minuta jeni te shtëpia.

Ashtu bënë. U nisën në këmbë, por kur shkuan te kanali i ujit, syri ju zuri një fushë kanabisi gati për t'u korrur. Kokulur dhe pa zë, vijës së ujit dhe mespërmes fushës me kanabis, nxituan hapat dhe për 5 minuta shkuan te shtëpia e plakut.

Ai i priti mirë, i vuri në krye të odës dhe ndërkohë që po bëhej kafja, po u dridhte nga një cigare miqve.

Njëri, që ishte më i riu, pasi kishte dëgjuar shumë për muhabetin e odave, e ngacmoi plakun:

- Duhan vendi është?

- Po, po, - ia ktheu plaku. Ka mbjellë djali ca rrënjë. Ai i bën shërbimet, e vjel dhe e than, dhe unë veç e pres në kimë dhe e dredh brenda këtyre katër mureve.

Djaloshi, i cili kujtoi se plaku nuk ia kapi muhabetin, e ngacmoi sërish:

- Djali a mbjell duhan ta tymosësh veç ti, apo ka mbjellë edhe nga ai duhani që e tymos edhe rinia?

Por plaku bëri sikur nuk e kuptoi sërish djaloshin, ngriti kokën dhe e pyeti prap:

- Unë nuk e njoh këtë duhanin e ri, unë njoh veç këtë që po dredh në kuti...

Por djali vazhdoi në të tijën:

Kanabis, xhaxha, kanabis! A ke parë ti të kenë mbjellë këndej nga katundi juaj?

Plaku, ndaloi dredhjen e duhanit, drejtoi trupin dhe gjithë serioz i tha:

- Nga ma gjete shpajn, mor voc, nga xhadja poshtë apo rrugja nalt?

- Rruga sipër, - tha djaloshi pa u menduar.

- Mor bir, kur nuk ke pas tej saj me e pa si ke kalue midis arës, nga ta shof unë m'shele m'rena katër mureve...

- Mos ia vër re, - i tha plakut njëri prej burrave që ishte më i moshuar, se këta të rinjtë, kur nuk kanë sy, kanë gojë...

"SI TË THOTË BURRI"

Dy militantë partie, që ia kishin pirë gjithë lëngun demokracisë, herë majtas e herë djathtas, kishin shkuar në fushatë në një katund. Aty shtëpi më shtëpi e lagje më lagje, kërkonin vota për partinë e tyre të re.

Kaluan pranë një shtëpie dhe në oborr panë dy të moshuar.

- Ndalojmë këtu, - thotë njëri prej tyre. Ai burri është i partisë tjetër dhe nuk na e jep votën, por gruaja është bijë te një mik i imi, dhe ata janë me në. Ndalojmë e bëjmë një dorë muhabet dhe di si t'ia kërkoj unë votën kësaj here...

Burri dhe gruaja i panë që u kthyen nga shtëpia e tyre. Nuk kishin hiç qejf me i pritë, por burri i tha me zë të ulët:

T'i presim, t'u japim n'i kafe, se nuk duhet me e koritë shtëpinë për këta të dy ...

Pasi u përshëndetën, i kërkuan zonjës së shtëpisë që në vend të kafes t'u jepte ose një gotë dhallë ose një gotë qumësht, se u ishte mbush stomaku me miell kafeje dhe po u përzihej. Dhe u ulën këmbëkryq dhe filluan muhabetin.

- Oj nanë, - i thanë gruas. - A do t'na e japësh votën kësaj radhe?

- Si t'thotë burri, - tha gruaja.

- Jo, jo, oj nanë. - Jemi në demokraci dhe vota është e lirë! Burri ka votën e vet dhe gruaja ka të vetën!

- Po, mor bir, po, por unë do t'votoj si t'thotë burri...

Lëre burrin të bëjë si të dojë vetë. Ti na e jep këtë herë votën! Mos e dëgjo burrin, se burri jot është si muri, nuk luan!

Duhet n'gjue burri, mor bir, duhet ngjue! Se po t'ishte për mu, ua kisha fajt ni bar majni n'tamël, por burri nuk m'la. M'tha: Oj grue, fajti ni lugë mjalt n'gotë t'amlit, t'amëltohen e t'shkojnë n'punë t'vet...

Dy militantët e lanë përgjysëm gotën e qumështit, u ngritën e ikën gjithë inat...

"KU PO E BAN BURGUN SALIU?"

Disa nga udhëheqësit e PD në një katund në Dibër shkuan për një kafe te një burrë i vjetër.

Plaku i priti dhe u dha muhabet duke i pyetur një nga një.

Njëri prej tyre i tha:

- Do ta rrëzojmë komunizmin kësaj here. Nga Dibra do të fillojë revolucioni që do t'u fusë tmerrin bijve të Enverit...

- Po, mor, po, - tha plaku... A m'bëjn sajt, a ti je ai voci si herën e kalueme m'kërkove votën se do fajsish n'burg Saliun... E ku po e ban burgun Saliu?

"ESTRADË NË KATUND"

Ishin përhap fjalë në katund se një kaubojs do të bënte takime me popullin. U mblodhën burrat te dyqani i fshatit duke pirë birra e duke sharë opozitën.

- Ku shkon, o bab, - i tha një fëmijë i vogël babait të tij.

- Jam tu shkue në nji mbledhje se ka ardh Kaubojsi...

- A t'vi edhe un me ty se kam qejf me pa ni kaubojs me saj...

Babai mori të birin përdore dhe shkuan në mbledhje. Aty fliste kaubojsi dhe burrat e fshatit ngrinin shëndete me birrë kuqalashe dhe gajaseshin së qeshuri....

- O bab, - tha i biri me zë të ulët në vesh, ky kaubojsi po rren...

- Jo, mo bir! Nuk rren ai! A e shef çish burri asht? Nuk rrejn këto soj burrash....

- Po rren, po rren, - tha djali serioz. - Sepse ai nuk asht kaubojs, nuk ka as kal dhe as patllake...

Babai qeshi dhe i tha:

- E di, mor bir, e di. Por ne për të qeshur erdhëm këtu, pasi ka 25 vjet që nuk ka ardhë estradë në katund.

...

"FITORE PËR KURBAN BAJRAM"

Pas fushate e pyeta njërin që ishte me partinë fituese:

- Pse jeni kaq të mërzitur!

- Jo, mo, tha, të gëzuar jemi, por nuk e prisnim një fitore kaq të thellë!

- Atëherë nxire gëzimin, - i thashë, - merre një flamur të PS dhe dil të festosh në bulevard.

- Jo, nuk dal dot, - ma ktheu!

- Por çfarë ke atëherë që më je i vrenjtur si moti?"

- Po shpresoja që të vazhdonte numërimi dhe të shpallej nesër fitorja. Se sot është dita e Kurban Bajramit dhe kryetari i ri do të thotë se 'jam zgjedhur në një ditë të bekuar nga Zoti' dhe do t'i ndajë të gjitha vendet e punës përgjysëm... Dhe kam frikë se do më kërkojnë të ndaj vendin e punës time përgjysëm...

HUMOR PASZGJEDHOR

E pyetën një burrë:

- Çish qe kjo si ndodhi n'Dibër?

- Ndodhi, - tha burri, - s'kemi ç't'i bëjmë.

- Po ku i patët sajt, a nuk e shajfshi se hashashi ishte tu u gje votat?

- O bir, - tha burri. Ata me dy saj kan ik nga ki ven, ata me ni saj kanë shkue n'Bathore, ndërsa k'tu kan mbet ata pa saj...

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky muaj ka qenë i begatë për Dibrën. Deputetë, ministra, qeveritarë, drejtorë, opozitarë, kryetarë partish, të huaj, vëzhgues, shoferë, pastrues, të larguar e të harruar, iu rikthyen Dibrës së paku për një vizitë. Bënë ndonjë fotografi për të hedhur në Facebook, hëngrën jufka me çull a mish pule dhe u rikthyen në Tiranë. Sigurisht, me fitore.

Zgjedhjet mbaruan. U shpall edhe fituesi. Ditën e votimeve militantët rrinin syhapur se mos kundërshtari u vjedh një votë, por kur votat shkuan mbi katër mijë, hajdut doli se ishte Hash-ashi...

Hash-ashi nuk është njeri. Ca thonë është drogë e ca të tjerë bimë mjekësore. Ndërsa për disa është shkëputje nga varfëria, së paku për ca muaj, sa nuk i ka zënë...

Aq shumë është mbjellë, sa thonë ia ka kaluar edhe kumbullave, edhe mollëve. Por askush nuk i ka parë dhe askush nuk ka mbjellë. Vetëm tregohet se ku, por kur dhe kush nuk dihet...

Ca thonë i ruan policia, ca i ruajnë tepelensit, ndërsa për të tjera i kultivojnë lazaratasit... Sepse Dibra është e madhe dhe kryeministri ka thënë se "i ka dhënë mend gjithë Shqipërisë". Por me Hash-ashin ato mend që ia kemi dhënë, do t'ia marrim tani pas zgjedhjeve...

Partitë akuzonin njëra –tjetrën se në Dibër kanë çuar militantët dhe ekstremistë. Por dibranët treguan se kanë prit e përcjell gjithmonë miq, sepse edhe kur e ka pas magjen plot, edhe kur s'ka pas bukë për vete, derën e kanë mbajtur gjithmonë çelë... Ndaj i priti edhe këtë muaj vjeshte miqtë nga Jugu në Veri dhe me këtë rast u dha edhe shembullin se si fitohen e humben zgjedhjet...

Gojët e liga thonë se PD e humbi Dibrën se pati aleat Kreshnikun, ndërsa PS e fitoi se pati aleat Kaubojsin...

Thonë, gjithashtu, se PS fitoi këtë herë se kishte aleat "çamët". Një vit më parë fitoi se kishte aleat "grekët". Ndërsa vitin e ardhshëm do të fitojë se do të ketë aleat PD-në...

Po shyqyr që pati zgjedhje dhe "Tenderi" u duk edhe nga Dibra... Tender për bulevardin, tender për unazën, tender për shkollën, tender për spitalin... Plot 30 brenda një muaji... Erdhën zgjedhjet, se e kishim harruar fjalën...

Zhurmë e madhe u bë me akuzat se pati shitje. "U shit populli", vunë kujën sikur të kishte ardhur fundi i botës. Kur shiten vetë, nuk e merr vesh njeri, se e kanë çmimin e lartë dhe pazari bëhet në parlament ose te Sheratoni...

E vetmja gjë që nuk shkoi në zgjedhje ishte dita kur u numëruan votat... Sepse Kryetari i ri u zgjodh natën e Kurban Bajramit dhe duhet ta ndajë pushtetin gjysëm për gjysëm, si keci që therëm... Por si i bëhet halli që janë tre aleatë?...

Pas zgjedhjeve duket se u anulua edhe HEC i Katundit të Ri! Nuk u mor vesh nëse qeveria po mendon Skavicën e madhe, investitori doli gulinist apo Gjiknuri u kthye në dibran...

Për rrugën po shtohen shpresat. Vetëm se si gjithmonë, na dhimbset qeveria dhe duam ta heqim tunelin... Ç'na duhet... Ne kemi kërkuar rrugë, nuk kemi kërkuar tunel...

Korabi vërtet doli në kategorinë e parë, por po vuan shumë për fitoren e parë... S'po e lënë gjyqtarët të ngrejë kryet... Se po fitoi, është hall i madh: kush ndërton stadiumin dhe kush udhëton kaq larg... për një ndeshje futbolli...

Është shtator dhe mollët po i vjelim... Por është hall i madh se s'kemi ku t'i çojmë... Të ishin pjekur para datës 11, do t'ia shisnim ndonjë ministri a deputeti...

Isuf Koçi ishte i suksesshëm, pasi punën e tij e bazoi mbi korrektesën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Isuf Koçi, "Qytetar Nderi" i Bulqizës



Nga **AZIS KETA**

Isufi Koçi lindi në Tiranë më 15 mars 1949. Ishte koha kur Shqipëria sapo kishte ndërprerë marrëdhëniet me ish-Jugosllavinë. Ndërsa anglo- amerikanët organizonin me grupe zbulimi rezistencë antikomuniste për përmbysjen e regjimit në Shqipëri.

I ati i Isufit, Hamiti, ka qenë partizan në Brigaden 18 Sulmuese dhe pas lufte ka punuar si drejtues në sektorë të ndryshëm të ekonomisë në Tiranë, Gjirokastër, Rubik dhe në Ulëz, ku u perjashtua nga Partia. Ishte koha e krizës ushqimore dhe ku pas çdo dështimi shpikej një armik.

Ulza e viteve 1960 - kantier ndërtimi - ende nuk kishte shkollë, ndaj dhe Isufi, nga klasa e parë deri në të shtatën do të mësonte në "Internatin e Burrelit". Jeta në konvikt, me regjim "gjysmë kazerme", me disiplinë të rreptë, do e bënte Isufin të ngjashëm me kadetin e shkollave ushtarake.

Mbas arsimit shtatëvjeçarë vijoi gjimnazin në Durrës. Pas kësaj, synonte të studionte për mjekësi ose inxhinieri, por një shënim në dosje: "me probleme në biografi" do e "plagoste" qysh në rini dhe përgjithnjë. Ishte koha e triskëtimit dhe, babai i tij, Hamiti, do të ndëshkohej nga sistemi i kohës, do të shkarkohej dhe do të përjashtohej edhe nga partia. Pasoja: Hamit Koçi do të shkonte në Bulqizë. Metoda me dënime, internime, burgime, pushkatime, do vijonin vite me radhë, por fatmirësisht, Hamit Koçi do e mbyllte me kaq.

1970 – 1990, "KOHA E ISUF KOÇIT"

Isuf Koçi,për sa kohë ishte në nivele të larta drejtimi, pati nivelin më të lartë të prodhimit. Nivelin më të lartë të investimeve që thithi nga ndihmat e minierës së Kromit në Bulqizë dhe ato nga Plani i Shtetit. Futi frymën studimore në qarkullimin bujqësor dhe në analizat e cilësisë së tokës. Këmbëngulja e tij ndikoi në krijimin e bindjes se, ferma në Bulqizë, ishte një nevojë jetike, jo vetëm punësimi, por dhe për afrimin e prodhimit te konsumatori, ku minatori, merrte përparësi. Në këtë luftë, ai bëri të pabesueshmen. Sepse argumentoi ngritjen e fermës, jo në Myzeqe, por në Bulqizën e vështirë. Dhe, në kushtet që punoi, Bulqiza mori maksimumin e prodhimit historik, edhe pse evidencat flasin për më pak. Dhe kjo, kishte një arsye: në kooperativë dokumentohej më pak se prodhohej, sepse, populli, me konceptin e "arës time", gjithmonë vinte dorë në " arë të vetë", edhe pse ajo figuronte në "tokë kooperative". Kjo për mbijetesë, sidomos ato familje që nuk kishin asnjë të punësuar në minierë.

Bulqiza e viteve '70 –të ishte e njësuar si strukturë organizimi "Kooperativë e Bashkuar". Ajo shtrihej nga Ura e Qytetit deri në Qafë Bualli. Isuf Koçi, kryetar i kooperativës, raportonte për 776 ha tokë dhe 700 krahë pune, duke mos përfshirë në statistika një sasie toke që i ishte kaluar NFP-së Bulqizë nga toka që përfitohej nga tharja e fushës Vajkalit (AQSH).

ISUFI DHE BULQIZA KRAH PËR KRAH

Për shkak të përjashtimit të babait nga partia, do të penalizohej edhe Isuf Koçi. Pas përfundimit të gjimnazit nuk kishte më të drejtë zgjedhje, edhe pse rezultatet në shkollë i kishte të relativisht të larta. E dërgojnë në degën më pak të kërkuar të asaj kohë, në Institutin Bujqësor Kamëz. Studimet universitare i përfundoj me rezultate të larta. Propozimi për të filluar punë si asistent pedagog nuk iu miratua për çështje biografie. Emërimi në Bulqizë u kthye në dramë edhe për Isufin, sepse, po në Bulqizë, me status "gjysëm internimi" do gjente dhe të atin. Fillimisht Isufi emërohet agronom, por shumë shpejt do të merrte detyrën e shef dege prodhimi, e më pas kryeagronom, kryetar kooperative, përgjegjës sektori në ndërmarrjen bujqësore Peshkopi, për ta mbyllur si drejtor ferme.

Kjo karrierë befasuese erdhi si rezultat i dy faktorëve:

E para, Isufi tregonte vazhdimisht vlera intelektuale, shpirt pune dhe marrëdhënie të shkëlqyera me njerëzit.

E dyta, populli i Bulqizës, kurrë nuk e mori seriozisht luftën politike të biografive. Populli, i velur me shpalljen e pesë kulakëve në Bulqizë, sepse ata refuzonin të hynin në kooperativë, ishte plagë shpirti edhe për Isuf Koçin. Bulqiza kishte përvojën e persekutimit të disa fiseve të mëdha si Voci, Shehu, Keta, Tançi, vetëm se kishin patur djem oficerë në kohë e Mbretërisë, dhe për këtë shkak i bënim armiq të paqenë. Kolektivizimi me dhunë, gënjeshtrat me mirëqenie dhe "lugë floriri", kishin vrarë besimin dhe ishte krijuar bindja se "jemi të mallkuar nga Zoti!"

Kur vinin ekipe dhe përgjegjësinë e ia kalonin drejtuesve, mes të cilëve edhe Isuf Koçi, pleqtë ndërhynin dhe bënin pyetjen: "A po e provon ju karrigen e Isufit tonë? Çdo të bëje ti të ishe në vend të tij? Djali jonë ka bërë gjëra, aq sa mund të bëhen në kushtet e Bulqizës, me pesë muaj dimër e ku "pula ha gurë".

BULQIZAKËT KRENOHESHIN DHE IDENTIFIKOHESHIN ME ISUF KOÇIN

Ishte shans i Isuf Koçit që ai u emërua në Bulqizën e "depolitizuar". Kurrë nuk mori kosto politike nga letrat anonime. Bulqiza e mbajti afër Isufin, si djalin e vetë. E vuri në qoshe dhe i dëgjojë fjalën. I doli zot, kur tentonin t'i bënin "stërkëmbëshin" ekipet që vinin nga lart. Bulqiza krenohej me Isuf Koçin. Nga Qafa e Buallit në Urë Qyteti, ai ishte personaliteti më i vlerësuar në fushën e bujqësisë. Populli i drejtohej kryetarit dhe drejtorit të vetë, njëlloj siç u drejtoheshin djemve të tyre. Ishte e vetmja krenari që i kishte mbetur, kur, gjithë drejtuesit e tjerë, rrallë do të ishin vendas.

Kooperativa e kohës së Isuf Koçit kishte probleme pa fund, ku politika, kërkonte një

> Këshilli Bashkiak i Bulqizës ka vendosur këto ditë që ti japë titullin "Qytetar Nderi" birit të saj Isuf Koçi.
>
> Një titull plotësisht i merituar. Por ky titull nuk është vetëm i Isuf Koçit, por gjithë popullit të Bulqizës, që së bashku ia kanë arritur të jetojnë krah njëri-tjetrit në kohë të vështira.

arsye për të justifikuar dështimin. Por Isuf Koçin e mbrojti Bulqiza dhe Isuf Koçi i mbrojti bulqizakët. Sot, asnjë familje e persekutuar nuk ankohet nga Isuf Koçi. Ndaj dhe ai qëndroj kaq gjatë në Bulqizën problematike, madje, edhe në nivelet më të larta të drejtimit. Isufi ishte i pranuar nga të gjithë. Dinte të ruante ekuilibrat, amortizonte gjithçka brenda vetes, shpesh duke marrë dhe "zjarr mbi vete". Kjo i dha Isuf Koçit autoritet të merituar në popull. Dhe Isufi ia shpërbleu Bulqizës. Nuk u bë pjesë e luftës së shtrigave për punë biografish. Kishte koston politike të familjes së vet dhe kaq i mjaftonte.

"FERMA E ISUF KOÇIT"

Isuf Koçi dhe jo vetëm, kishte marrë një përgjegjësi tepër të madhe mbi vete, kur ngrinin probleme që mund të keqinterpretoheshin politikisht. I kërkonin udhëheqjes së asaj kohe, hapur, se nuk mund të ketë dy standarde mes të njëjtës bashkësie. Që një mirditor, gollobordas, selishtas, mund t'a punësonte gruan në qytet dhe të merrte një rrogë prej 120 lekësh, ndërsa një minator bulqizak jo, duke u paguar me 20 lekë në kooperativë. A nuk janë në kushte të njëjta?

Këto fjalë plumb, të thëna nga komunistë, shoqëruar me sloganin: "Ne këto nuk ja themi armikut, por Partisë tonë", shkuan në "veshin" e qeverisë së kohës. Kryeministri Mehmet Shehu, mbi informacionin që shkonte nga Bulqiza, vendos shënimin: të punësohen 100 gra të minatorëve në Fermë.

Po ku ishte ferma? Fillon një luftë e hapur midis kërkesave që vinin nga Bulqiza dhe kundërshtimit të dikastereve: asnjë nuk jepte firmën për hapjen e fermës në Bulqizë. Ndër ta, kundër dhe Manush Myftiu, ish zëvëndës kryeministër.

Isuf Koçi ndodhej në situatë të vështirë. Vëzhgohej politikisht. Dështimet e kooperativës i faturoheshin atij. Nga studimi i dosjes së tij del se ka pas disa tentativa për ta ndëshkuar. Shkaku fillonte nga i ati, i cili trajtohej më keq se një i internuar. As shtëpi banimi nuk i dhanë në qytet, siç ishte vepruar në raste të ngjashme. I jepej justifikimi i përveçëm: "me që ke shtëpinë në fshat, afër qytetit, nuk të bëjmë as pasaportizim, as strehim".

Me këtë arsyetim do penalizoheshin jo vetëm Hamit Koçi, por të gjithë minatorët me banim nga ura Topojanit deri në Qafë Bualli. Bulqizakëve ju kufizohej e drejta e pasaportizimit dhe strehimit në qytet. As fëmijëve të tyre nuk ju lejohej të bënin shkollën në qytet, madje, as bukën e grurit nuk mund ta merrnin në furrën e qytetit! Ky genocid i pastër vazhdoi disa vite, aq sa, revolta arriti kulmin.

Isuf Koçi i dinte këto shqetësime, të cilat i ngriti në strukturat përkatëse. Dhe u vendos që të bëheshin "ca arnime" në dobi të Bulqizës, dhe në këtë kuadër Isuf Koçi i sfidon të gjithë: Bulqiza që prodhon krom e meriton një sakrificë të shtetit për të. Nëse ferma ka një ngritje kosto, për mishin dhe perimet, kjo kompensohej në shkallë shoqërie vetëm nga diferenca e transportit prej nga vinin mishi dhe perimet deri në Bulqizë. Veç kësaj, shërbimet e furnizimit ofroheshin tek minatori konsumator të freskëta. Veç punësimit, që zbuste një plagë të fshatit të Bulqizës. Kjo i bindi edhe më të pabindurit. Dhe këtë e bëri vetëm Isuf Koçi, duke marrë shumë risk mbi vete, me qëllimin e vetëm që bulqizakët të ishin pak më mirë ekonomikisht. Ndaj dhe lajmi se u miratua ferma u prit me urra të fuqishme në Bulqizë. Dhe ferma punësoi 300-500 veta, nga 700 gjithsej që raportonte Bulqiza krah pune në vitet '70.

* * *

Pas viteve 1990 ishte një ndër biznesmenët e parë në Bulqizë, ku veprimtarinë kryesore e kishte në tregti, autoshkollë, përpunimin e lëndës drusore etj. Dhe ishte i suksesshëm, pasi punën e tij e bazoi mbi korrektesën dhe bashkëpunimin e ndërsjellë.

Këshilli Bashkiak i Bulqizës ka vendosur këto ditë që ti japë titullin "Qytetar Nderi" birit të saj Isuf Koçi. Një titull plotësisht i merituar. Por ky titull nuk është vetëm i Isuf Koçit, por gjithë popullit të Bulqizës, që së bashku ia kanë arritur të jetojnë krah njëri-tjetrit në kohë të vështira.

cyan magenta yelloë black



Korabi kthehet te fitorja

Korabi pas 450 minutave lojë arriti ta gjejë rrugën e portës, duke marrë një fitore të rëndësishme në transfertë kundër Teutës së Durrësit. Ishte Plaku që në minutën e parë e gjeti golin, duke thyer mallkimin e pesë javëve të para. Dy barazime dhe tre humbje e kishin renditur ekipin në vendin e parafundit, duke venitur shpresat për një edicion të suksesshëm, ashtu si dy vitet e shkuara.

Korabi luajti shumë mirë në "Niko Dovana", duke treguar se trajneri Mergjyshi ka zgjedhur një ekip që dita-ditës po funksionon. Në minutën e 30'të ishte Nexhipi që shënon golin e dytë, ndërsa në fund të pjesës së parë durrsakët ngushtuan diferencën.

Në pjesën e dytë djemtë e Korabit nuk e ulën ritmin dhe megjithëse me 10 lojtarë, pas largimit të kapitenit Sheta me karton të kuq, shënuan golin e tretë me anë të Kajës. Teuta arriti të shënonte edhe një gol, por nuk mundi ta përmbyste rezultatin. Vlen të theksohet se Korabi humbi shumë raste për gol, duke dëshmuar se rezultati mund të ishte edhe më i thellë.

Pas kësaj fitoreje ekipi do të udhëtojë drejt Peshkopisë, ku me 8 tetor do të luajë kundër Kamzës në ndeshjen e kthimit, e vlefshme për Kupën e Shqipërisë. Ndeshja e parë u mbyll barazim 1-1, ndërsa në Peshkopi do të luajë në një stadium të mbushur me tifozë, pasi ndëshkimi i FSHF-së nuk vlen për ndeshjet e Kupës së Shqipërisë.

* * *

Prezantimi i skuadrës dibrane Korabi si debutuese në kampionatin e kategorisë superiore, natyrisht që ishte shumë i mirëpritur, madje kurioziteti rritej kur skuadra u formatua thuajse e gjitha, ndryshe nga ajo e një sezoni më parë. Stafi i ri, me trajnerin Artan Mergjyshi dhe futbollistët e blerë, krijonin përshtypjen e një ekipi potent dhe që do të bënte një bum në futbollin shqiptar.

Veçmas blerjet më të fundit, sulmuesi i njohur Sebino Plaku që erdhi nga Skënderbeu si huazim dhe mesfushori po kaq i njohur në futbollin shqiptar, që erdhi nga Maqedonia, Blerim Nexhipi, ishin më shumë se shpresë, një gjetje e duhur në shërbim të rezultateve.

Në fakt, realiteti i ri nuk ka shkuar në këtë mendim të opinionit sportiv dhe jo vetëm. Në katër jave te kampionatit, skuadra ka dy barazime dhe dy humbje, duke grumbulluar vetëm 2 pikë. Konkretisht Korabi me Laçin në javën e parë mori barazim pa gola 0-0 dhe me Vllazninë në javën e katërt

Pas kësaj fitoreje ekipi do të udhëtojë drejt Peshkopisë, ku me 8 tetor do të luajë kundër Kamzës në ndeshjen e kthimit, e vlefshme për Kupën e Shqipërisë. Ndeshja e parë u mbyll barazim 1-1, ndërsa në Peshkopi do të luajë në një stadium të mbushur me tifozë, pasi ndëshkimi i FSHF-së nuk vlen për ndeshjet e Kupës së Shqipërisë.

doli me të njëjtat shifra 0-0. Por ka humbur në javën e dytë dhe të tretë me Skënderbeun 0-2 dhe Luftëtarin, rivalin direkt me shifrat 0-1.

Ndoshta ka qenë kjo humbja që indinjoi më shumë dibranët, të cilët prisnin një fitore shprese ndaj simotrës Luftëtarit, debutuese edhe ajo në superligën shqiptare. Fakti që ekipi ynë luan të gjitha ndeshjet jashtë qytetit të Peshkopisë dhe pa praninë e tifozerisë, natyrshëm ka ndikimin e vet, pa dashur të justifikoj aspak të tilla shifra që nuk justifikojnë merkaton e verës, përkujdesjen financiare të Selim Rusit dhe Naim Agollit, por edhe kushtet mjaft të mira që ekipit i janë krijuar prej më shumë se dy muajsh.

Gjithashtu, ekipi ka zhvilluar edhe ndeshjen e parë të kupës së Shqipërisë dhe ka barazuar pas një loje jo të mirë me Kamzën me shifrat 1-1 dhe goli i Prençit në fund të takimit, sikur e çliroi ekipin që të dielën ka ndeshjen e radhës me Teutën për javën e 5-të të kampionatit. Ndeshja e dytë e kupës së Shqipërisë në turin e parë të saj do të luhet me 5 tetor në stadiumin Korabi të Peshkopisë, sepse dënimi nuk është i vlefshëm për takimet e kupës, por vetëm në kampionat. Për ndeshjen me Teutën të dielën në orën 17-të, pritet një interesim tejet i madh, sepse Imer Lala ka vëne një sponsorizim për tifozët dibranë që vijnë nga Dibra dhe Tirana në drejtim të Durrësit, me mjete udhëtimi falas.

REZULTATET E KORABIT

Java e parë Korabi – Laçi 0-0
Java e dytë Korabi – Skënderbeu 0-2
Java e tretë Luftëtari – Korabi 1-0
Java e katërt Korabi – Vllaznia 0-0
Java e pestë Teuta – Korabi 3-2



Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit

ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit

<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

KOMENT

Për kë luan Korabi?

Nga **DËFRIM METHASANI**

Pas 54 vitesh, Korabi i Dibrës rikthehet mes skuadrave më të mira të futbollit shqiptar, duke prekur Kategorinë Superiore. Një sukses i tillë u përjetua në mënyrën më të mirë të mundshme nga mijëra e mijëra sportdashës, madje jo vetëm dibranë, sepse ishte një risi e bukur e vetë këtij sporti kaq popullor në vend, duke freskuar emrat që ishim mësuar thuajse t'i shihnim zakonisht vitet e fundit.

Për atë çfarë ndodhi në ndeshjen e fundit në Peshkopi përballë Kastriotit në Kategorinë e Parë sezonin e kaluar, skuadra dibrane është dënuar të luajë një vit pa spektatorë. Arsyet e dhunës së asaj ndeshjeje janë qartësuar dhe opinioni tashmë e ka mësuar prej kohësh të vërtetën. Korabi vazhdon të vuajë dënimin, edhe pse nuk luan në Peshkopi, por luan në mes të kryeqytetit pas një kontrate të mundësuar me klubin Tirana, ku i detyrohet çdo ndeshje me një shumë 2.5 milionë lekë të vjetër.

Dy javët e para, Korabi luajti përballë Laçit dhe Skënderbeut dhe sinqerisht të dukej se shihje një takim stërvitor, ose një ndeshje të pakuptimtë. Futbolli ka pasur, ka dhe do të ketë një mision: atë të argëtimit dhe kënaqësisë që dhuron te publiku. Krejt ndryshe duken ndeshjet që Korabi luan në një fushë asnjanëse dhe pa sportdashësit e tij. Vërtet duket paradoks që një ekip elitar si Korabi të luajë për policët, dhjetë zyrtarë dhe shkallët bosh.

Futbolli i kësaj forme, më mirë të mos luhet. Pa emocion, pa zhurmë, pa atmosferë, a thua se po i bëjnë të 40-at...! Ky dënim nuk vlen kur ekipi nuk luan në Dibër, por në Tiranë. Dibranët nuk pretendojnë t'i luajnë ndeshjet në fushën e tyre, sepse duan ta respektojnë dënimin. Por t'u heqësh të drejtën që të mos shohin futboll në mes të kryeqytetit, kjo duket absurde. Çfarë vlere ka dalja e një ekipi në Superiore?! Për kë luan Korabi, kujt i vlen ndeshja...?!

Pas Korçës dhe ndeshjeve të derbit, dibranët ishin të tretët në Shqipëri që mbushnin stadiumet. Një popull që edhe rrugë s'ka, por sakrifikon me orë të tëra për të ardhur në Tiranë të ndjekë skuadrën e zemrës, meriton që dikush ta vendosë dorën në zemër, jo për lëmoshë, por për drejtësi. Për t'i bërë jo nder Korabit, por futbollit shqiptar. Jam i bindur që asgjë nuk do të ndodhë në stadium, sepse asnjëherë tifozët dibranë s'janë shquar për dhunë, por kanë duartrokitur kundërshtarin kur ka luajtur më mirë se ekipi i tyre.

FSHF është drejtuese e futbollit në Shqipëri dhe jam i bindur që askush në atë institucion apo jashtë tij nuk është dakord me këtë praktikë. Një pyetje kemi për FSHF-në: Për kë luhet futbolli, për njerëz apo për mumie? Apo kemi shumë ekipe në Superiore dhe nuk dimë ku të shohim më parë...? Korabi po dëmtohet ekonomikisht, moralisht, por edhe në mënyrë sportive. Kjo skuadër debutuese ka nevojë për ndershmëri dhe korrektesë institucionale. Korabi erdhi me meritë dhe e zbukuroi Superioren, jo vetëm me emrin e bukur, por edhe me një ekip dinjitoz.

Të nderuar zyrtarë, Korabi dhe sportdashësit e tij kanë nevojë jo për lëmoshë, por për drejtësi, gjë e cila mungoi ndeshjen e dytë të kampionatit...! Iu mohua një gol i pastër, pa përmendur detaje të tjera. Futbolli mbi të gjitha është imazh. Po për çfarë imazhi mund të flitet në Superiore, kur dy ndeshje janë pa spektatorë, sepse edhe Luftëtari luan jashtë fushe, derisa t'i rregullohet stadiumi?! Nëse një kampionat është për të mbushur disa letra, atëherë më mirë të mos zhvillohet.

Pas Korçës dhe ndeshjeve të derbit, dibranët ishin të tretët në Shqipëri që mbushnin stadiumet. Një popull që edhe rrugë s'ka, por sakrifikon me orë të tëra për të ardhur në Tiranë të ndjekë skuadrën e zemrës, meriton që dikush ta vendosë dorën në zemër, jo për lëmoshë, por për drejtësi. Për t'i bërë jo nder Korabit, por futbollit shqiptar. Jam i bindur që asgjë nuk do të ndodhë në stadium, sepse asnjëherë tifozët dibranë s'janë shquar për dhunë, por kanë duartrokitur kundërshtarin kur ka luajtur më mirë se ekipi i tyre.

Ky shkrim nuk është thjesht një mendim personal, por është konkluzioni pas konsultave me shumë njerëz të sportit, stafin e klubit dhe drejtues institucionalë në Dibër. Dibrën të mos e duam vetëm kur na duhet, por kur duhet... Dibranët nuk dinë vetëm të heshtin, por edhe të protestojnë kur u cenohet e drejta e tyre...!

Rruga e Arbërit nr. 125
kulturë

Ylber Pilku kthen shtëpinë në një muze, ku vizitorët mund të njihen më mirë me Shqipërinë dhe shqiptarët

YLBER PILKU hap një muze shqiptar në mes të New Jorkut

Nga **VJOLLCA SADIKU**



Dibranët, kudo që janë në pjesën dërmuese nuk e harrojnë kombin, rrënjët, gjakun. Ato janë thuajse edhe më atdhetarë nga ata që jetojnë në vendlindje e vet. Këto vlerësime vijnë nga shumë veprimtari të mërgimtarëve, të cilët shumë më shumë u kushtojnë rëndësi dibranëve në vendlindjen e tyre. Nuk ka shtëpi të mërgimtarëve dibran në SHBA ku nuk ka flamur kombëtar, apo zbukurime në të cilët dominojnë elementet dhe fotografitë të personaliteteve kombëtar siç janë: Skënderbeu, Nëna Terezë, Isa Boletini, Fan Noli, Ismail Qemali etj.

Atdhetari i njohur dibran, biznesmeni Ylber Pilku, i cili ka migruar me familjen e tij në Amerika në janar 1988, sot jeton në Nju Jork dhe është një aktivist i dalluar i komunitetit dibranë. Dy-tri vitet e para i kaloi me vuajtjet dhe vështirësitë e fillimit, ashtu si ka ndodhur me të gjithë, duke punuar pa u lodhur në ndërtim. Pas tri vitesh Ylberi nisi biznesin e vet në fushën e ndërtimit. Sot ka një kompani ndërtimi, që është e specializuar për skelat e të gjitha madhësive, dhe për të gjithë lartësitë. Për shumë kohë ishte një firmë lider në SHBA.

Aktualisht, aktivitetin e tij ndërtues në SHBA e zhvillon në Kenerik, Nju Jork dhe në Nju Xhersi. Ka dhënë kontribut edhe për punësimin e bashkëvendësve të tij. Të panumërt janë ata dibranë që kanë shkuar në SHBA dhe që Ylber Pilku i ka ndihmuar që të sistemohen në punë dhe të kalojnë vështirësitë e fillimit. Ylberi, përveç suksesit në biznes, ka një shpirt të gjerë human. Sponsorizimet e tij për libra, për festa, për sëmundje etj., janë të shumta.

Nuk mund të harrojmë veprimtarinë që Ylber Pilku dhe familja e tij organizuan më 27 shtator 2013 në Dibër të Madhe me komunitetin dibranë në Tiranë dhe me iniciativën e shoqatës "Bashkësia Dibrane". Miqtë e tij, si prof. Burhan Cikuli, Saimir Shatku e Tofik Jegeni, ishin në këtë veprimtari. Me rastin e 100 vjetorit të kryengritjes kombëtare, 100-familje dibrane që jetonin në Tiranë erdhën në Dibër të Madhe për të takuar miqtë, vëllezërit dhe motrat e tyre. Lot, emocion dhe përmallje dhuroj kjo ngjarje për të gjithë pjesëmarrësit. Kështu, Beli - siç i thërrasin miqtë, ka fituar respektin e shumë njerëzve për shpirtin e tij human, për gatishmërinë e tij që t'i ndihmojë të gjithë ata që kanë nevojë për ndihmë e mbështetje.

NJË SHTËPI MUZE NË MES TË NJU JORKUT

Shtëpia e tij në Nju Jork është kthyer në një muze të vërtetë. Skulptura dhe piktura të personaliteteve historike shqiptare duke filluar nga Skënderbeut janë në shtëpinë e Ylber Pilkut. Në një dhomë të posaçme qëndrojnë skulpturat dhe veprat e tjera të figurave kombëtare, përfshirë edhe shumë libra historie dhe vepra të tjera të shkrimtarëve dhe historianëve të mirënjohur. Në këtë dhomë-muze ai ka pritur shumë mërgimtarë dhe personalitete të mëdhenj shqiptar dhe Amerikanë që e duan Shqiptarinë. Është një numër i madh i skulpturave, fotografive dhe sendeve me vlera kombëtare, dhe në to prezentohet Dibra, patriotët dibran dhe vendet historike shqiptare.

"Është kënaqësi të jesh në këtë shtëpi muze", - thonë ata që e kanë vizituar. Zyra e tij është si një muze i vërtetë i historisë së kombit shqiptar. Në zyrë ai mban një pllakat të madh me fotografitë e të gjithë patriotëve dhe të burrave të shtetit shqiptar, bustin e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të Lekë Dukagjinit, të Nënë Terezës, të Adem Jasharit, fotografi të Sali Berishës, Bujar Nishanit, Ymer Kelmendit, avokatit Avni Spahiut, Piter Fejit, senatorit Eliot Engëll, Xhejms Vakës, ambasadorit Filip Riker, të avokatit Bill Eduars etj. Ka, gjithashtu, plot relikte shpatash, revolesh e shumë gjera të tjera të vjetra e me përmbajtje historike.

"Në të ardhmen do të shpenzoj më shumë për të rritur numrin e pikturave dhe skulpturave në këtë muze", thotë Ylber Pilku.

Ylberi është i njohur jo vetëm në mesin e dibraneve por edhe në mesin e shqiptarëve në SHBA për veprat e tij patriotike. Nuk ka veprimtari atdhetare e kulturore që zhvillohet nga shqiptarët dhe dibranët me banim në State Island, Nju Jork, Nju Xhersi, Boston, Brooklyn e kudo në SHBA, ku Ylberi të mos dallohet ndër gjithë të tjerët. Ylber Pilku është i kudondodhur dhe ndër më të gatshmit për të kontribuar dhe financiarisht, për të kontribuar dhe në organizimin e veprimtarive të shumta që zhvillon ky komunitet shqiptar i dalluar për ndjesi atdhetare.

Ylber Pilku është ndër veprimtarët e ceremonisë së përvitshme të ngritjes simbolike të flamurit shqiptar në mes të Nju Jorkut, në Manhatten. Ylberi është organizator e kontribuues i të gjithë protestave në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve kudo në botë, kurdoherë në ballë të protestave dhe para selisë së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Ylberi është kurdoherë në mesin e veprimtarive politike që zhvillohen ne Amerikë me dibranët dhe me shqiptarët.

> Në këtë dhomë-muze ai ka pritur shumë mërgimtarë dhe personalitete të mëdhenj shqiptar dhe Amerikanë që e duan Shqiptarinë. Është një numër i madh i skulpturave, fotografive dhe sendeve me vlera kombëtare, dhe në to prezentohet Dibra, patriotët dibran dhe vendet historike shqiptare.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshme me këtë dibran, sepse ai jo vetëm është pasardhës i një dere me emër si ajo e Pilkeve, por është dhe nip i i Qokut të Iljaz Pashës e të Xhemal Pashës në Kllobçisht të Maqellarës, pasardhëse e fisit më të vjetër e më me zë të Gropjave e të gjeneralit të Skënderbeut, Zaharija Gropa.

Ylberi me familjen e tij shpesh viziton vendlindjen. Edhe në Dibër, ku ka edhe shtëpinë e tij, gjithmonë është i gatshëm të ndihmoje në veprimtari kombëtare dhe humanitare. Ai thotë se është i kënaqur nga puna e tij në SHBA, por shton se do të vazhdojë të kontribuojë për popullin dhe vendlindjen.

Shembulli i tij është një frymëzim edhe për qytetin e Dibrës, ku ka një kulturë shpirtërore por edhe pasuri kombëtare të pa ekspozuara. Puna e tij dëshmon se mërgimtarët tanë janë të kujdesshëm dhe i ruajnë traditat e tyre kombëtare. Ylberi sot është mjaft aktiv për çështjen kombëtare, mban kontakte të vazhdueshme me miq, bashkëpunëtor dhe dashamirës të atdheut. Ai është pranë shoqatës atdhetare "Dibra" në SHBA, "Bashkësia Dibrane" në Tiranë dhe "Oda Dibrane" në Shkupit, e më gjerë, të cilat e falënderojnë për mbështetjen dhe i urojnë suksese.



skica

Plagë që dhëmbin fort

Nga Dr. **Selman MEZIU**

Është dukuri fizike. Por edhe morale, shpirterore, psiqike kulturale. E përbashkëta e tyre është se të shkakton dhimbje. Mund të theri deri në shpirt. Mund të djegi për shumë kohe. Por edhe të të bëj të vuash fizikisht e moralisht. Shërimi mund të jetë mjekimi. Mirëpo po nuk pate mjetet, ilaçet, doktorin apo së paku ndihmës mjekun mund të pushosh së jetuari. Megjithatë ajo mbijeton bashkë me njeriun e qëniet e gjalla. Atëhere....

I SËMURI PËR MEND

U ula në tavolinën pranë murit. U pyeta me mikun e vjetër. Ai më kerkoi se çfarë do të pija. Morëm nga një gotë birrë. Kishim më shumë se një vit pa u parë. Sapo filluam, na u afrua nje djal i hequr në fytyre, i parruar, ballin me pak rrudha të imta. Trupin e kishte sa një gjel mish. Përplasi disa qindarka në tavolinë dhe tha:

Nje gotë raki,- dhe iku në drejtim të banakut.

Ikë ore tani se nuk jap, dil jasht,- i tha shitësi, dhe lëvizi dorën duke i treguar derën.

Ore une dua të pijë at..at, të..të bek... ueme, - duke u mbështetur te banaku se nuk e mbanin kamët. Era e qelbur e gojës mbushi klubin.

Saimiri u ngrit si me përtesë. I mbushi gotën. Duke i vënë dorën në sup e shoqëruar deri jasht. Ai ul pranë një tavolinë, i vetëm.

Historia e tijë, asht e dhimbështme, - e filloi tregimin Saimiri,- Punon karrocjer. Gjen pak punë, këtu në fshat. I ka dhane zoti katër vajza. E madhia ashtë me probleme psiqike. Pikturon çuditerisht. Por nganjëherë..... Prandaj i japin një pension. Ky faqeziu, i ban parat raki. I merr klubet me rradhë. Vjet u shtrua në spital. Nuk e di sa harxhoi. Se këtu or bashi i mikut, pa para nuk të shikojn as me sy e jo të shërojn. Nejse. Para mixhës së tijë, mjeku i tha, pasi e shëroi:

Betohu që nuk do ta pishë atë të shkretë raki. Se do të të vdes.

Nuk do ta ve as në buzë, iu betohem,- iu tha ai i shtrirë ende në krevat.

Por ai e vazhdon, biles më shumë. E tani do të shkoi në spital nga fillimi i shtatorit. Do të operohet për zorrën e trashë. Fëmijët i ka kockë e lëkurë. Librat e shkollës ia japin falas. Të varfër sa s'ka. Netë të shumta flenë pa darkuar. Pra asht për tu vra me bukë në gojë, siç themi ne knej.

Mu mbushën sytë me lot. Urrejtja dhe dhimbja u përzien në qënjen time keqas. Mblodha veten dhe mora numurin e telefonit të tijë, mikut tim. Ndërsa gotën e birrës nuk e mbarova. Nuk mundesha. U largova me një breng në shpirt.

Kaluan disa ditë dhe para se të hynte në operacion, u paraqita në spital. Me shumë ndërhyrje e shtruam. Ne prisnim për tu operuar. Por..... Në dere u bef vëllai i tijë duke na folur neve që prisnim jasht:

Pata marre dhjete mijë lekë të reja me vete. Por s'më mjaftuan. Kush ka para me vete, ju lutem, na i jepni borxh. Doktori e personeli po nuk panë ato në duar, nuk fillojnë operimin.

Të gjithë sa ishim, filluam të lëvizim, kërkonim xhepat e portofolat. Në duart e Astritit filluan të mblidheshin monedha letre të vlerave të ndryshme. Në mjediset spitalore kjo ishte ma se normale. Edhe pse çuditerisht e jashtëligjëshme.

Çfarë të bëjmë ndihmojmë të sëmurin për mend, pasurojm doktorin e të tjerët që kanë men, - tha nje nuse e re, teksa vështronte neve.

Sapo doli nga salla, i sëmuri nuk hapte sytë. Pasi i doli narkoza e pyetëm se si dukesh. Ai me zor shqiptonte fjalën, mirë. Atëhere ne filluam të largoheshim. Urimi yne ishte: Zoti të dhashtë men!

PLAGA E BLIRIT

Bulevardi i blijve zhurmonte nga skavatora e makinat e randa. Pluhuri shtëllunga shëllunga të shqetësonte pa masë. Puna që kishte filluar papritur i kishte shqetësuar qytetarët. Edhe blijtë e sakatuar nga prerja, nuk kishin lulëzuar simjet. Qytetarët dhe bletët e ndjen së tepërmi këtë dukuri fenologjike.

Ndërsa ecja përmes bulevardit, papritmas syri me kapi inxhinierin. Nuk munda të rrija pa e përshëndetur. Edhe pse unë diku e kisha atakuar.

Mirëmëngjesi Blerim,- i thashë dhe hodha dy tre hapa drejt tijë duke i zgjatur dorën.

Mire mëngjesi i dashur,- dhe vazhdoi,- siç e shikon, blirat kanë filluar të formojn kurorën.

Kështu duken, por tani kërkohet që nga fundi i tetorit, t'iu rrallohen degët, që kurora e re të mbaj sa më pak borë,- ndërhyra unë me kujdes e zë të butë.

Inxhinieri, uli kokën, u mendua dhe mezi i doli nga buzët e tijë fraza: -Më vjen keq, unë jam pushuar nga puna, kështuqë dikush tjetër shpresoi të ndërhyjë.

Nuk ka mundësi që një inxhinier si juve, me punë katër dhjetëvjeçarësh në lulishten e qytetit tonë, të pushohet kështu?- ndërhyra unë me një habi e mëdyshje të thellë.

-Përkundrazi. Pikërisht për ide të djathta,- më tha, me një ton të fort, por hidhërueshëm. Që unë ta besoja.



U largova duke e ngushëlluar. Ndërsa një punëtor me bluzë të verdh e helmet, me sopat po priste disa rrënjë të shtruara të një bliri. Në lartësinë një metra, pashë lëvoren e hequr në trupin e tijë. Ah ky skavatoristi sa i pamëshirshëm, mendova. Mu dhimbs sa s'dija si ta shprehja. Iu afrova e preka me pëllëmbën e dorës, e cila mu lag. Ndërsa e vështroja, mendoja. Kohën e ndëshkimeve. Njeriun që i shkakton dhimbje, plagë, natyrës dhe vetes. Dhe ai vetë, loton, vuan, lodhet, drobitet e ashtu përpiqet të jetoi. Përse vallë këto kohë të liga, ku lulet nuk çelin dhe njeriu nuk mund të qesh?

IDEJA E MADHE

Qyteti shtrihet në dy brigjet e një përroi. Formimi i tijë si i tillë bashkë me emërtimin, ka disa lakore, të pabindshme. Pasi zbrita nga makina hypa në një kodër. Qytetin e shikoj si në pllam të dorës. Edhe pse disa degë mollësh të vuajtme sa s'përshkruhet më



pengonin. Ato shtriheshin gjatë gjithë sipërfaqes, të rralla, të cfilitura nga sëmundjet dhe mungesa e kujdesit të njeriut

Pyeta bashkë shoqëruesin për emrin e saj. Edhe pse ai ma shqiptoi disa herë nuk po e kuptoja. Nevarm - ma persëriste ai. Në Varm, - ose e zbërthyre më tej. Ne varemi,– pra nga kjo kodër biem posht kodrinës deri në cepin e trekëndëshit të rrafshinës së Debrovës. Apo Ne varëm,- mos ndoshta këtu janë vënë trekandshat ku janë varur njerëz. Po pse nuk asht quajtur kodra e mollëve? Mendova aty për aty.

Nxora nga çanta skicën. Pra pikërisht këtu të krijohet një rrafshinë, fillova të flisja unë,- ku prapa të ndërtoheshin lokale, në tip kullash të stilit dibran. Para tyre të lihet e lirë, ku të shikohej panorama e qytetit e fshatrave per rreth deri buze drinit e muraja e maleve të Runjës, Balgjajt e Pratit. Edhe pse tani ky qytet asht në koma, me nje projekt të bastarduar. Të mbilleshin njolla me shkurre zbukuruese brenda e për rreth rrafshinës.

Mollët të lihen pa u prekur. E të zbritesh me shkallë të gjëra e në çdo dhjetë, metra sheshe pushimi me stola etj.Në tokën në rrafshinë të ndërtoheshin lulishte me lodra për fëmijë. Fusha lojrash për sporte të ndryshme. Parqe me drure e stola e belvedere. Kjo pjesë të lidhet me një urë, projektuar e ndërtuar me art, me bregun tjetër ku qytetarët të vinin lirshëm. Pse jo edhe natën me drita.

Dhe nëpërmjet këtij kompleksi të lidheshim me lagjen Deborve, ku nëpërmjet shkallëve të ngjitet deri tek rruga automobilistike që do te lidhte atë egzistuese me kalanë Antike të qytetit. Ku shikohen për bukuri shpatet e përroit të Llixhave. Peisazhe natyrale e fshatrash të mahnitëshme.

Sakaq ndjeva një të rënë në shpatulla, shoqëruar me një za të çjerrë:

- Ore, a jeni në vete apo jo! Ndalu pak he burrë.

- Pse çfare ndodhi?- I thashe unë i trembur e dosja me projekt idenë më ra në në tokë.

- A dini se duhen miliona e miliona. Sot nuk të asfaltojn rrugët e qytetit. E përroit i vjen era qelbësina. Ndërsa ti fantazon, -e ndjeva tonin e tijë të ashpër. U stepa. Por truri punonte si mulliri pa kokrra.

Vertet, qytetarët kanë halle të tjera. Pluhuri i makinave karrocave, kuajve e gomareve te mbyt e helmon në verë. Ndërsa në dimer baltrat të çerrojnë sytë. Atyre iu asht marrun fryma nga ndërtime badihava. Aq shume probleme ka ky qytet fshat sa ka dhjetëvjeçar që askush nuk po i a zgjidh.

Durimi me terhoqi për krahu. Unë hidhja hapat si në be të rreshme. U ula ne sedilje të makinës. Vërtet unë nuk paskam të drejt për një shbirim në të ardhmen e qytetit, katrahu sot? Po nesër kush do të përgjigjet? Mendoja e ndërsa makina veç ecte.

DËSHTIMI

Motorin e mbështeta mbi bordurën e tortuarit. Pluhuri e balta kishin mveshur pjesët e motorit piçiruk. Mbi zgarën prapa mora pakon me libra. Mirë që ishin mbështjell, se shtresa e pluhurit, dukesh qart. E fshiva pak me duar. Ai ra posht duke u shpërndar në pllaka. Një pjesë mbeti ndërmjet gishtërinjëve.

Hyri në librari. Raftet ishin mbushur plot e përplot. Iu drejtova njërës prej libra shitësve:

- A i blejnë librat?

- Pak fare, pak, kemi rënie të theksuar,- mu përgjigj ajo fytyr vrejtur.

Me hapa të qeta, por, të pasigurta iu afrova llogaritares. Pasi e përshendeta i zgjata pakon me libra:

Janë dy botimet e mia të fundit, dëshiroja t'i lija në librarinë tuaj,- i thashë dhe instiktivisht ia vura pranë kompiuterit.

Por për çudi, ajo mi shtyu me dorën që i dridhesh, dhe mezi më shqiptoi:

Para se ti marrë duhet të më firmosësh një kontratë.

Hajde, për hajr na qoftë,- ia ktheva unë dibrançe, dhe i buzëqesha. Por frika filloi dalëngadalë të më pushtoi.

Ajo filloi të më shpjegoi, që sipas ligjës së re duhet të merrni veç gjysmën e çmimit. Dhe kjo jo vetëm për këto që solle por për gjithe librat.

Çfarë është kjo mynxyrë, po edhe tek ne duan të fitojnë pa kandar,- me një zë tepër nervoz dhe të lart, saqë edhe librashitëset kthyen kokat duke më parë.

Qetësohu këto janë kushtet, vepro si të duash,- me tha ajo disi e përmbajtur.

U largova pa e përshëndetur. Më dukesh vetia se po shkoja drejt një errësire të pafundme. Pasi udhëtova me motor disa qindra metra, ndalova tek një tjetër librari. Por azgje nuk zgjidha. Mora ne telefon një shokun tim në një shtyp shkronjë. E njëjta muzikë zie.

Pas tre ditësh u ktheva. Lexova kontratën e firmosa. I gjindosur iu thashe, drejtorit dhe llogaritares së librarisë:

- Tanima kjo është e fundit herë, nuk sjell libra dhe nuk shkruaj. Po përse skllav jam une që të punoi për këto mafioz? Netë pa gjumë. Trurin ta lodh pa kufi. Për çfarë?

U largova, pluhuri e balta e motorit tim ishin shtuar. Ai më dukesh më i shëmtuar. Syte me ishin errësuar. Shpirti me ishte trazuar keqas. Goja më kishte marrë shije të hidhur. Ku po shkoi kështu vallë? Pyeta veten. Nuk e di! Një zë i brendshëm u përgjigj.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 125

botime

Profesor Çipuri është autor i 350 punimeve diturore me rreth 32. 560 faqe shtypi shkencor dhe publicistik.

Hasan Çipuri, "ky është vetëm fillimi..."

Nga **XHAFER MARTINI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Po ajo që përbën, si të thuash "Thembrën e Akilit" dhe e bën një dijetar "t'i rezistojë kohës" ka të bëjmë me pyetjen: çfarë veprash ka lënë? Cilat janë ato vepra fundamentale që nuk kanë qëllim të justifikojnë gradat "profesor" ose "doktor shkencash", kaq shumë të shpërdoruara, që e bëjnë një shkencëtar personalitet, figurë qëndrore të shkencës ushtarake? Në curriculiumin vitae që është përfshirë në materialet që do të përbëjnë këtë libër monografik, thuhet se Profesor Çipuri është autor i 350 punimeve diturore me rreth 32. 560 faqe shtypi shkencor dhe publicistik. Kjo është një punë kolosale e një njeriu të vetëm që nuk është në gjendje ta bëjë një institut i tërë. Por sasia nuk është kurdoherë cilësi. Një autor bashkëkohës dhe bashkëkombëtar me Servantesin, të dy spanjollë, ka botuar rreth 2000 vepra, por që janë harruar, kurse "Don Kishoti" i Servantesit shetit i vetëm dhe i ri në gjithë botën. Dhe kurrë nuk ka për ta ndaluar udhëtimin e tij. Me pak fjalë, sasia nuk të siguron as famë e as vlerë. Cilësia po. Lumturisht Profesor Çipuri ka edhe vepra të rëndësishme, qoftë si përkthime, qoftë edhe origjinale.

Një nga përkthimet e tij më të vlefshme është vepra "Serbët dhe Shqiptarët" të Shuflait. Kjo vepër ka rëndësi të madhe për historinë dhe kulturën tonë. Në këtë vepër gjuhëtari i madh është nga të parët që hedh dritë mbi të vërtetën historike të Shqipërisë, duke hulumtuar tek ajo shtresë e lashtë që ka të mbuluar një qytetërim të tërë, të panjohur dhe të pastudiuar më parë si për shkak të terrenit të vështirë të Shqipërisë Veriore, të mungesës së çdo lloj infrastrukture, ashtu edhe për shkak të presionit serb për të shartuar mbi kulturën dhe qytetërimin shqiptar kulturën e tyre të re që paraqitet si "nëna" e kluturave të tjera. Studiuesi i mirënjohur i kulturës shqiptare Gaetano Pettrota në veprën madhore: "Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare" thotë se një kontribut shumë i madh për kulturën shqiptare dhe "për historinë e Shqipërisë në mesjetë janë aktet dhe dokumentet e botuar nën kujdesin e albanologëve: L.Taloci, K. Jireçek, M. Shuflaj: "Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia", vëll. I-1913, dhe vëllim. II-1918. Kjo përmbledhje dokumentesh qe renditur nga Milan Shuflaj. Nga një letër e Shuflajt marrim vesh se ky dijetar kishte përgatitur një projekt që përmbledhja monumentale me dokumente për historinë e Shqipërisë të shkonte në katër vëllime. "Por për shkak të vështirësive ekonomike të pasluftës, Shuflaji nuk mundi të vazhdojë botimin e vëllimeve të tjerë ..." Sipas Profesor Demirajt, Milan Shuflaji ka kontribuar shumë për origjinën e ilirëve dhe të mesapëve. Ky dijetar vë në dukje bashkëpunimin gjuhësor midis shqipes dhe italishtes jugore të Abrucëve dhe të Puljes, që ka elemente të substratit të mesapëve e të japingëve, fise ilire të shpërngulura nga bregdeti ballkanik rreth shekullit të IX para erës sonë.." Përkthimi i veprave të këtij dijetari është një kontribut për të mbrojtur autoktoninë e shqiptarëve. Profesor Çipuri ka shumë përkthime të tjera nga gjuha serbokroate, natyrisht, jo të rëndësisë së veprës së Shuflait, por, sidoqoftë, një kontribut i madh për ndriçimin hap pas hapi të historisë dhe kulturës së popujve të Ballkanit, që fati historik i ka çuar të jetojnë në këtë rajon të ngushtë për të përballuar aq shumë dyndje popujsh, dhe për rrjedhim, mbushur me shumë konflikte dhe acarime, për të cilat shqiptarët nuk kanë qenë kurrë fajtorë. Profesor Çipuri nga serbokroatishtja ka përkthyer edhe vepra të tilla, si: "Disa pikëpmaje të doktrinës së re ushtarake jugosllave për luftën e përgjithshme popullore", ose "Pikëpamje themelore të doktrinës ushtarake jugosllave për organizimin dhe zhvillmin e luftës së përgjithshme popullore", të cilat unë nuk i kam lexuar dhe nuk ua di as qëllimin dhe domosdoshmërinë e botimit. Por, meqë këto dy materiale flasin për luftërat popullore të popujve jugosllavë, do të kisha dëshirë që Prof. dr.Hasan Çipuri me kulturën e gjërë dhe përgatitjen e lartë dhe të gjithanshme, të jepte kontributin e tij shkencor për të ndrçuar cilësitë dhe qëllimet e kryengritjeve popullore shqiptare në rrjedhat e shekujve, disa prej të cilave janë zhvilluar edhe kundër pushtuesve serbë. Elez Isufin, heroi i kryengritjeve të popullit dibran kundër pushtuesve serbë, për të cilin kam botuar dy monografi historike("Elez Isufi", 1993), dhe ("Gjenerali me shajak", 2012), në mënyrë metaforike e kam quajtur "gjeneral", por ai në të vërtetë i tillë ka qenë, por këtë mund të argumentojnë vetëm ata që njohin shkencën ushtarake dhe kanë një kulturë të tillë. E vërteta nuk duhet të acarojë askënd dhe unë, çdo vepër të kësaj natyre, që kontribuon për ndriçimin e historisë dhe kulturës së Ballkanit, do ta konsideroja një kontribut për tejkalimin e ngërçeve historike midis popujve të këtij rajoni të trazuar. Ballkani ka shumë nevojë për pranim të njeri-tjetrit dhe për mirëkuptim. Politikanët kanë punën e tyre, kurse dijetarët dhe poetët kanë punën e tyre dhe rolin e tyre të madh në këtë proces. Në veprën e mirënjohur "Ftesë në studio", kur bën portretin e Lasgush Poradecit, Ismail Kadareja, midis shumë të tjerave, shkruan edhe këto radhë:

> Unë do ta quaja Prof. dr.Çipurin një ballkanollog të madh që, me punën e tij të jashtëzakonshme, ka bërë veprime ndërkulturore të mëdha duke afruar edhe këta popuj me armiqësi të hershme dhe me konflikte ende të pazgjidhura.

"Një ditë më tha:"Kur e dënua me 80 vjet burg Viçens Prenushin, ai ishte 76 vjeç. "Më bëri përshtypje folja "e dënuam" dhe, duke kujtuar se e dëgjova gabim, i thashë:"Ju thatë "e dënuam", në mos gaboj? Atëherë e futni edhe veten në dënimin e tij?"Ai më vështroi gjatë siç e kishte zakon në kësi rastesh dhe u përgjigj:"Sigurisht. Poeti përgjigjet për çdo gjë".

Ky pasazh ka kuptim të thellë. Ai, në radhë të parë, tregon për absurdin e sistemit totalitar që një 76-vjeçar, e dënon me 80 vjet burg; e dyta, tregon edhe të vërtetën tjetër që Viçens Prenushin nuk e dënoi vetëm diktatura, por edhe zëri i munguar i intelegjencës shqiptare, mungesa e disidencës shqiptare, mungesa e trimërisë civilve, mungesa e të gjithë atyre që nuk duhej të mungonin, që ngarkojnë me përgjegjësi të gjithë ata që këtu i simbolizon Poeti.

Për rrjedhim të këtyre që thamë, përgjegjësia e dijetarëve është e madhe. Profesor Çipuri ecën në një shteg me dritë kur hap shtigje të reja për afrimin kulturor të popujve të Ballkanit. Ne, si shqiptarë, kurrë nuk kemi pasur ndonjë vepër me kundërsens kulturor. Përkundrazi, e kundërta ka qenë e vërtetë. Përkthimet e Profesor Çipurit nga serbokroatishtja janë një kontribut i madh edhe në aspektin e kapërcimit të ndasive



të thella si prodhim i historisë së popujve të këtij Gadishulli.

Duke u shkëputur nga fusha e përkthimeve të Profesor Çipurit, mendoj se veprat e tij më të rëndësishme që spikasin midis shumë syresh dhe që e bëjnë atë një figurë të ndritur të shkencës sonë ushtarake janë fjalorët dygjuhësh dhe shumëgjuhësh. Këto përgjithësisht janë fjalorë termash, si për shembull:

"Terminologjia ushtarake e gjuhës shqipe (studim monografik nga Rilindja deri në vitin 1990), me rreth 250 faqe shtypi, Tiranë 1993.

"Fjalori serbokroatisht-shqip,(për fushën ushtarake), Tiranë 1990, me 25 mijë njësi terminologjike, 524 faqe.

"Fjalori italisht-shqip",(për fushën ushtarake), Tiranë 1993, me rreth 25 mijë njësi terminologjike, 490 faqe shtypi.

"Gjuha serbokroate për fillestarët (tekst mësimor), Tiranë 1975, me 130 faqe.

Kurs i gjuhës serbokroate (tekst mësimor), Tiranë 1976, me 180 faqe.

Tekst i gjuhës serbokroate për shkollat e larta, Tiranë 1981, me 380 faqe.

Këto janë veprat individuale të Profesor Çipurit, veprat kolektive, siç thuhet për ato me bashkautor janë të shumta dhe nuk është e mundur të paraqiten në këtë parathënie. Disa prej tyre janë mjaft të rëndësishme si, për shembull, "Fjalori i termave të tipografisë ushtarake (shqip-anglisht-rusisht), Tiranë 1985, me 419 faqe; "Fjalori i termave të dëmtimit në masë dhe i mbrojtjes prej tyre" (shqip-anglisht-rusisht), Tiranë 1986,me 253 faqe; "Fjalori i termave të artilerisë" (shqip-anglisht-rusisht), Tiranë 1987, me 385 faqe e të tjera.

Në të gjitha këto vepra ai ka qenë drejtuesi kryesor, ashtu siç ka udhëhequr shumë tema dhe disertacione, ashtu siç ka kryesuar shumë komisione dhe redaksi, ashtu siç ka bërë qindra zëra për enciklopedi ushtarake dhe Enciklopedinë e Shqipërsë, ashtu siç ka hartuar shumë tekste mësimore për nevojat e shkollave të mesme dhe të larta. Kontributi i Profesor Çipurit nuk është vetëm në fushën ushtarake, por edhe në atë filologjike. Shumë artikuj janë për shpjegimin e kuptimit të termave, si: rokonjicion, konfiguarcion, kabotazh, kiç, kanonier, basen, shef, batare, konvoj, rikoshet, koaludim, dislokim, bronjuar, saltomortale, kadushkë, sambo etj. etj. Zëvendësimi i tyre me fjalë të brumit shqipes është për t'u vlerësuar lart. Ndërsa gazetarët, politikanët dhe ata që hiqen të ditur, por që janë injorantë, ia zënë frymën shqipes me lloj-lloj fjalësh të huaja, krejt të panevojshme, Prof.Çipuri e pastron vazhdimisht atë duke zëvendësuar edhe terminologjinë e huaj me atë shqipe. Çdo popull mbron gjuhën e vet. Gjermanët, me sa kam dëgjuar, edhe termat e mjekësisë që janë ndërkombëtare që nga koha e Hipokratit, i kanë gjermanizuar.

Fjalorët terminologjik për fushën ushtarake të botuara nga Profesor Çipuri janë kërkuar në disa vende perëndimore. Disa prej tyre ndodhen sot në bibliotekën e NATO-s në Bruksel, në Norvegji, Gjermani,Turqi etj. Veçanërisht në Komitetin e Terminologjisë ose në Agjensinë për standartizimin e Terminologjisë së NATO-s janë vlerësuar lart dhe janë konsideruar si punimet e para të këtij lloji nga një vend partner, siç deklaroi nënkoloneli Raymond Taillefer, bashkërenduesi i Terminologjisë së NATO-s në qershor të vitit 2000 në Bruksel. Fjalorët terminologjikë kanë një rëndësi të madhe për studimin, pastërtinë dhe pasurimin e gjuhës kombëtare. Vini re sa është rënduar dhe bastarduar shqipja nga depërtimi i fjalëve të huaja të panevojshme në fusha të ndryshme të jetës, sidomos në politikë. Është detyrë urgjente pastrimi i tyre nga gjuha shqipe, por kush do ta bëjë këtë? Profesor Çipuri, kaq shumë i ditur dhe i përkushtuar ndaj terminologjisë, i është kushtuar fushës së terminologjisë ushtarake, që, megjithëse ka rëndësinë e vet, nuk ka të bëjë me publikun e gjërë dhe me përdorim të përditshëm.

Unë do ta quaja Prof. dr.Çipurin një ballkanollog të madh që, me punën e tij të jashtëzakonshme, ka bërë veprime ndërkulturore të mëdha duke afruar edhe këta popuj me armiqësi të hershme dhe me konflikte ende të pazgjidhura. Dhënia e një çmimi të lartë për miqësinë dhe paqen mes popujve, sidomos për një rajon të nxehtë si Ballkani, do të ishte jo vetëm një vlerësim i lartë për Hasan Çipurin por për krejt popullin shqiptar dhe kulturën e tij të tolerancës dhe afrimit me popujt e tjerë. Akademia e Shkencave duhej të kishte me kohë në gjirin e saj këtë shkencëtar.

***

Me gjithë këtë kontribut, Profesori ka pasur peripecitë e veta në jetë, që ishin të natyrës së sistemit që kaluam, i cili nuk nguronte të shkelmonte edhe figura të tilla shkencore si Hasan Çipuri. Hasan Çipuri ishte komunist familjarisht. Por ajo parti edhe komunistët i shikonte me dyshim. Përzgjedhja e tyre nga gjiri i popullit nganjëherë bëhej shumë e vështirë për shkak të qëndrimit që mbajtën njerëzit gjatë Luftës II Botërore (Luftës nacionalçlirimtare), që qe një gur prove. Organizatat e partisë duhej të ngriheshin kudo. Duhej ngritur ajo, fjala vjen, edhe në Fushë Alie që luftoi kundër partizanëve. Ku ta gjeje atë lloj malli në atë fshat? Por nuk thonë kot që kur nuk ke pulën, han sorrën. I gjetën në fillim tre, pastaj u bënë tridhjetë, dashakeqës dhe dogmatikë, që, duke u bërë më katolikë se Papa, siç thuhet, u shkaktuan fatkeqësi njerëzve, pikërisht atyre me të shkëlqyerve. Të tillë ka pasur kudo dhe prej tyre ka vuajtur edhe Profesor Çipuri. Profesori është njeri që nuk ankohet, por rastin kur e larguan nga puna në Drejtorinë II të Komandës së Përgjithshme të FA, e kujton me dhimbje dhe indinjatë. Në atë detyrë nuk ishte emëruar me mik. Ishte në fillim të karrierës ushtarake, toger i ri, me rezultate të shkëlqyera në çdo cikël shkolle, zotërues i katër gjuhëve të huaja, plot vrull dhe energji!

(vijon në faqen 19)

Me rastin e 103 vjetorit të kryengritjes popullore dibrane të 22 shtatorit 1913

Kryengritja e dibranëve e Shtatorit 1913 në shtypin e kohës

Nga **Abdurahim ASHIKU**,
gazetar dibran

Këto ditë është folur aq shumë për Dibrën sa nuk është folur në të gjithë historinë e saj. Është sharë, është përbuzur si asnjë krahinë tjetër, është anatemuar si në koret e inkuizicioneve mesjetare, është përbuzur në gjak e në gjini.

Do të desha që të flitej për vlerat e saj historike, vlera që më së largëta lidhen me 18 betejat fitimtare të Skënderbeut në Dibër dhe plagëve të mëdha që ju hapën asokohe nga të qenët shesh beteje e mëni anadollake. Do të desha të flitej për betejën e jashtëzakonshme në dhjetëvjeçarin e dytë të shekullit të kaluar për mbrojtjen vetëm për vetëm të truallit të shenjtë shqiptar.

U fol për lypje, për miell e para, për shitje me flamurin e "brekëve të grisura" veshur.

Më vjen keq.

Si dibran që e dua Dibrën me shpirt, edhe pse jam njëmijë kilometra larg tash 20 vjet, por përcjell nëpërmjet një studimi të vjetër timin një fragment publik nga qëndresa, dhuna dhe harresa sa e saj...



Viti I, N. 25. Një numër 20 para. E Shtunë 9/22 Vjesht' e III, 1913.

PËRLINDJA E SHQIPËNIËS

ORGAN PER ME MPROJTUR TË DREJT'T KOMBËTARE.

DEL, NË VLONË, DITËN E MËRKURË E TË SHTUNËN.

Greqia dhe çështim i kufinjve të jugës

KUJTESË...

"Më parë se të vijnë luftëtarët në Dibër, - shkruan gazeta "Përlindja e Shqipërisë" Nr.13 Vjeshtë e Parë -1913 ushtria serbe burgoi tetëdhet veta nga parësia e vendit, me qëllim që t'i vrasin dhe të nesërmen, Kur u rradhuan për me i plumbos, i arritën Malësorët, andaj s'munden me i vra të gjithë, por veç pesë shpirt.

Këta janë ata që ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emënat e tyne për një kujtim të përjetshëm: Sheh Hyseni, SadullahStrazimiri, Ramiz beu, Karafil beu, Numan Efendiu. U ndrittë shpirti".

Dibra, kryengritja popullore kundër pushtuesve serbë dhe politika e egër e gjenocidit ndaj shqiptarëve që ushtronin shovinistët serbë, zë, në prag të Luftës së Parë Botërore, faqet e para të shumë gazetave të kohës që botoheshin brenda dhe jashtë vendit.

Jehonë të gjerë bëri veçanërisht kryengritja popullore e shtatorit e vitit 1913.

Gazeta "Shqypnia e re" e cila dilte dy herë në javë, mundohet ta pasqyrojë kryengritjen popullore në Dibër gjerësisht. Në lajmin me burim nga Vlora të datës 25.IX, gazeta jep sihariqin: "Dibra asht marrun me nji luftë të rreptë të shqiptarëve, të cilët e kanë ndjekunanmikun deri në fushë të Ohrit"

Në lajmin e po asaj date, por tashmë në mbrëmje dhe nga një burim tjetër, Elbasani, theksohet se "Dy sahat ma parë erdh nji njeri prej sheshit të luftës, i cili lajmon se anmikukje shty deri në Pyll të Zezë dhe i muernë 11 topa, 2 mitraloza dhe shumë xhephane", se "Lëvizje e madhe ka edhe ka ana e Lumës dhe e Prizrenit".

Në të dy lajmet e tjera, që botohen në faqen e katërt e që janë marrë në kohë të ndryshme të natës, tregohet se "Lufta u nis në malësi. Malësorët kryengritës bashkë me qytetasit e Dibrës të dishpruem nga barbarizmat serbe i ranë anmikut dhe e shtynë në tri anë, në Gostivar, në Kurçovë e Strugë. Zaptuen 13 topa, xuen 300 serb rob e prishën fare pesë batallona"

Në një lajm të datës 27 shtator tregohet se jo vetëm Struga, Gostivari e Ohri janë marrë , por është marrë edhe Gjakova, ndërsa Prizreni është rrethuar.

Dy lajme të tjera të marrë njeri më 27 shtator në mbrëmje e tjetri natën, vetëm pak orë para botimit të gazetës, tregojnë se "Në Ohër asht ngrehun qeveria shqiptare".

Kjo dendësi lajmesh, ky interesim për ngjarjet, duke i ndjekur ato ditën dhe natën, tregojnë se ato ditë jetohej me ngjarjet e Dibrës, me luftën e popullit shqiptar për mbrojtjen e tërësisë tokësore.

Një tablo të plotë, jo vetëm të teatrit të luftimeve, por edhe të heroizmit popullor, na jep gazeta "Përlindja e Shqypnisë", Organ i Qeverisë së Vlorës. Madje ajo na jep edhe emrat e atyre që "ranë dëshmorë për lirimin e atdheut të vet, të cilëve historia meriton t'i shkruaj emnat e tyne për kujtim të përjetshëm".

Në këtë numër gazeta, duke folur për "malet plotë famë e nder", luftën dhe unitetin luftarak të tyre thotë: " Sot, pra, ka një marrëveshje të plotë midis dy Dibrave...Me gëzim të madh luftëtarët tanë ngritën flamurin e Shqipënies... Qytetet qeverisen prej një komisie popullore" duke nxjerrë në pah unitetin, qëndrueshmërinë, aftësinë për tu vetëqeverisur-probleme këto që janë diskutuar gjerë në këtë kohë në kanalet diplomatike e që i mohoheshin popullit shqiptar.

Burim lajmesh për gazetën "Liri e Shqipërisë", që botohej në Sofje, fillimisht janë agjencitë e huaja, të cilat theksojnë se "...shqiptarët e muntnë ushtrinë serbe pranë Dibrës dhe muarnë këtë qytet e po përparojnë drejt Ohrisë dhe Kiçovës"

Lajmet e agjencive dhe gazetave të huaja ajo i ballafaqon me lajmet që vijnë nga Beogradi duke theksuar se "Këto lajme duket se janë të vërteta se, në Belgrad janë shumë të trembun dhe po bëhen përgatitje të mëdha për të shuarë lëvizjen shqiptare, e cila po përhapet në tërë Kosovën". Gazeta fillon ta ndjekë luftën e dibranëve kundër pushtuesve serbë nëpërmjet korrespondentëve të saj në Durrës, Elbasan, Manastir etj., duke na pasqyruar hapat e kryengritjes, rritjen e saj, pjesëmarrjen e masave popullore, qëndresën e dëshpëruar të pushtuesve.

"Dishnica", një firmë që pasqyron ngjarjet në gazetë, ngre në një piedestal të lartë heroizmin popullor kur thotë: "Këto lajme mbushin me gëzim zemrat e shqiptarëve dhe i japin Evropës një mësim të plotë që kurrë shqiptari s'do durojë të jetë nën zgjedhë dhe se vendimet e Londrës s'mund të kenë forcë..."

Në gazetat e kohës shquajnë tituj të tillë si: "Dibranët dhe malësorët përreth po luftojnë kundër serbëve", "Dibranët dalin fitues në shumë beteja me serbët", "Dibranët janë 6 000". "Luftime të rrepta në Dibër". "Serbët hëngrën shuplakë nga shqiptarët e Dibrës", "Dibra shqiptare" etj.

Me gjithë politikën e heshtjes, që ndoqën fuqitë e mëdha ndaj ngjarjeve në Shqipëri, në këtë periudhë e veçanërisht ndaj kryengritjes popullore në Dibër dhe politikës së paparë të gjenocidit që ushtruan shovinistët serbë ndaj shqiptarëve, agjenci të ndryshme lajmesh, gazeta të ndryshme nuk munguan që të ngrenë zërin e tyre në anë të kryengritjes popullore të Dibrës. "Giornaled'Italia", "Wiener Alge meineZeitung", "NeueFreiePress", "The dal mail", "Reichpost" etj., e pasqyrojnë kryengritjen e Dibrës që në ditët e para duke u munduar ta datojnë sa më saktësisht (10 të muajit, ora 10 në mëngjes), duke u munduar të japin edhe numrin e luftëtarëve ("Shqipëtarët 6.000 vetë"). Gazeta Wiener Alge meineZeitung", duke folur për fqinjët e kryengritjes së Dibrës, na jep gjerësinë e luftës së shqiptarëve për të mbrojtur truallin e tyre shekullor. Ajo thekson: "Gazeta lajmërohet prej Shkodre se çeta shqiptare nën kryesinë e Isa Boletinit dhe të Bajram Currit, u përpoqën dhe i shtynë ushtritë serbe në Dibër dhe afër Prizrenit. Ushtarët malësorë i zunë gjithë malet e kufijtë.

"Giornaled'Italia" tërheq vëmendjen edhe për shqetësimet në Beograd: "Lajmi i të hymit të shqiptarëve në Dibër i turbulloi fare mendjet në Beograd. Me pesë ditë, thonë gazetat e Serbisë, do të gjenden në Shqipëri 40.000 ushtarë serbë"

Shtypi në këtë periudhë tërheq vëmendjen kryesisht në dy çaste kryesore; në qëndresën masive e heroizmin popullor kundër pushtuesve dhe terrorin e egër dhe reprezaljet e serbëve ndaj shqiptarëve. Barbarizmat, që u zhvilluan ndaj shqiptarëve, Fuqitë e Mëdha u munduan t'i mbulojnë me heshtje. Megjithatë gazetarë të disa gazetave më në zë të kohës, diplomatë e të dërguar të ndryshëm duke udhëtuar nëpër Dibër e në viset e tjera shqiptare, nuk mungojnë të ngrenë zërin e t'i japin shtypit dokumente të pakontestueshme për barbarizmat dhe mizoritë serbe.

Gazeta "Corriere de la Puglie" qe ndër të parat që përshkroi "Barbaritë serbe në Dibër". Bazuar në "shënimet që kishte marrur, duke shëtitur të gjitha vendet i dërguari i një fuqie të Evropës dhe pas të cilave i bëri guvernës së vet raportin".

Në këto përshkruhen reprezaljet e bëra në 103 fshatra, duke treguar me adresë të plotë varjet, vrasjet dhe djegiet në zjarr të mbi 1700 burrave, grave e fëmijëve. Djegien e mbi 1 600 shtëpive. Grabitjen e mbi 2 700 bagëtive të trasha, 21 000 të imta dhe 800 njëthundrakëve, grabitjen e një sasie të madhe lirash që e kalonin milionin. Në këtë numër nuk janë futur barbari të tilla masive që raporti i përmbledh me fjalët: "plaçkitën tërë fshatin dhe pasi morën gjithë ç'gjetën i vunë zjarrin dhe e dogjën fund e krye", "Gjindjen; gra, burra e çilimi i shkuan të gjithë në bajoneta", "s'është punë që mund të rradhiten emrat e gjithë të vrarëve"

Barbaritë arritën në kulme të tilla: " të zotin (e shtëpisë A.A.) e therën në sy të s'ëmës plakë, të së shoqes dhe të fëmijës", "vranë me bajonetë një çupëz 6 vjetë", "hodhën të gjallë në zjarr një djalë 5 vjetësh, Shyqyrinë dhe një 4 vjetësh, Hasanin", "Zenelit i dogjën në zjarr gruan me një djalë në djep" etj., etj.

Një tablo ngjethëse të mizorive serbe jepet edhe në një përshkrim të titulluar "Udhëtim në Gollobordë" botuar në faqet 4 e 5 të dy numrave radhazi të "Përlindja e Shqipërisë" të janarit 1914.

"Udhëtimi" ishte një raport i hartuar nga një ambasador i huaj nëpër krahinën e Gollobordës fill pas shtypjes së kryengritjes së shtatorit 1913 dhe "amnistisë" që gjoja shpalli qeveria serbe për pjesëmarrësit e kryengritjes në tetor 1913. Dokumenti, sipas KristoFrashërit (Historia e Dibrës), iu përcoll më 19 dhjetor 1913 njerës prej fuqive të mëdha. Dy ditë më vonë, më 21 dhjetor 1913, ai do të botohej në përkthimin italisht në gazetën italiane "CorrieredellePuglie" e marrë prej saj në janar 1914 në gazetën "Përlindja e Shqypëniës"

Në gazetat e kohës, jehonë të madhe bëri letra e një ushtari serb, botuar në gazetën socialiste serbe "RandiçkaNovine" më 22 tetor 1913, letër e cila u botua më pas në shumë gazeta të kohës.

"Shoku im i dashur, shkruante ai, gjëra të tmerrshme po ngjajnë. Unë po tmerrohen para tyre...Në këto anë nuk shikohet gjë tjetër veç kufomave dhe hirit"...

"Shqypnia e re", në numrin e saj të 20 nëntorit 1913, duke folur për barbarizmat serbe, nxjerr në pah edhe devizën e pushtuesit: "Asnjë t'falun, asnjë pshtim", ç'ka flet për egërsinë e pashembullt të këtij rrebeshi mesjetar ndaj shqiptarëve në trojet e tyre shekullore.

Kryengritja e shtatorit 1913 në Dibër ishte një kryengritje popullore, një kryengritje e masave, që ngriti në këmbë, siç theksojnë gazetat, mbi 6 000 luftëtarë. Dibra në këtë luftë foli me grykën e pushkës. "Do të vijë ora, thoshte Luigj Gurakuqi në një intervistë botuar në gazetën "Atdheu" ato ditë, kur populli ynë do të organizohet në udhën që do t'i tregojë organizimi i tij politik, gjer atëherë nuk mbetet veçse udha e armëve... Buçitja e armëve dëgjohet shpejt në veshët e Evropës. Do ta përdorim sa herë që veshi i Evropës është i shurdhër, që të na dëgjojë zërin, i cili nuk do të pushojë së kërkuari drejtësi"

Për vetë kushtet e asaj kohe me mjete të pakta komunikimi e ndërlidhjeje, mungesë kronistësh në fushën e betejës etj., dhe mbi të gjitha të politikës së heshtjes që ndiqnin Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe shtetet ballkanike, lidhë kjo edhe me prapaskenat e turpshme që thurnin në kulisat e diplomacisë së fshehtë, gazetat arritën vetëm sa ta preknin problemin e Dibrës dhe barbarizmat që u ushtruan ndaj saj, politikën e një gjenocidi të tmerrshëm që u veprua në këtë kohë ndaj shqiptarëve me banim në trojet e tyre shekullore.

Dokumentet arkivale e në veçanti popullit me gojën e tij, janë një pasqyrë më e plotë e madhësisë dhe e forcës së kryengritjes popullore të Dibrës, e heroizmit popullor në luftë.

Dibra është treva e vetme shqiptare që u përball me ushtrinë e egër serbe pa ndihmën e asnjë krahine tjetër, e përgjaku, u përgjak sa askush, u pre egërsisht nga hanxhari i Londrës 1913 dhe hanxharët e viteve që pasuan, humbi përgjithnjë kryeqendrën e vet Dibrën e Madhe banorët e të cilës (mbi 20 mijë) ikën natën me dhimbjen më të madhe për të bërë vend në Elbasan e Tiranë.

Në Tiranë ka një lagje të madhe me emrin "Lagja Dibrane" që numron rreth 70 mijë pasardhës të gjenocidit serb ndaj një treve në qendrën gjeografike të shqiptarëve.

Në Shkodër ka një varrezë me emrin "Varret e Dibranëve". Atje prehen trimat dibranë që luftuan që Shkodra të mos i jepet Malit të Zi. Dhe luftuan në një kohë kur Dibra luftonte me serbin për të mos ia lënë qytetin dhe luginën e bukur të Drinit të Zi Serbisë.

Athinë, 22 shtator 2016

Fotoreportazh / Udhëtim në kohë

Vjeshta dibrane midis ngjyrave të arit dhe ylberit

Midis fotove do të gjeni djersën e njerëzve që krijuan plantacionet e mëdha frutore në Dibër dhe mendimin e ri për krijimin e blloqeve bashkëkohorë të mollëve...

























Veprimtaria e Bledarit vazhdon, repertori i tij rritet çdo ditë, kënga e tij jehon, suksesi marshon. E bashkë me suksesin, Dibrës po i shtohen artistë çdo ditë.

Bledar Kaca, talenti i ri i këngës popullore dibrane

Nga **Dritan BRUNGA**

Bledar Kaca, nga Tartajt e Zall Dardhës, vjen nga artistët e rinj që po e kultivon me sukses këngën dibrane

Zalldardha e Dibrës njihet si një zonë me tradita të rralla në historinë dibrane, të trimërisë, zgjuarsisë, penës, folklorit të larmishëm të saj, mikpritëse e bujare. Ajo shtrihet buzë Drinit të Zi, rrethuar nga një reliev malor shumë piktoresk.

Kjo zonë e Dibrës gërsheton për bukuri gjithçka që dëgjon e shikon, ka nxjerrë njerëz me emra të mëdhenj në çdo fushë, që njihen në Shqipëri, Kosovë e kudo në diasporë. Janë talente të rrallë që vetëm vijnë e i shtohen çdo ditë e më shumë, duke u futur në radhët e faqeve të artistëve të Dibrës.

Këto radhë unë po ia kushtoj një emri të ri, që padyshim është sukses, e ky është Bledar Kaca nga Tartajt, një fshat i vogël i Zalldardhës, me njerëz punëtorë, të rrallë në besë e mikpritje.

Bledari ka filluar të këndojë që në vitin 2002. Fillimisht në gëzime familjare, në dasma, ku u pëlqye shumë për zërin e tij. Më pas këndojë me Grupin e Zalldardhës, ku mori pjesë për rreth dy vjet, ku këndoi në veprimtari e koncerte që zhvilloheshin në Peshkopi, Burrel etj.

Ashtu si shumë banorë të tjerë, meqenëse jeta në atë zonë malore është e vështirë, mungon infrastruktura dhe çdo gjë tjetër elemetare për jetesë, si rezultat i moskujdesjes së shtetit, Bledari shpërngulet nga Tartajt e ikën me banim në Durrës. Për këtë arsye u detyrua të linte edhe grupin artistik të vendlindjes, por talenti i tij nuk do të ndalej. Bledari e vazhdoi këngën përditë e më bukur, përditë e më të pëlqyer nga publiku. Në Durrës e nisi me një grup të vogël në dasma, fejesa, ditëlindje dhe shumë shpejt do të dukej talenti i tij, e do thirrej në Kosovë, në trojet shqiptare në Maqedoni, Suedi, Greqi etj.


Bledar Kaca

Bledar Kaca është modest. Nuk i pëlqen që këngët e tij të jenë doemos në Youtube, nuk i pëlqejnë reklamimet me tepri dhe që po të kërkosh në internet, gjen fare pak për Bledarin, këtë artist të ri të këngës dibrane. Fama dhe zëri i tij do të dëgjoheshin shpejt, kur para disa muajsh, erdhi me këngën: "Mos harro se je Dibran". Kënga sapo doli u prit shumë mirë dhe u klikua shumë në rrjet e u dëgjua anembanë. Ajo e bëri të njohur Bledarin, duke parë tek ai talenti artistik dhe këngëtarin me një zë të ngrohtë e melodioz. Dibranët të pyesin për këtë talent të ri, pasi ai kishte qëndruar shumë kohë "në hije", pôr ja që puna e tij del vetë në dritë , se artisti dëgjohet edhe pa u reklamuar. I miri zë vendin e vet në të mirë, vlera i rritet dhe mundi nuk i humbet.

> Bledari e vazhdoi këngën përditë e më bukur, përditë e më të pëlqyer nga publiku.
>
> Në Durrës e nisi me një grup të vogël në dasma, fejesa, ditëlindje dhe shumë shpejt do të dukej talenti i tij, e do thirrej në Kosovë, në trojet shqiptare në Maqedoni, Suedi, Greqi etj.

Babai i Bledarit, Shefqet Kaci, ka punuar në Lurë si mjek rreth një dekade (1976 - 1986). Duke qenë mik shpie i Kacës, në një farë lidhje gjaku, kërkova të bisedoj me këtë artist të ri të këngës këngës popullore.

Nga biseda telefonike me Bledarin mësova ai nuk ka "dorë" që e ndihmon. Ai çdo gjë e bën vetë, me punën. Këngën e ka shpirt, e ka talent, nuk kursehet në shpenzimet që bën, pasi si i ri sponsorizimet i mungojnë, e ndoshta edhe nga sedri i tij, nuk ka kërkuar ndonjëherë ndihmë nga dikush.

"Dibrës i këndove, i thashë gjatë një bisede telefonike. E tani dua t'i këndosh një këngë Lurës. Jo se nuk ka Lura talent, se Lura i ka tashmë edhe Grupin e Lurës edhe Legjendën e madhe të këngës ,por se jam kurioz: A i Këndojnë Lurës këta talentet e rinj?".

Kaq u desh, e Kaca ma ktheu: "Me gjithë zemër! Unë e kam nder e respekt t'i këndoj Lurës, por duke qenë dhe si zonë kufitare, jam nga Tartajt, por jam dhe i lurjanë se jam rritur në Lurë".

Nuk e zgjatëm shumë bisedën, por i postova tekstin e këngës, që këtë radhë e sjell këtë artist, sukses si këngëtar, me një repertor të ri: "Kushtuar Lurës së Dibrës!"

Veprimtaria e Bledarit vazhdon, repertori i tij rritet çdo ditë, kënga e tij jehon, suksesi marshon. E bashkë me suksesin, Dibrës po i shtohen artistë çdo ditë. Kjo na bën krenar që jemi dibranë, lum si Dibra për bijtë e vet. I uroj shumë suksese Bledarit, maja të larta, nga ku të shikosh shumë larg. Uroj që edhe dibranët që kanë mundësi të ju afrohen e mbështesin, në mënyrë që talentet e reja të mos humbasin, të përfaqësojnë e ngrenë lart fise e zona të Dibrës. Njëherësh, me talentin e tyre, të ngrenë lart edhe emrin Shqiptar.

Paris, 1 shtator 2016

Këngën e re mund ta ndiqni në linkun e mëposhtëm:
http://www.dailymotion.com/video/x4sj943

Hasan Çipuri, "ky është vetëm fillimi..."

(vijon nga faqja 16)

Me të krenohej shkolla, pedagogët, miqtë e shokët, por më shumë duhej të krenohej Dibra dhe sidomos vendlindja e tij, por jo. Dibra, siç e kishte zanat për t'i groposur më të mirët, për t'i tërhequr poshtë e më poshtë, mundësisht për në skëterrë, përgatiti skenarin edhe për togerin e ri dhe të talentuar Hasan Çipuri. Në Dibër, më duket, ka lindur ajo fjala e urtë që "Hasmin ta ban nana" dhe tregimi alegorik me këtë përmbajtje: kishin qenë dy vëllezër që i bënë një shërbim shumë të çmuar mbretit dhe ky vendosi t'i shpërblejë se qenë njerëz të varfër e nevojtarë. Por mbreti u vuri një kusht: Ai që do të kërkonte i pari, do të merrte atë që kërkonte, kush të kërkonte i dyti, do të merrte dyfishin. Asnjeri nuk e hapi gojën. Më në fund,vëllai i madh tha: "O mbret, ma nxirr mua njerin sy që vëllait tim t'ja nxjerrësh të dy." Ja, pra, kjo është Dibra. Ajo e përgatiti letrën denoncuese, shkruar dhe firmosur nga ata që nuk donin që ta kishin dibranin e ri në komandën e Forcave të Armatosura.

Akuza? E shpifur, por nuk kishte shumë rëndësi. Ta turbullonin një herë ujin, pastaj, ai mund të mos qartësohej kurrë, por, edhe sikur të ndodhte kjo e fundit, goditja, ndërkohë, do të ishte dhënë. Mund të kalonte shumë kohë për ta marrë veten. Të më falin Profesori dhe lexuesit që në parathënien për librin kushtuar atij po i jap rëndësi të madhe këtij episodi, por kemi të bëjmë me një rast që Profesorit ia tronditi jetën, kurse disa të tjerëve,(Dibra nuk ka vepruar kështu vetëm ndaj Profesorit), u ka dhënë goditje aq të forta sa nuk arritën më kurrë ta merrnin veten. Madje disave u hapi edhe varrin. Pra, nuk kishte fort rëndësi nëse akuza ishte e drejtë apo jo. Në përgjithësi goditja jepej për dyshimin më të vogël, ose jepej në bazë të një verifikimi të përciptë, ose jepej thjesht për ambicie personale, se kishte edhe aty, rreth e rrotull togerit të ri, njerëz të cilëve ai u bënte hije me personalitetin e tij njerëzor dhe shkencor. Ata nuk donin ta kishin afër, nuk donin të kishin të bënin me të. E pra, shyqyr që na erdhi denoncimi i zi! Sikterosur qoftë. Ka mbaruar shkëlqyeshëm! Punë e madhe! A nuk qenka gjeni! Pse, ne që nuk kemi mbaruar shkëlqyeshëm, madje që nuk kemi as shkollë të madhe, nuk dimë ta kryejmë detyrën? Besnikëria ndaj partisë në radhë të parë! Pastërtia e radhëve të partisë! Dhe në emër të kësaj pastërtie të mos hezitojmë asnjë çast. Sikterisu, t'i themi. Partia na ka vënë ne këtu që të gjykojmë për këto punë. Kështu e gjykuam ne, do të themi. Ishte akuzë që nuk mund të tolerohej. Po cila ishte akuza? Ajo ishte hiçgjë: ju gjetën do dajallarë ballistë. "Ishte fjala për Riza dhe Haqif Sopotin nga fshati Brezhdan, të cilët ishin kushërinj të tretë të nënës sime, se babai Ali Sopoti i kishte vdekur shumë heret dhe si familje ishin shkretur", shkruan për këtë rast Profesori. Kjo ishte akuza e parë, krejt e pathemeltë, krejt gënjeshtër. Akuza e dytë: motra e Profesorit, Hikja, ishte martuar shumë kohë para çlirimit me Jonuz Lushin nga fshati shqiptar Vraçisht i Gostivarit. Kur midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë u prishën marrëdhëniet, kjo miqësi u interpretua sikur ishte lidhur ato ditë direkt me Titon ose Kardelin për inat të Partisë së Punës. Përfundimi, me të dyja këto akuza qesharake togeri i ri u dërgua oficer me trupa në Burrel. Pasi ai, më në fund, arriti ta sqarojë pozitën e tij, e dërguan në komandën e divizionit në Shkodër, pastaj u transferua në ishullin e Sazanit ku jetoi dhe punoi shtatë vjet.Mund të qëndronte atje edhe më shumë sikur të mos shkonte për vizitë Ministri i Mbrojtjes së asaj kohe Beqir Balluku, i cili për arsye shëndetësore, e transferoi Hasan Çipurin në Tiranë, pranë Drejtorisë II të MMP. Ja, mbas tetë-nëntë vjetësh e drejtat e Hasan Çipurit u gjet. Ma merr mendja se çdo njeri tjetër që nuk e kishte këmbënguljen e tij, do t'i ishte ftohur dëshira për t'u marrë me punë shkencore; do të kishte preferuar më mirë rolin e një oficeri të zakonshëm që bën detyrën dhe rri rehat. Të merresh me shkencë, të përkulesh mbi fjalorë dhe mbi vepra të tjera diturore, të mos kesh kohë të lirë për të pushuar dhe për ta gëzuar jetën, të mos i kushtosh kohën e duhuar as familjes, është sakrificë e madhe për një njeri, sakrificë që e kuptojnë dhe e besojnë vetëm ata që kanë botuar vepra të atij niveli. Pra, bëmë fjalë për një goditje që Profesorit iu dha në moshë të re dhe ai, duke qenë natyrë e fortë shpirtërisht, e përballoi, ndonëse jo pa pasoja. Kështu goditje u jepeshin më të mirëve, më të aftëve, më të talentuarve. Goditjet vinin jo vetëm prej natyrës së sistemit, jo vetëm prej paranojës së Enver Hoxhës që kudo shikonte armiq, por edhe për faktin se gjithnjë në atë sistem vihej karroca para kalit, dhe goditej kali që nuk po ecte. Në atë sistem përgjithësisht merrnin detyra të rëndësishme të rëndomtit, që nuk kishin asnjë aftësi, asnjë prirje, asnjë talent, përveç talentit për të thurur intriga në kurriz të të aftëve, të të talentuarve. Shefat e burimeve njerëzore të asaj kohe, ose siç emërtoheshin atëherë- shefat e kaudrit, ishin njërëzit më të paarsimur, më të indroktinuar, më dogmatikë, më absokurantë, me një shpirt shumë regresiv.

***

Dhe në fund, në mbyllje të këtyre mendimeve, desha ta falenderoj dhe ta vlerësoj qëllimin dhe punën e z. Enver Kaloshit për të shkruar një libër për Prof. dr.Hasan Çipurin. Këtë unë nuk e lidh me asgjë tjetër veçse me dëshirën e Enver Kaloshit për të vlerësuar ata që e meritojnë, prandaj e konsideroj jo vetëm një akt kulturor, por edhe një akt patriotik, se atdheu, kombi e kanë si kërkesë themeltare nderimin dhe përkujtimin e atyre që kanë punuar për ta.

Libri mund të mos jetë i asaj gjithëpërfshirjeje për të pasqyruar jetën dhe veprën e Prof. dr. Hasan Çipurit, por, sidoqoftë, ai përmbushë, si të thuash, kërkesat emergjente që një figurë aq e madhe e me aq shumë kontribut të dalë nga errësira, dhe të zërë vendin që meriton. Njerëz si Profesor Çipurin vdesin vetëm fizikisht, se ato lënë pas emrin dhe veprën. Profesor Çipuri le pas emrin e mirë dhe veprën e madhe si rrallë njeri që i le të dyja. Për këtë arsye për Profesor Çipurin do të flitet dhe do të shkruhet gjithmonë, do të ketë për të të tjera monografi, të tjera studime që do ta nxjerrin gjithnjë e më në pah personalitetin e tij vigan dhe punën kolosale që ka bërë. Ky është vetëm fillimi.

Xhafer Martini

Tiranë, më 30.05.2016

Rrëfenjë për kirurgun **Tahir Alku**



Këto mu kujtuan ndërsa shikoja e dëgjoja një emision televiziv për Aida Çajkën dhe foshnjën e saj, ku mendimet e mjekëve dhe komentuesve më ngjanin si "dokërr e drunjtë" në një fushë absurde dokrrash...

Këto mu kujtuan kur një mik nga Peshkopia më dërgoi një fotografi familjare të TahirAlkut, mjekut që një jetë të tërë ishte pranë e me njerëzit. Një aksident enigmë në ujërat e Shkopetit i mori jetën ndërsa kthehej nga një operacion në spitalin e Bulqizës ku, edhe pse kishte dalë në pension, shkonte herë pas here me makinën e tij për tu qenë pranë njerëzve...

Aida Çajka, bijë Lume e nuse Reçi u përcoll si dokërr në lojën e njohur popullore "dokrrash" nga njeri spital në tjetrin. Pasi i ra "rrotullës" e goditur nga "shkopinj të bardhë", humbi jetën bashkë me fëmijën e saj...

E dhimbshme në një kohë kur njerëz dhe mjete janë në kufijtë e teknikave të kohës...

E dhimbshme për familjen, dy fëmijët jetimë kafe e hidhët në mortet në Lumë e Reç

Ndërsa përjetoj dhembjen njerëzore si të gjithë njerëzit me gjak që lëviz arterieve e venave e shpirt që grafullon mu kujtua një ngjarje e viteve tetëdhjetë që kish mbetur në cepin e kujtesës.

...Isha kthyer nga një shërbim në malet e Gollobordës, midis njerëzve duarartë në ndërtim e punëtorë të palodhur në bujqësi e blegtori. Asokohe nuk kishte celularë e telefonat me dy tela mbi shtylla druri sa kishin arritur në qendër të fshatrave të bashkuar, si u thoshin asokohe, e po punohej që linjat të shkonin në çdo fshat. Vëllai nuk më kishte kapur dot për të më njoftuar për operimin e nënës nga apendiciti akut e unë lajmin do ta merrja vesh vetëm kur hyra në shtëpi. Gruaja po bëhej gati për të shkuar në spital për ti qëndruar nënës time tërë natën e parë të operacionit tek koka. Nuk eca por vrapova. Nuk mu nda hap pas hapi edhe ime shoqe...

Nëna na priti me buzëqeshjen e saj të ëmbël.

Tek koka kishte kirurgun Tahir Alku që po i maste pulsin.

- Gjithçka mirë. – më tha duke më shtrënguar dorën. Pasnesër vjen në shtëpi.

Njihesha me Tahirin ashtu siç njiheshin tërë banorët e qytetit tim të vogël. E respektoja si njeri dhe si mjek në dijet e tij shkencore dhe gatishmërinë për tu shërbyer njerëzve...

Nuk më shkohej në shtëpi ndaj me gjithë lutjet e nënës "shko se je lodhur" vazhdova ti qëndroj pranë...

Dola për një kafe e në hyrje të spitalit, tek urgjenca, takova Vehbi Ketën një mjek me të cilin kisha shumë shoqëri e kishim pirë një "ibrik kafe" bashkë...

Një sirenë ambulance na e dallgëzoi kafenë në filxhan. Hamdiu, shoferi i palodhur i ambulancës të spitalit, frenoi dhe gati i shpërfytyruar nga ajo që kishte përjetuar thirri: "Shpejt, shpejt, drejt e në sallën e operacionit".

Lëvizje njerëzish, hapje e mbyllje dyersh, shqetësim qytetar...

Pyes se çfarë kishte ndodhur.

Në Herbel, në atë kthesën e rrezikshme tek rruga zbret në përrua e kthehet thuajse njëqind e tetëdhjetë gratë brenda një ure të ngushtë, një makinë me pasagjerë ishte rrëzuar. Një grua e re kishte përplasur kokën dhe gjaku e kish mbuluar sa nuk i dalloje fytyrën.

> Këto m'u kujtuan kur një mik nga Peshkopia më dërgoi një fotografi familjare të Tahir Alkut, mjekut që një jetë të tërë ishte pranë e me njerëzit. Një aksident enigmë në ujërat e Shkopetit i mori jetën ndërsa kthehej nga një operacion në spitalin e Bulqizës ku, edhe pse kishte dalë në pension, shkonte herë pas here me makinën e tij për tu qenë pranë njerëzve...

E morën dhe me shpejtësi e çuan në sallën e operacionit...

Tek ishim me Vehbiun në sallën e urgjencës hyri Hamdiu që po kërkonte shoqëruesin e gruas, bashkëshortin e saj që fatmirësisht nuk kishte pësuar ndonjë dëmtim të dukshëm.

Një shqetësim tjetër qytetar. Ku ishte? Ku shkoi?

Dikush tha se ishte nisur për në Ushtelencë tek familja e të shoqes...

Ushtelenca nga Peshkopia është një orë larg në këmbë. Një udhëtim natën nga një njeri pa shoqërues, në një gjendje shoku nga ngjarja por edhe i tronditur nga aksidenti, edhe sikur të mos kishte asnjë dëmtim fizik, ishte një ngjarje tjetër e rëndë.

Ushtelenca nuk kishte lidhje telefonike. Provuam Brezhdanin, fshat një gjysmë ore larg. Nuk dilte njeri.

Mora centralin e repartit ushtarak. U prezantova se kush isha, u tregova rastin dhe u kërkova të më lidhnin me repartin ushtarak të Zdojanit. Lidhja ishte e menjëhershme. Kërkova oficerin e rojës. U përgjigj menjëherë. I thashë se jam Abdurahim Ashiku dhe marr nga komiteti i partisë. I tregova rastin dhe adresën e familjes ku do të shkonte i traumatizuari nga aksidenti. U kërkova të dërgojnë një skuadër të vogël me ushtarë dhe të kërkojnë e sjellin në spital personin. Më tha se do të shkonte vetë së bashku me dy ushtarë. Reparti ushtarak ishte po aq larg në shtrirje tokësore sa Peshkopia me Ushtelencën...

Vebiu, i çuditur nga adresimi im më tha:

- Si u the; "Marr nga komiteti i partisë" ?

- Mos duhet të shkoja në zyrë që ti merrja në telefon prej andej? Koha nuk pret.

Të nesërmen mësova se skuadra e ushtarëve me oficerin në krye kishin arritur në një kohë me burrin e traumatizuar. Kishin hyrë në shtëpi, kishin sqaruar familjarët dhe i kishin nisur për në spital për të përjetuar ngjarjen e rëndë që lidhej me të bijën.

Mësova edhe për betejën për jetën në sallën e operacionit. Mjeku Tahir Alku, kirurg me përvojë ishte ndodhur para një gjendje që nuk e kishte provuar asnjëherë. Gruaja kishte thyerje të kockave të kokës dhe me siguri rrjedhje të gjakut në hapësirën trunore. Një thirrje drejt Tiranës ishte një vdekje e sigurt edhe sikur të sillej helikopteri i urgjencës. Një lëvizje edhe deri tek fusha e sportit ku uleshin helikopterët ishte të humbje një jetë në një moshë fare të re...

Nuk mund të priste. U tha shokëve se do të hapte kokën e gruas. Gatishmëria e tyre e qetësoi...

Hapi kafkën. Vërejti se nuk ka dëmtime fizike. Pastroi tërë gjakun e derdhur mbi palat e trurit me kujdesin që të mos mbetet qoftë edhe një grimcë sado e vogël...

Në mëngjes, kur dielli nxori kokën nga maja e Hynoskës doli nga salla e operacionit me sigurinë dhe dyshimet që lindin në shpirtin e mjekut në raste të tilla kur luftohet për jetën...

Pas qëndrimit disa ditë në reanimacion gruaja, e vetëdijshme për atë që kishte ndodhur, kaloi në dhomën e të sëmurëve tashmë nën kujdesin dhe buzëqeshjen e të shoqit, prindërve e miqve...

Ishte përkushtimi qytetar i mjekut Tahir Alku, profesionalizmi i tij, përvoja dhe guximi që i shpëtuan jetën gruas së re nga Ushtelenca...

***

Këto mu kujtuan ndërsa shikoja e dëgjoja një emision televiziv për Aida Çajkën dhe foshnjën e saj, ku mendimet e mjekëve dhe komentuesve më ngjanin si "dokërr e drunjtë" në një fushë absurde dokrrash...

Këto mu kujtuan kur një mik nga Peshkopia më dërgoi një fotografi familjare të Tahir Alkut, mjekut që një jetë të tërë ishte pranë e me njerëzit. Një aksident enigmë në ujërat e Shkopetit i mori jetën ndërsa kthehej nga një operacion në spitalin e Bulqizës ku, edhe pse kishte dalë në pension, shkonte herë pas here me makinën e tij për tu qenë pranë njerëzve...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 24 shtator 2017

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

KANUNI ME … SHEKËN E KOSIT(!)

Nga **Haki PËRNEZHA**

Në historinë shumëvjeçare të së drejtës zakonore krahinore raste të veçanta të dhënies së drejtësisë kanë bërë jehonë e mbërritur deri në ditët tona për prakticitetin e tyre. Përdorimi i formave të larmishme në praktikat kanunore ka bërë që ndarjet e prezantuara nga pleqtë e Çidhnës të kenë qenë gjithnjë të besueshme e bashkëkohore. Pleqtë kanundarë, për çdo rast të paraqitur, të ndihmuar edhe nga stërpleqtë e tyre, grumbullonin informacion të bollshëm rreth ngjarjes, rastit të paraqitur dhe pastaj, atë e "ballafaqonin" me normat e së drejtës zakonore. Shpeshherë, pleqtë e stërpleqtë, për të qenë sa më bindës, merrnin mendimin e "esnafëve", të cilët ishin burra të urtë e me njohuri në blegtori, bujqësi apo zejtari. Pikërisht kjo përvojë e gjatë e këtyre "esnafëve" jo rrallëherë është shfrytëzuar për të dhënë zgjidhje *kanuneve* të ndërlikuara.

Ne do të përmendim një rast të tillë. Në Çidhën ky kanun u quajt i "shekës së kosit", pasi në këtë rast, pleqësia përdori një shekë kosi për të bërë eksperimentin e rastit. Ngjarja ka rrjedhë kështu:

Në fshatin Grykë Nokë, banorët e kishin larg burimin e ujit të pijshëm. Kroi ndodhej në mes të malit. Aty çdo ditë gratë e vashat e fshatit mbushnin ujë, aty pinin ujë edhe udhëtarët e çobanët. Një ditë aty rrotull kishin kaluar disa gjahtarë të cilët ishin në ndjekje të një kafshe, ndërkohë që një nuse e cila ishte shtatzënë po mbushte ujë te kroji. Në këtë kohë krisi pushka e gjahtarit dhe një lepur pak metra më tutje mbeti i shtrirë, ndërsa nusja me bucelën në shpinë po ikte për në shtëpi. Sapo nusja shkoi në shpi, u ndje keq e u shtri në krevat. Pas pak orësh ajo dështoi. Burrri mësoi nga gruaja se

> Përdorimi i formave të larmishme në praktikat kanunore ka bërë që ndarjet e prezantuara nga pleqtë e Çidhnës të kenë qenë gjithnjë të besueshme e bashkëkohore.
>
> Pleqtë kanundarë, për çdo rast të paraqitur, të ndihmuar edhe nga stërpleqtë e tyre, grumbullonin informacion të bollshëm rreth ngjarjes, rastit të paraqitur dhe pastaj, atë e "ballafaqonin" me normat e së drejtës zakonore...

ajo ishte trembur kur gjahtari kish gjuajtur me armë për të vrarë lepurin. Kaq mjaftoi që burri t'i çojë fjalë gjahtarit se "i kish gjakun" e fëmijës së dështuar. Gjahtari i ktheu përgjigje bashkëfshatarit duke i thënë që jam gati të shkojmë në një të drejtë dhe nëse mbetem me faj, jam i zoti i së keqes. Të dy palët pranuan që të shkojnë në pleqë (në të drejtë).

Që të dy zgjodhën për plak Lushën i cili ua mori fjalën të dy palëve që "të rrinë ku t'i lënë e drejta". Plaku i lushës punoi shumë për të gjetur zgjidhje që palët të mos shkonin drejt përdorimit të armëve. Ai e rrahu problemin me stërpleqtë e tij si dhe shfrytëzoi edhe disa informacione teknike që mori nga disa "esnafë". Ai njoftoi palët për datën dhe vendin e "gjyqit". Vendi do të ishte tek Gurra e Gjyqit në Prat, pak mbi fshatin Grykë Nokë. Një person ishte caktuar nga Lusha që të sillte atë mëngjez, një shekë me kos pa e trazuar fare. Të gjithë pjesëmarrësit, rreth 50 burra u çuditën shumë kur panë bashkëfshatarin të zbriste ngadalë në tokë shekën dhe hamendësonin me njëri tjetrin se çfar kishtë brenda në atë shekë. Askujt nuk i shkonte mendja te kosi, fundja ç'lidhje kish kosi me kanunin që do ndahej?! Plaku i Lushës gjithë solemnitet, thërret dy nga stërpleqtë e tij që i kish marrë nga Arrasi dhe iu drejtohet pjesëmarrësve: Të nderuar pjesëmarrës, ju falenderoj shumë që keni ardhë për të ndjekë këtë kanun i cili ndodhet aty në shekë (!). Të gjithë u habitën dhe me kureshtje po ndiqnin lëvizjet e stërpleqëve të cilët të urdhëruar nga Plaku morën shekën e kosit me kujdes dhe pa e trazuar e vendosën pikërisht aty ku kohë më parë kish qënë gruaja shtatzënë. Në këtë kohë Plaku ftoi 4-5 pjesëmarrës të cilët hoqën kapakun shekës dhe panë(!) brenda saj se ajo ish përgjysmë me kos por me cipën (kryesina e kosit) e paçarë... Një tjetër person qëndronte pikërisht në vendin ku fshatrari gjahtar kishte qëlluar e vrarë lepurin. Ai ishte porositur nga Plaku të qëllonte në ajër dy herë aq sa kish qëlluar gjahtar. Pra siç mund të kuptohet, plaku i Lushës "ndërtoi" me kujdes vendin apo skenën e "krimit". Pasi përfunduan të gjitha këto përgatitje, Lusha bëri me dorë nga pushkatari i cili qëlloi në ajër dy herë... Një heshtje varri kaploi te pjesëmarrësit. Askush s'po merrte vesh se çfar po bëhej. Tani sërishmi ngrihet plaku kanuntar i cili ftoi përsëri disa pjesëmarrës të vëzhgojnë brenda shekës së kosit. U hoq kapaku i shekës por asgjë kish ndodhë brenda saj. Plaku tërhoqi vëmëndjen fshatarve duke i nxitur të shohin me vëmëndje cipën e kosit. Ajo ishte e pa çarë, e pa dëmtuar...Në këtë moment, aty pranë shekës, Lusha nxori pistoletën dhe qëlloi në ajër dhe dy herë tjera dhe hoqi sërish kapakun e shekës për të parë. Cipa e kosit në shekë ishte plasaritur. Shihni këtu -ndërhyri plaku kanuntar, duke iu drejtuar të gjithë pjesëmarrësve me zë të lartë -gjahtari që ka qëlluar për të vrarë lepurin,nuk është fajtor për humbjen e jetës së fëmijës në barkun e nënës se ka qënë në një distancë të largët. Gjyqi mbaroi, e disa nga pjesëmarrësit iu drejtuan plakut kanuntar për ta përshëndetur për zgjidhjen e problemit në këtë formë duke shmangë gjakderdhjen në mes të konfliktuarve. Pas këtij "eksperimenti" shkencor kanunor, plaku mori përfaqësues nga palët në konflikt dhe i çoi për të pirë kafe tek njëri tjetri. Kafenë të dy palët e pinë te shpia e të dëmtuarit ndërsa buka u hangër te shpia e gjahtarit.

Kështu u mbyll dhe një "vatër" konflikti në Krahinë dhe ajo që ka mbete në memorien e çidhnakëve është mënyra e përdorur apo "eksperimenti shkencor" që u shfrytëzua për të provuar fajsinë e gjahtarit.

Siç shihet, plaku kanundar krahasoi cipën në shekën e kosit të njëllojtë dhe delikate me barrën në barkun e gruas shtatzënë. Sipas atij *kanuni,* krisma e pushkës së gjahtarit, nuk ka ndikuar në dështimin e fëmijës te gruaja që u përshkrua më sipër. Eksperimenti i bërë "tregoi" se vetëm nëse do të qëllohej afër gruas krisma do të ishte përgjegjëse për humbjen e fëmijës. Ende dhe sot kjo histori kanunore endet në gojën e çidhnakëve.

Shtator 2016

Halim Leska, i vetëm kundër ushtrisë serbe

Nga **METUSH SKEJA**

Në Korab ka dy toponime të veçanta: Luftain(Luftëtinë) dhe Varri i Halimit. Këto emërvende lidhen me luftën e dëshmorit Halim Leska,i cili plot 96 vjet më parë ka rënë në luftë kundër ushtrisëserbe,për të mbrojtur vendlindjen.Pas Luftës së Parë Botërore ushtria serbe pushtoi veriun e Shqipërisë. Duke u nisur nga politika e faktit të kryer,qarqet nacionaliste serbe kërkonin që vendet e pushtuara nga ushtria e tyre të ishin pjesë e shtetit serb.

Halim Leska ka luftuar trimërisht për lirinë e vendit tonë.Ai ka rënë në shtator 1920. Cilësori "trimërisht"është mëse i merituar. Personazhi në fjalëështë hero ivetmuar.Kjo i jep më shumë sublimitet veprës tij.Nuk ka pasur askënd afër për të ndarë rrezikun e integritetit fizik.

Unë kam biseduar me shumë njerëz,të cilët e kanë jetuar atë ngjarje.Ato nuk e kanë ditur fjalën "legjendë", por tregimet për luftën e Halim Leskës kanë qenë afër legjendës.Më mirë do t'i shkonte shprehja "në kufijtë e mitit e legjendës".Ato nuk bënin komente,por vetëm tregonin ngjarjen si ka ndodhur.Dua të bëj edhe një saktësim.Shpesh lufta e Shaban Alisë lidhet njëkohësisht me luftën e Halim Leskës.Shaban Alia ka luftuar e ka rënë në Sorokol në qershor 1920,duke prashitur misërat,kurse ngjarjet me Halim Leskën janë nëmesin e shtatorit 1920.Të dy kanë rënë kundur ushtrisë serbe.

> Kanë kaluar shumë vite nga rënia e dëshmorit Halim Leska.Kjo nuk do të thotë ta harrojmë.Nga ana tjetër nuk kërkohet aktualizim apo fryrje të ndjenjave nacionaliste,jo. Por,mendoj unë, të mos njohësh ato që kanë rënë për të mbrojtur këtë dhé është e padenjë. Njohja e qendresës Halim Leska i bën nder çdo njerit nga ne.

Halim Leska ka lindur në Ploshtan nga fisi i dëgjuar Leskaj.Ai ka qenë i fejuardhe do të bënte dasëm atë vjeshtë.Kjotregon se ka qenë në moshë madhore për të marrë vendime mbi vetvetën, i ndërgjegjëshëm për veprimet që ka kryer e pasojat e tyre.E fejuara e tij ka qenë nga fshati Kullas.Halimi nuk arriti të bëhej dhëndërr.Ai ka dashtu lirinë e vendit vet më shumë se vetvetën. Dhëndërrimin e ka dashtur pa pushtues. Ka qenëi gatshëm për flijim për interesat kombëtare.Do të sjell për lexuesin e këtij shkrimi fjalët e Xhon Stjuartt Mill që janë standart për gjykimin e sjelljes së njeriut, i cili ka thënë: "Unë e pranoj plotësisht se gadishmëria për të bërë sakrificëështë virtyti më i lartëqë mund të gjendet te njeriu".

Halim Leska në mëngjes ka qenë nisur për në Livadh të Gjatë për të bërë dru zjarri me dy kuaj.Ka arritur në Derbaç,aty ku sot është shkolla nëntëvjeçare.Ka dëgjuar të shtënat e armëve, në Korab,nga ushtrisë serbe.Ka ndryshuar drejtim e është nisur drejt Korabit.Thirrjes së ndërgjegjës për të mbrojtur vendlindjen e punës përsonale Halimi ka zgjëdhur të parën.Shpirti i motivit kombëtar e ka thirrur për sakrificë. Në Radomirë ka marrë fishekë.Një armë e ka pasur vetë, ka gjetur edhe armë të tjetra.I ka ngarkuar fishekët e armët në kuaj.Ka shkuar e ka zënë pozicion përballë forcave të ushtrisë serbe në Korab në bjeshkën e Preshit.Tërë ditën luftë.Nuk e ka lejuar ushtrinë serbe të marshojë mbi Radomirë. Në darkë vonë është kthyer në Radomirë, ka marrë fishekë,bukë dhe përsëri ka shkuar te pozicioni i mëparshëm.Në mëngjesin e ditës dytë ka filluar përsëri lufta.Ka duruar goditjet e armëve e predhat, të cilat i kanë rënë afë trupit.Ka përballuar kërcënimin e mosekzistencës i vetëm. Shpesh herëHalimika ndërruar pozicion duke përdorur disa armë.Ditën e dytë pas dite është vrarë.Një grup ushtarësh i kanë dalë tinëzisht nga prapa dhe e kanë qëlluar fatalisht.Lufta në dy anë të kundërta e me numër të madh forcash kanë sjellë rënien e Halim Leskës,ose rënien e luftës dhe qendresës Halim Leska.Moshatarët e prindërve dhe gjyshërive tonëetiketoni "Lufta e Halim Leskës në Korab".Kjo pëdorej edhe si kufi për ndarjen e kohës. Për aksh ngjarje thuhej se ka ndodhur para ose pas luftës së Halimit.

Në vitet 1948- 1950 disa bashëfshatarë të mi kanë qenë duke punuar në ndërmarrjen rruga-ura nëKuçovë.Mes tyre ka qenë edhe një shqiptar nga Tetova.Tetovasi kishte kaluar në anën e shtetit amë në vitet 1941-1942,por kishte qenë i mobilizuar më 1920 nga ushtria serbe edhe kishte marrë pjesë kundër Halim Leskës.Ai ka treguar se përball Halim Leska ka qenë i pakalushëm.Dy ditë luftë papushim.Ushtria serbe ka gjuajtur edhe me artileri. Halim Leska ka shfrytëzuar shpellat karstike për tu mbrojtur ndaj gjyleve të murtajave e topave.Në ditën e tretë,pasi është zhvendosur ushtria serbe, kanë shkuar vendasit.Halim Leska është varrosur nga radomirasit, ku ka rënë,aty ku sot quhet Varri i Halimit.Më pas ushtria serbe ka djegur e shpërngulur tërë Kalanë e Dodës.Pushtuesi shumë njerëz i ka vrarë.

Kanë kaluar shumë vite nga rënia e dëshmorit Halim Leska.Kjo nuk do të thotë ta harrojmë.Nga ana tjetër nuk kërkohet aktualizim apo fryrje të ndjenjave nacionaliste,jo.Por,mendoj unë, të mos njohësh ato që kanë rënë për të mbrojtur këtë dhe' është e padenjë.Njohja e qendresës Halim Leska i bën nder çdo njerit nga ne.Duke kujtuar dëshmorët ne respektojmë lirine tonë,vetveten.

Rruga e Arbërit nr. 125

homazh

Kujtim me rastin e 8-të vjetorit të ndarjes
nga jeta të kompozitorit Tahsim Oshafi)

Një kuadër dinjitoz e masovik që kujtohet me shumë respekt

Nga **FAIK XHANI**,
Kryetari i Shoqatës "BPPSH"



5 shtatori qe një ditë ndryshe, një ditë ku shumë shokë, moshatarë, miq e dashamirës u mblodhën së bashku në lokal "Kuksi " Tiranë për të fesuar 80-vjetorin e lindjes së Halil Robit.

Kush nuk deshi të shprehte mirënjohjen dhe respektin për Halil Robin!

Urimet më të mira shprehi n/kryetaria e Bashkisë Tiranë znj. Brunilda Paspali, konsiderata e vleresime të larta dhe të ngrohta shprehu ish-kryeredaktori i gazetës "Ushtima e Maleve" z. Velo Cfarku, me shumë respekt foli dhe ish-kryetari i Degës së Brendeshme Dibër Ilir Balili, me një poezi mjaft të goditur pershendeti artisti Halim Laçi etj., ndërsa kryetari i degës Mat, z. Sefer Duka dërgoi mesazhin: Nga Burreli, nga Deja e lartë, afër Dibrës, i përcjellë Halil Robit të bëhet edhe 100 vite të tjera. Kontributi i Halil Robit është i madh dhe i gjithanshëm, ndaj duhet vlerësuar e respektuar nga të gjithë në shoqatën tonë. Urimet më të mira e të sinqerta. Gëzuar 80-vjetorin e lindjes Halil Robi!"

Midis atyre përshendetjeve dhe urimeve, disi i vecantë, qe edhe urimi i z. Osman Vladi. Midis tjerash ai theksoi: " Vargu i numrave natyror matematik nga 1-80 vetëm për t'i numruar don kohë e jo më t'i jetoshë. I thonë 960 muaj apo 28800 ditë dhe kur bën këtë bilanc habitesh dhe vetë e thua sa paskam jetuar...!"

Kur analizon veprimtarinë e Halil Robit nga maja e këtij 80-vjetori ndjen gëzim e lumturi për atë që ka arrit, ndihesh i motivuar për ndreqjen e gjërave dhe për të lënë kujtime e mbresa sa më të mira me moshatarët, shokët e miqtë.

E rëndësishme është se Halil Robi me jetën e tij 80-vjeçare dhe me aktivitetin e tij të dendur ka çfarë të tregojë e të kujtojë, theksoj -kryetari i Shoqatës "BPPSH", z. Faik Xhani në përshëndetjen drejtuar atij me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Më tej ai vazhdoi:

"Halil Mersim Robi lindi në Venisht të Dibrës në një familje me tradita bujarie e atdhetarie më 1 shtator 1936. Mësimet e para i mori në Sllatinë, 7 vjeçaren në Shumbat. Më vonë mbaroi pashkëputje nga puna shkollën e mesme ekonomike dhe shkollën e Partisë.

Në vitin 1955-1957 kreu shërbimin ushtark në Vlorë dhe Durrës ku u dallua në përvetësmin e programit të përgatitjes politiko-ushtarake dhe detyrat që i ngarkuan.

Gjatë jetës së tij të gjatë prej 8 dekadash ka kryer detyra të shumta dhe me përgjegjësi shtetërore dhe shoqërore. Midis tyre llogaritar i ndërmarjes Grumbullimit Peshkopi-Sllovë, 2 vjet sekretar Lokaliteti, dhe 10 vjet kryetar lokaliteti në Sllovë, 4 vjet kryetar kooperativës Bujqësore Kala e Dodës dhe Sllatinës si dhe 15 vjet përgjegjës i zyrës së Gjendjes Civile Sllovë. Në maj të vitit 1994 hiqet nga puna dhe del në pension të parakohshëm për motive politike. Halili të gjitha detyrat që iu ngarkuan i kreu me ndergjegje të lartë dhe përkushtim. Për merita dhe rezultate në detyrat që ka kryer është dekoruar nga ish-Presidiumi i Kuvendit Popullor me Urdhërin e Punës të Klasit Dytë dhe Medaljen Për Shërbime të Shquara Shtetërore dhe Shoqërore.

Gjatë jetës së tij Halil Robi kreu edhe detyra shoqërore ku veçojmë detyrën e anëtarit të Këshillit Popullor të Rrethit Dibër për disa legjislatura si dhe detyrën e anëtarit të komisionit të revizionimit të Partisë së rrethit Dibër, të cilat i kreu me nder.

Në vitin 2005 u vendos me banim në Tiranë. Gjatë kësaj kohe u anëtarësua në Shoqatën "Bashkimi i Përgjithshëm i Pensionistëve të Shqipërisë" ku për 11 vjet ka dhënë ndihmesën e tij të pakursyer. Aktualisht është n/kryetar i kësaj shoqate. Për ndihmesën e dhënë mban edhe titullin e lartë "Nderi i Shoqatës BPPSH" .

Një xhiro po të bësh me Halilin nëpër Laprakë do të jesh i rrethuar prej njerëzve të moshave të ndryshme që kërkojnë ta takojnë e të bisedojnë shtruar. Janë nga më të ndryshmit, punëtorë, blektorë, klerikë e shërbëtorë të fesë, e pse jo edhe ish -kuadro të ndryshëm të kohës dhe të sotëm.

Ndërsa sheh këtë mirënjohje e respekt tek Halil Robi, ndryshe nga jo pak kuadro të tjerë të atyre kohëve, ku njerëzit asqë duan t'i takojnë e ti kujtojnë, mandej shpesh u ndërrojnë dhe rrugën, kupton se ai paska punuar e shërbyer mirë, paska lënë gjurmë me punën dhe aktivitetin e tij shumëvjeçar.

Jo rrallë, ndërsa ulemi e pimë kafe, i bie telefoni. E urojnë, i kërkojnë mendime për probleme të ndryshme dhe jo pak e ftojnë të marrë pjesë në gëzimet e tyre. Dhe Halili megjithëse i moshuar nuk përton, nuk nënvlehtëson asnjerin dhe përpiqet që secilin ta nderojë, ta respektojë dhe ta ngushllojë për çdo vaki.

Halil Robi është shembull edhe për leximin e librave. Ai nuk i ndahet leximit. Nuk është e lehtë të bisedosh e të ndashë mendime për libra të autorëve të ndryshëm me Halilin, sepse ai ka pasion, lexon e studion rregullisht.

Ai bënë një jetë të gjallë e aktive. Është i pranishëm në shumë veprimtari të ndryeshme e sidomos në promovimet e librave dhe veprimtarive që organizon Komiteti Kombëtar i Veteranëve të LANÇ-it e Organizata e Familjeve të Dëshmorëve.

Halil Robi është një nga njerëzit e këndshëm që i ka lezet fjala dhe i zë vend mendimi për shumë probleme edhe të kohës së sotme. Ai ndjek me kujdes zhvillimet e vendit e të komunitetit si dhe nuk kursehet të japi ndihmesën e tij në përmirësimin e punëve dhe në forcimin e unitetit e të solidaritetit midis individëve të moshave e profesioneve të ndryeshme, në shuarjen e konflikteve dhe pajtimin e gjaqeve. Ja sepse ndihem krenar se e njoha dhe e kam shok Halil Robin, këtë dibranë të urtë e të mençur, kuadër dinjitoz e masovik që kujtohet me shumë respekt edhe sot e kësaj dite.

E paçim me shendet të mirë e jetë të gjatë edhe për shumë vite të tjera!

TAHSIM OSHAFI, kompozitor i harruar

Nga **SUAT SHATKU**



Kur flasim për muzikën klasike, atë popullore qytetase por dhe për muzikën e lehtë, e sidomos atë të filmit e të dramë Shqiptare, nuk mund të lëmë papërmendur personalitetin e kompozitorit Tahsim Hoshafit.

Tahsim Hoshafi lindi në Tiranë më 28 nëntor 1928 në një familje të thjeshtë qytetare dibrane. Që në adoleshencë ishte i prirur nga veprat muzikore botërore klasike dhe ato të kulturës popullore kombëtare. Pas vitit 1945 e gjejmë Tahsimin si pjesëtar në grupet korale qytetase, atë të rinisë e të shtëpisë së kulturës. Në vitin 1951 kalon në korrin e Ansamblit të Ushtrisë. Gjatë kësaj periudhe e merr dhe hovin krijimtaria e tij artistike dhe muzikore, në romancën për piano "Kujtime". Në vitin 1945 do ta gjejmë T. Hoshafin të emëruar në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, ku veproi deri në vitin 1961. Gjatë kësaj periudhe ai vazhdon të kompozoj mjaft këngë masive dhe ato të lehta, për të cilat fiton emër në muzikën Shqiptare. Ndër këto këngë mund të përmendim: "Dashuria e pare", "Të dua", "Eja vashë", "Mbrëmje në bregdet", "Vashë sime", "Kthehu i dashur" etj. Përfundon me sukses kurset profesionale muzikore, e në 1959 përfundon liceun Artistik "Jordan Misja", ndërsa studimet e larta i ndoqi në Konservatorin e Tiranës. Pati raporte të ngushta dhe bashkëpunuese me pedagogët e muzikës si: Tish Dahija, Çesk Zahdeja. Kontribuoi intensivisht si specialist incizimi në redaksinë muzikore të Radio Tiranës. Ndërsa si lëvrues dhe krijues i muzikës klasike është autor i "suites sinfonike nr.1 për orkestër të vogël", "vals sinfonik", "Oratorin", "Variacione për piano", pjesë "noktum për violinçel e për piano". Ka punuar si përgjegjës muzikor në shtëpinë qendrore të krijimtarisë popullore. Për mëse një dekadë dha kontribut sesi mund të punohet në muzikë me koncepte bashkëkohore, profesionale, me ansambël artistik amator, e më pas profesionist. Kjo fenomen i individualitetit të Tahsim Hoshafit, ra në sy në koncertet e Majit, ku dhe është nderuar me disa çmime. Vend të gjerë në krimtarinë e Hoshafit, zinte dhe krijimtaria e lehte muzikore. Mori pjesë në 26-festivale radhazi, të këngës në RTSH, nganjëherë edhe me dy këngë, si dhe në një sere anketash muzikore, festival të këngës së muzikës qytetase në rrethe, asaj folklorike, të lehtë etj. Pjesëmarrës në vitin 1972 në Kongresin e II-të në Kongresin e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë. Nuk mund të harrohet muzika e filmit dhe ajo e dramës, ku mund të dallohet bashkëpunimi i shkëlqyer i tij, në filmin "Kapedani", të vitit 1972, ku Tahsimi ishte kompozitor i filmit e vëllai i tij, Fehimi regjizor i saj. Ka kompozuar suksesshëm dhe filma të tjerë si: "Thirja", "Shoku ynë Tili", "Dritat e qytezës", "Takimi i fundit"; Pas daljes në pension në vitin 1988, Tahsimi e shtoj akoma më shumë kontributin e tij duke krijuar rreth 20 vepra orkestrale simfonike, si për orkestrën e RTSH, ashtu dhe për RTV, ashtu dhe për orkestrat e disa rretheve të vendit si dhe orkestrat frymore të Ushtrisë, pallatit të Kulturës, Shtëpisë së Krijimtarisë Popullore.

Pas viteve 90' e gjejmë të aktivizohet në "Mbrëmjet e Romances Shqiptare" (1994-1997), si dhe themeloi poemën simfonike"Rizgjimi i popullit shqiptar", kushtuar ndryshimeve demokratike të viteve 1992. Krijimtaria e tij muzikore shquhet për origjinalitet, individualitet muzikor dhe spikatje të veçorive artistike muzikore të çdo lloj zhanri. Nuk duhet harruar që Tahsim Hoshafi ka një ndikim jo pak të rëndësishëm në fushën e shtypit, në publicistikë. Ai është autor i mjaft shkrimeve, studimeve dhe artikujve kritik e profesion për muzikën, intervista e oponenca muzikore. Gjithmonë duhen kujtuar, e nuk duhen lënë në haresën e kohës kompozitorët tanë të mrekullueshëm.

TAHIM HOSHAFI NË KUJTIMET E MIQVE

Për këtë mjeshtër të papërsëritshëm origjinën e tij të kohës e kanë kujtuar mjaft miq, artist, koleg, të afër e bashkëpunëtor të tij. Kujtojmë këtu shkrimin e Tahsim Hoshafit në vitin 1978 i cili i bën jehonë zërave rinor në festivalin e 16-të për fëmijë e të talenteve të reja. Ai shkruan se: "suksesi i këngës për fatosa e pionierë e ka quajtur si një sukses i madh. Në këtë shkrim plotë spikatje, jetë e frymëzim, Tahsimi evidentonte plotë pasion tre personazhe, sot pjesë e spikatur e skenës sonë: Zana Çela, drejtore e TKOB, sopranos me fame botërore, Inva Mula dhe këngëtarit Ardit Gjebrea. Sikur ai e ka ndierë suksesin dhe famën e tyre. Ai e quante depërtimin e tyre si një hap cilësor me përmbajtje në realizimin e krijimtarisë artistike, duke kristalizuar përshtatjen e mendimit psikologjik, emocional me fuqinë e zërit të interpretimit. Ndërsa këngëtari simpatik, Rudolf Stambolla, në intervistën e tij, me titull: "Tango dhe dashuria më kanë ndjekur gjithë jetën, e nuk mu ndalua në kohën e regjimit", flet duke theksuar se: "Këngë të bukura ka bërë dhe Tahsim Oshafi. Kënga "Dashurinë e parë" e kam kënduar unë dhe kjo këngë e kishte bazën tek kënga "Vajza e valëve". Ndërsa muzikologu i njohur Zamir Këlliçi, në librin e tij me titull: "Zemra e madhe, botë e ngushtë", botuar në Tiranë 2009, rrëfen për jetën dhe krijimtarinë e kompozitorit Hoshafi, me shumë respekt e dashuri për të. Ndarjen nga jeta të Tahsimit, e ka shkruar me shumë emocion e keqëardhje dhe miku i tij në librin: Tungjatjetja diasporë! E autorit Dr. Namik M. Shehut.

Autori shprehet se lajmin e ndarjes nga jeta të Tahsim Hoshafit, më date 18.09.2008 e mësoi nga Çikago ku Tahsimi, bashkëshorti i Engjëllushes që jeton në Tiranë ka ndërruar jetë.

nekrologji

Dr.Islam Cani u përcoll nga qindra miq, bashkëpunëtorë dhe të afërt
për në banesën e fundit më 27 shtator 2016.

Dr.Islam Cani është i gjallë me kontributin shoqëror dhe veprat e tij të botuara për Çidhnën e më gjerë

NGUSHËLLIM

Redaksia e gazetës i shpreh ngushëllimet familjes Cani për ndarjen nga jeta të njeriut të tyre të shtrenjtë, Islam Canit. Islami ishte një bashkëpunëtor i gazetës, një lexues i rregullt dhe një mik i mirë. Ai ishte një njeri që kontribuoi për vendlindjen, si dhe një veprimtar i palodhur në shërbim të çështjes së Rrugës së Arbrit.

I qoftë dheu i lehtë! / Redaksia

Dr.Islam Cani, i biri i Rrahmanit dhe i Hikes, u lind më 1932 në Çidhën të Poshtme në Dibër, nga fisi Cani, njëri prej fiseve më me emër të Çidhnës.

Çidhna e Poshtme deri në vitin 1967, kur u hap Kanali i Setës, ka qenë fshati më i varfër ekonomikisht në Dibër. Në kushte të tilla, edhe pse familja e tij kishte tokë buke të mjaftueshme, Islami u detyrua të merrte rrugën e kurbetit, qysh në rininë e hershme, në adoleshencë, në fillim të viteve '40 të shekullit të kaluar e të vendosej në Tiranë, duke punuar punë të rëndomta krahu, pranë bejlerëve, apo nëpër ndërmarrje shtetërore të kohës së pushtimit. Meqenëse emigrimi i tij përkoi me vitet e Luftës Nacionalçlirimtare Islami, si i ri që ishte u aktivizua duke dhënë ndihmesën e vet edhe në luftën kundër pushtuesve nazi-fashistë.

Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, ku kreu kursin për infermier, u vendos përfundimisht me banim në Tiranë, qysh në fillim të viteve '50, ku ka punuar gjatë gjithë jetës në shërbimin shëndetësor të Tiranës, së pari si ndihmës mjek, kryesisht në zonën e Kombinatit të Tekstilit (Lagjja Nr.6) dhe pas vitit 1967, kur përfundoi studimet e larta në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës ka punuar si mjek në Lagjen 6 dhe në Institutin e Inspektoratit Shëndetësor të Tiranës, i specializuar më pas edhe për patholog dhe kardiolog. Për shumë vjet ka qenë zgjedhur Kryetar i Frontit për Lagjen Nr.6 të Tiranës. Për punë të devotshme në shërbim të popullit në organet e shëndetësisë Dr.Islam Cani është dekoruar nga Kuvendi Popullor me shumë urdhëra e medalje pune.

Edhe pse u largua qysh në fëmijëri, Dr.Islami nuk i shkëputi kurrë lidhjet me Çidhnakët e dibranët. Kontributi i tij në aspektin shëndetësor në shërbim të tyre nuk mund të përshkruhet këtu, sepse nuk na lejon as koha, as vendi. Por, si dëshmitar okular, nuk mund të anashkaloj pa konfirmuar faktin



Dr.Islam Cani

se qysh prej fillimit të krijimit të familjes me Aleksandrën, në fillim të viteve '50, edhe pse në ato kohë të vështira, e pat kthyer shtëpinë në një bazë për çidhnakët, e thënë ndryshe, në një paradhomë spitali, deri sa ata të sistemoheshin në spitalet përkatëse të Tiranës. Meritë të veçantë, në këtë aspekt, ka znj.Aleksandra, e cila, si zonjë shtëpie që i ka pritur e përcjellur çidhnakët me nderim e respekt, ajo ka fituar simpatinë e tyre, ndaj ato e nderojnë dhe e respektojnë Aleksandrën, jo si nuse myzeqare e ardhur në familjen Çidhnake, por si bijë të vërtetë të Çidhnës. Pa dyshim, nuk mund të anashkalojmë pa përmendur këtu edhe rolin që ka luajtur në këtë aspekt nënë Hikja, e cila, me cilësitë e saj të bujarisë dhe të mikpritjes, ka qenë përfaqësuesja tipike e nënës dhe e zonjës së shtëpisë dibrane.

Për gjithë sa sipër, si dhe për veprat (librat) që ka botuar (13 tituj të depozituar në Fondin e Bibliotekës Kombëtare) Komuna e Arrasit e ka nderuar Dr.Islam Canin me titullin e lartë "Qytetar Nderi" të Komunës dhe Bashkia e Peshkopisë e ka nderuar me titullin e lartë "Qytetar Nderi të Peshkopisë".

Si themelues dhe Kryetar i Shoqatës "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorit Shqiptar" qysh prej vitit 1991, kontributi shoqëror i Dr.Islam Canit në mbrojtje të konsumatorit shqiptar në rang kombëtar dhe më gjerë, është një vepër e konfirmuar dhe e evidentuar si në median e shkruar dhe në atë elektronike.

Me studimet e tij shkencore dhe me diskutimet e intervistat e dhëna në mediat e ndryshme, Dr.Islami ka dhënë kontribut mbarëkombëtar duke influencuar pranë shtetit për të përmirësuar ligjet shtetërore në mbrojtje të Konsumatorit. Dr.Islam Cani është ai që ka përfaqësuar denjësisht jo vetëm shoqatën, por edhe shtetin shqiptar në shumë takime ndërkombëtare me Organizatën Botërore për mbrojtjen e Konsumatorit (Consumers International) me qendër në Londër, e cila në një sesion të caktuar të saj, e ka zgjedhur Dr.Islam Canin anëtar të Kryesisë së vet.

Duke përfunduar, theksojmë se Dr.Islam Cani është përjetësisht i gjallë ndërmjet nesh jo vetëm me kontributin shoqëror dhe veprat e tij të botuara për Çidhnën e më gjerë, por edhe me pasardhësit, trashëgimtarët e tij që ka lënë mes nesh, tre intelektualë të mirëfilltë. Është merita e Dr.Islamit dhe e Aleksandrës që i rritën dhe i edukuan të tre fëmijët me cilësi të larta morale dhe arsim të lartë në ato kushte tepër të vështira ekonomike, me të cilët krenohet jo vetëm familja e fisi Cani, por dhe mbarë Çidhna e Dibra, duke filluar, së pari, me djalin e madh, Shkëlqimin, i mirënjohur prej të gjithëve, Prof.Dr. i Shkencave ekonomike, i cili ka kryer e vazhdon të kryejë detyra të larta shtetërore e shoqërore: deputet i Kuvendit të Shqipërisë në shumë legjislatura, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, Specialist i Bankës Botërore, pedagog në Universitetin e Tiranës, ministër e deri në postin e Zv.Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Edhe Prof.Dr.Zana dhe Arbeni kanë bërë emër në shoqëri atje ku jetojnë e punojnë, respektivisht në SHBA dhe Kanada, duke nderuar vetveten edhe familjen.

Në këtë moment ju ftojmë të mbajmë një minutë heshtje në shenjë nderimi për Dr.Islamin!

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!.

Ali HOXHA

Nënkryetar i Shoqatës së Konsumatorit Shqiptar (qysh prej themelimit)

Tiranë, më 27.09.2016

Homazh për shokun tonë të klasës

Me një shtator u nda nga jeta shoku ynë i paharuar Halit Bushi,lindur në Kishavec me 30 maj 1938. Haliti vinte nga një familje e varfër fshatare.Arsimin fillor e mbaroi në Vakuf dhe atë shtatëvjecar në Kastriot.Shkolla e Vakufit ishte nga të parat e hapura pas clirimit në atë zonë, ku, krahas femijëve te moshës shkollore,mesonin në klasë të parë edhe nxënës më të mëdhenj e deri 15 - 16 vjeçarë.Haliti i mbaroi të dya këto shkolla me rezultate shumë të mira.Për rezultatet në mësime u mendua që të ndiqte të mesmen për mjekësi, por i ati u bë pengesë pasi nuk donte që i biri t'i largohej përtej rrethit. Kështu u pranua në të mesmen Pedagogjike të Peshkopisë. Kjo ndodhi në vitin shkollor 1954-1955.

Edhe këtu Haliti shkëlqeu si nxënës, sidomos në matematikë. Shkollën e mbaroi me nota shumë të mira dhe me Fletë Nderi. Pas mbarimit të Pedagogjikes, Halitin, pavarësisht se Pedagogjikja e Peshkopisë përgatiste mësues për shkollat fillore, e caktuan mësues matematike në shkolllën shtatëvjecare të Rubikut dhe në disa shkolla të tjera të Mirdites, detyra që i kreu me përkushtim.

Puna e mirë dhe efikase në edukimin e vocërakëve mirditorë bëri që Halitit t'i jepj e drejta e studimit në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe pikërisht në degën e gjuhës anfleze, ku gjithashtu shkëlqeu në mësime. Pikërisht këtu u njoh me bashkëshorten e tij të jetes- korçaren Donika Bulku.

Ne vitin 1965, pas mbarimit te Universitetit, bashkë me bashkëshorten e ardhëshme, me të cilën pati dy djem njeri më i mirë se tjetri, caktohen mësues anglishtjeje në Rrethin e Beratit. Edhe si mësues Haliti dallohet per mësimdhënie



krijuese si dhe për angazhimin e tij të vazhdueshëm në veprimtari të ndryshme në ndihmë të shoqërise. Ai hartoi nje tekst shkollor me titull "Anglisht per klasen e shtatë", qe u prit mjaft mirë nga ata që u njohën me të, por që nuk e pa dritën e botimit. Po ashtu shkruajti artikuj te ndryshem rreth mesimdhënies ne organet përkatëse të shtypit të kohës, si në gazetën "Mësuesi". Të tillë mund të përmendim shkrimet: " Mendime kritike për tekstin e anglishtes klasa e poestë", " Fjalori Frazeologjik për 7-vjecaren" etj. Po ashtu ai u aktivizua edhe në përkthime nga literatura e huaj. Përmendim prej tyre tregimin "Kurorë e Bardhë për një të Zi", "E Qeshura " e Xhejms Henlit, "Miu që sjell dollare" te Uilliam Sarojan, "E bija" e Erskin Kollduell-it etj. Ai ndërtoi një kabinet anglishtjeje,që u bë shembull në tërë Rrethin e Beratit, madje edhe për gjuhët e tjera që mësoheshin atëkohë në shkollat e Beratit dhe të vendit.

Për tërë këtë punë të vyer dhe perkushtim, në vitin 1990 Halitit i jepet medalja e punës "Naim Frasheri", me motivacionin: "Eshtë dalluar për punë të ndërgjegjëshme dhe për arrritje në mësimin e edukimin e nxënësve"

Haliti e priti me entuziazem ndryshimin e sistemit në vitin l990 dhe ndër të parët iu bashkua levizjes demokratike.Kjo edhe për shkak të një përndjekjeje,që nisi që kur ishte në Pedagogjiken e Peshkopisë, kur bashkë me shokët e klases, braktisi mesimin në shenjë proteste ndaj mënyrës se si zëvendësoheshin orët e mësimit të disa mësuesve që aktivizoheshin me sportin e futbollit në atë kohë. Shkak për përndjekjen e tij u bë edhe gjetja në komodinën e tij në konvikt të një bombe, që Haliti tha se e kishte me qëllim që ta shperthente me rastin e ndonjë festet popullore si "Dita e Verës" apo "Shengjergji".

N'atë kohë,ishte traditë që fëmijët,kryesisht adoleshentët, të organizonin nëpër festa lojra me mjete shpërthyese,përfshire bomba, eksplozivë etj. kryesisht të mbetura nga Lufta.

Për fatin e tij të keq, ajo ngjarje do të lindte gjurmë në jetën e tij të mëpastajme për shkak se përkiti pakashumë me t'ashtuquajturin "Kundërrevolucion në Hungari". Ishte koha kur vigjilenca revolucionare ishte mprehur shumë dhe disa prej mësuesve, më fanatik se ç'duhej në "mbrojtje të vijën së Partisë". u munduan t'i jepnin kësaj ndodhie karakter politi, ndonëse ajo qe thjesht një veprim i zakonshëm adoleshentësh. Por njolla u vu dhe hajde e hiqe.

Një goditje të rëndë mori familja e Halitit në vitin 1991: djali I tij I vogël, Erjoni, student në inxhinieri tekstile, la shkollën dhe u largua emigrant në Greqi, ku gjeti vdekjen si pasojë e një aksidenti.Ishte vetëm 21 vjeç,në lulen e rinisë.Kjo ngjarje e hidhur e shoqëroi atë gjatë tërë këtyre viteve.Dhimbjen e madhe për vdekjen e parakohëshme të të birit,Haliti e shpreh në librin me kujtime me titull:" Erjoni ynë".

Në Berat dhe Kucovë, ku punoi Haliti, krijoi lidhje të forta me vendasit, që i ruajti deri në frymën e fundit të jetës. Po ashtu ai asnjëherë nuk i ndërpreu lidhjet me vendlindjen,ku shkonte hera-herës, dhe as me shokët e tij, duke u bërë promoter i takimeve të vazhdueshme të ish maturës së vitit 1958.Takimi I fundit në të cilin Haliti mori pjesë ishtë ai i 55-vjetorit, që u festua në Peshkopi.

Lamtumirë shoku ynë i klasës.Ti ike, por nuk je ndarë prej nesh.Ne do t'a ruajmë kujtimin tend sa të na rrahë zemra. U prehsh ne paqe dhe qetësi.

Ngushëllime edhe familjes,te afermeve dhe dashamirëve të tut ë shumtë në Peshkopi dhe Berat.

Sulejman TOMÇINI, Shahin LAZRI

Tiranë.me 20 shtator 2016



printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603